

**E**dukata e altruizmit

**E**shtrenjta vuajtja ime

**R**e përdhe! Pse nuk ngrihesh?

**U**ni: Kanceri i rrugës së shërbimit

**S**ikur të arrinim qoftë dhe 1%

**I**njeksion jete

**K**rijimi



# Sakrifica

# Editorial

Të kërkosh melhemin e dhimbjes që ndjen në brengën që të ka shtrënguar në shpirt! Ka nga ata që mendojnë se kush kërkon zgjidhje për çdo hall që i ka pllakosur dhe dëshirojnë të jetojnë në kushte komforte, janë më të pafat se të përvuajturit në jetë.

Ata që nuk ndejnë thellë në shpirt brengën që e ka pllakosur tjetrin si ta kishin përjetuar vetë këtë ndjesi, janë individët e zhveshur nga delikatesa e vërtetë e shpirtit. Ata janë të pafatët që nuk kanë shijuar në jetë shijen e hidhur të brengës, apo që nëse e kanë përjetuar atë, ende nuk kanë shpëtuar prej rehatisë dhe kënaqësisë që kërkon trupi njerëzor.

Altruizmi është një ndjenjë sipërore e cila na mëson të mos kërkojmë të na pagujnë me të njëjtën monedhë për hir të mirësisë që kemi kryer dhe të mjaftohemi vetëm me vetveten. Në të nuk kemi pse të shohim asnjë grimcë dobësie.

Altruizmi fillon aty ku logjika nuk thotë fjalën e fundit dhe imagjinaria të vjen rreth e rrotull.

Altruisti është personi që del mbi interesin dhe nevojën vetjake, ai që mund të fusë brenda një pike loti dhimbjen që i shkakton panorama e padëshirueshme e jetës shoqërore, ku intriga, mashtrimi, shkelja e të drejtave dhe filozofia se i forti shtyp të dobëtin vallëzojnë përditë para syve të tij. E ky njeri ka edhe një shqetësim tjetër, dëshiron që atë pikë loti ta lëshoj aty ku e meriton ajo.

Ai ka vetëm një shqetësim dhe preokupim në jetën e tij, t'i marrë për dore njerëzit, shpirtrat dhe ndjenjat e të cilëve janë shndërruar në gurë, për t'i shpënë drejt botës së ndjesive supreme dhe fërgëllimave shpirtërore.

Nëse ndokush i bën një të keqe ai di ta kontrollojë vetveten, madje i vjen keq për njeriun që ka rënë në atë shkallë sa të bëjë gjëra të tilla, nëse ndokush e ther me gjemba, ai nuk dëshiron ta shqetësojë atë as me petalet e trëndafililit.

Ka uri? Atëherë mendon që kafshatën e bukës t'ua jap njerëzve që kanë ditë pa ngrënë. Ka etje? Atëherë gotën e ujit ua afron buzëve të zhuritura të njeriut që e djeg zjarri i etjes. Ata që erdhën për ta vararë atë, tek ai gjetën jetën e vërtetë.

Nuk e di nëse ju njihni të këtyllë, por unë kam njohur të këtyllë dhe Atij ia kush-toj këto vargje:

*Çehre të ngrysur, surretër intrigantë*

*Rrezja që pres, për këtë delikaten situatë*

*O Zotëruesi i Kohërave, hidh një shikim dhe vështromë pak*

*Njerëzimi mbarë, ty të priti në ag*

# Në këtë numër do të lexoni:

## E shtrenjta vuajtja ime

Seher Ajdën

Mundimi, brenga, pikëllimi... janë të vërteta të hidhura të jetës. Janë fjalë të cilat thjesht vetëm kur i thua, ta ngush-tojnë shpirtin, ta ndrydhin zemrën. Janë fjalë që...

7



Edukata e altruizmit

Hasan Kamil Jëllmaz

| 4 |

| |

| 7 |

E shtrenjta vuajtja ime

Seher Ajdën

| |

Re përdhe! Pse nuk ngrihesh?

Omer Çelik

| 9 |

| |

## Të qash apo të qeshësh

Ridvan Seferaj

Jeta që na ka dhënë Krijuesi i gjithë-sisë si amanet kalon shumë shpejt. Askush nuk mund ta di se kur mund të na kërkohet që ta kthejmë këtë amanet të çmuar...

13



| 13 |

Të qash apo të qeshësh

Ridvan Seferaj

| |

Solidariteti dhe Bashkëpunimi në botën e qënieve të gjalla

Harun Jahja

| 15 |

| |

## Solidariteti dhe bashkëpunimi në botën e qënieve të gjalla

Harun Jahja

Bashkëveprimi ndërmjet gjallesave dhe specieve të ndryshme ka një rëndësi jetësore për të siguruar kushte optimale jetese...

15



| 19 |

Sikur të arrinim qoftë dhe 1%...

Halil Xhandan

| |

Gruaja Sakrifikuese: shtylla e shtëpisë

Zahide Topçu

| 21 |

| |

| 22 |

Injeksion jete

Idriz Arpat

| |

## Gruaja Sakrifikuese: shtylla e shtëpisë

Zahide Topçu

Gruaja myslimane, është shenja e sakrificës dhe dashurisë së familjes. Ajo...

21



Durimi dhe sakrifica

Naim Drijaj

| 24 |

| |

| 25 |

Thirre yllin e dëshirave

Xhahid Bushati

| |

Historia e hazreti Ibrahimit e Ismailit "Alehimysselam

Islam Dizdari

| 26 |

## Përkthyes:

Adelina Muça

Albert Halili

Ali Bardhi

Artur Tagani

Elvira Puka

Ermal Nurja

Evans Drishti

Klementina Rrepa

## Redaktor: gjuhësor-letrar:

Islam Dizdari

## Dizenjo - Grafik:

Bledar Xama

bledar\_xama@hotmail.com

Viti: III Numri: 10

Janar - Shkurt 2008





Dhulhixhe - Muharrem 1428 - 29

Boton

Progresi Sh.p.k:

Shkodër / Shqipëri

# Janar - Shkurt 2008

	30	Uni: Kanceri i rrugës së shërbimit <i>Osman Nuri Topbash</i>		Injeksion jete <i>Idriz Arpat</i>	Sa mirë është të jesh i thjeshtë e i sinqertë dhe sa keq të kesh formalitete dhe " të bësh sikur je" ...	22
Kurbani - Sakrifica dhe norma e tij në sheriatin islam <i>Zymer Ramadani</i>	37					
	40	Dialogu ndërkulturor <i>Feti Mehdiu</i>				
Tregim <i>Alban Kali</i>	44			Uni: Kanceri i rrugës së shërbimit <i>Osman Nuri Topbash</i>	Pranimi nga ana e krijuesit të gjithësisë i adhurimeve të bëra është i lidhur me pastërtinë shpirtërore dhe...	30
Haxhi ideal dhe umreja <i>Artur Tagani</i>	49					
	51	Relikte Historike <i>Ermal Nurja</i>		Dialogu ndërkulturor <i>Feti Mehdiu</i>	Janë mbajtur takime për dialogun ndërmjet qytetërimeve, ndërmjet feve etj. Sot...	40
Shëndeti dhe familja <i>Albert Halili</i>	55					
	57	Artet Islame <i>Ali Bardhi</i>				
Aktualitet <i>Adem Pizga</i>	60			Klerikët myslimanë shqiptarë në dosjet e Myftinisë së Stambollit <i>Ermal Nurja</i>	Dokumentacioni ofron të dhëna të tërthorta në lidhje me myftilerët, medresetë...	40
	62	Teknologji <i>Ali Bardhi</i>				

## Adresa:

L: Vasil Shanto Rr: Çajupi  
Shkodër

Tel: +355 69 20 76 768

## Për artikuj:

e-mail: [revistaetika@hotmail.com](mailto:revistaetika@hotmail.com)  
[etikaeditor@yahoo.com](mailto:etikaeditor@yahoo.com)

Ngjyra: Progresi  
Tel: +355 69 20 76 768

Shtyp: ArbëriaDesign, Tetovë

Tel: +389 44 35 33 71

Fax: +389 44 35 33 72

Çmimi: 1 Euro / 150 Lek / 60 DEN



# Edukata e altruizmit

Njeriu që zotëron në vetvete mësimet e “vëllazërisë fetare dhe kombëtare” e konsideron pasurinë si pasuri nga e cila mund të gëzojnë edhe të tjerët në rast nevojë.

Altruizmi është e kundërta e fjalës egoizëm. Egoizëm do të thotë të mendosh vetëm për vetë, të nxjerrësh në plan të parë egon, të sillesh në mënyrë egoiste. Kurse altruizmi do të thotë të mendosh për vëllain tënd sa mendon për vetvete, madje në disa raste edhe më shumë, ta konsiderosh përbushjen e nevojave të vëllait tënd të fesë më të rëndësishme se nevojat tuaja personale. Me thënien profetike do të shpreheshim «Të duash për vëllain tënd të fesë atë që ia dëshiron vetvetes, dhe të mos duash për vëllain tënd të fesë atë që nuk ia dëshiron vetvetes. « (Buhari, Iman, 7; Muslim, Iman, 71-72) apo e shprehur me gjuhën e Kur'anit «Të zgjedhësh nevojat e vëllait tënd para nevojave të tua « ( el-Hashr, 59/9)

Qenia njerëzore, e shprehur me gjuhën e mistikëve, ashtu si vetia që ka dheu për të thithur ujin, dhe prej të cilit edhe është krijuar, është i dhënë pas rrufitjes dhe kapjes së të mirave të kësaj bote. Prirja themelore e njeriut është egoizmi.

Për shkak të zgjedhjes së vetvetes para gjithçkaje njeriu dëshiron që t'i përbushë nevojat e egos së tij dhe për ta realizuar këtë gjë ai provon

rrugë nga më të ndryshmet. Shumë e vështirë është ta frenosh këtë ndjenjë, madje nganjëherë e pamundur, po që se individit nuk ka marrë edukimin e nevojshëm të vetvetes dhe edukatën e shprehjes së vullnetit. Kjo është edhe arsyeja përse në urdhëratë mistikë me konceptin e “vëllazërisë” synohet të kalohet pengesa që na vë përpara individualiteti dhe egoizmi. Vetëm nëpërmjet kësaj ndjenje njeriu mund të anashkalojë me vështirësi makutërinë e tij për individualitetet dhe pasuri.

Njeriu që zotëron në vetvete mësimet e “vëllazërisë fetare dhe kombëtare” e konsideron pasurinë si pasuri nga e cila mund të gëzojnë edhe të tjerët në rast nevojë. Në mësonjëtoret e hershme të mistikëve myslimanë i numëronin si devijim nga mësimet mistike përdorimin e fjalëve të tilla si “rroba ime, pasuria ime, shtëpia ime” duke pasur frikë se kështu do të kultivojnë në shpirtat e tyre ndjenjën e tepruar të pronësisë mbi gjërat e kësaj bote. Madje në mesin e tyre ishin të përhapura fjalët: “Në sheriat pasuria jote të përket vetëm ty, pasuria ime më përket vetëm mua. Në tarikat edhe pasuria jote, por edhe pasuria ime janë të tuat.

Ndërsa në hakikat, edhe pasuria jote, edhe pasuria ime i përkasin Allahut (xh.sh.)”

Ja kjo edukatë mund ti distancojë sadopak njerëzit nga qëndrimet e tyre si të ishin pronarë të hershëm të pasurive të kësaj bote dhe i mëson se si duhet të përfitojnë nga të mirat dhe begatitë e kësaj bote. Sa bukur e ka shprehur këtë realitet poeti mistik turk Junus Emre me këto vargje:

*Thonë i zoti i mallit, i zoti i pasurisë;*

*Kush është i zoti i parë i pasurisë?*

*Malli, gënjeshtër; pasuria, gënjeshtër...*

*Merru dhe ti pak me to në s'paç punë tjetër!*

Nuk ka fjalë më me vend se këto të poetit Junus Emre që na tregojnë se pasuritë e kësaj jete nuk na hynë aspak në punë përveç se të kalojmë kohën me to. Kurani e mëson njeriun që ta shoh pasurinë e kësaj bote vetëm si një mbështetëse për të cilën ai duhet të mbahet. (en-Nisa, 4/5).

Kjo lloj qasjeje me bazë në mësimet e Kur'anit fiton një rëndësi të veçantë sidomos në periudha skamjeje dhe ngush-

tësie ekonomike, në ato periudha kur nevojitet më shumë se kurdo të ndash hallet së bashku me nevojtarët dhe të gjallosh me mundësitë ekonomike që kanë të tjerët.

Në Kur'an njerëzit trajtohen të ndarë në tre grupe, secili prej të cilëve ka veçoritë e tija ekonomike dhe shoqërore. Ato grupe janë të ngratët, mjeranët (mesakin), të varfëritë (fukara) dhe të kamurit (agnija). Edhe pasuritë dhe të ardhurat që gëzojnë këto tre grupe ndahen përkatësisht në gjëra të domosdoshme (zarurijat), të nevojshme (haxhijat) dhe lukse (zejnijjat).

Gjërat e domosdoshme janë ato që kanë lidhje me vazhdimësinë e jetesës së njeriut siç është ushqimi sa për të mbajtur frymën gjallë, rrobat që do të nevojiteshin për t'u mbrojtur nga të ftohtët, një shtëpi sa për të jetuar brenda në të etj. Njerëzit që e kanë të vështirë për t'i siguruar këto gjëra, të cilat në ekonomi njihen si "nën kufirin e varfërisë", Kur'ani i emërton me termin "mjeran, të ngratë" (mesakin).

Gjërat e nevojshme, quhen ato gjëra që lehtësojnë rrjedhën e mënyrës së jetesës, që shndërrohen në të nevojshme sipas statusit shoqëror në jetën e përditshme, por që nuk hyjnë në gjërat që mund të konsiderohen luks. Në mesin e këtyre gjërave të nevojshme që ndryshojnë në varësi të kohës, kushteve dhe njerëzve mund të numërojmë pajisjet elektrike për një shtëpi, mobiliet, mundësitë për arsimim, mjetet e transportit etj. Personat që nuk

kanë mundësi ekonomike që ti gëzojnë gjërat e këtilla Kur'ani i klasifikon në grupin e të "skamurve". Këta janë personat që kanë të ardhura, por me to nuk arrijnë ti përmbushin nevojat e tyre të jetës.

Gjërat e luksit janë ato gjëra që individët i posedojnë pasi të kenë përmbushur nevojat e tyre të domosdoshme dhe të

Qenia njerëzore, e shprehur me gjuhën e mistikëve, ashtu si vetia që ka dheu për të thithur ujin, dhe prej të cilit edhe është krijuar, është i dhënë pas rruftjes dhe kapjes së të mirave të kësaj bote.

nevojshme. Personat që i gëzojnë ato në Kur'an quhen si "pasanik". Këto mundësi ekonomike që e lehtësojnë në mënyrë të tejskajshme jetën e përditshme duhet të vlerësohen si begati të dhuruara nga Allahu për të cilat pasi duhet paguar zekati, të mund të kanalizohen në punë bamirësie pa rënë në shpërdorime dhe lukse të mëdha.

Edhe në jetën e profetit Muhamed (a.s.) dhe të shokëve të tij vërejmë ekzistencën e këtyre tri grupeve sociale. Profeti Muhamed (a.s.), i cili e konsideronte shoqërinë si një trup a organ të vetëm, ndërsa individët si pjesë të këtij trupi apo qelizat e këtij organi, tregonte

një kujdes të madh që brenda shoqërisë të mos ekzistonte një diferencim i madh ekonomik dhe nuk lejonte që të shkohej pas luksit në këtë jetë përderisa kishte njerëz që mezi plotësonin nevojat e tyre të përditshme. Ai i tërhiqte vëmendjen në këtë drejtim në mënyrë të veçantë familjes, bashkëshorteve dhe bijve e bijave të tij. Prandaj edhe kur bija e tij Fatimeja, i kërkoi që t'i jepte një shërbëtoreshë për ta ndihmuar ai e pat shprehur me këto fjalë mospajtimin e tij ndaj kësaj kërkese: «Bija ime, nuk mund t'u jap një shërbëtoreshë kur njerëzit e suffasë bien shakull në tokë nga uria. Ato që kam mendoj t'i shes që t'u sigurojë atyre bukën e përditshme.» (Ibn Hanbel, I, 106)

Kërkesat e pareshtura të bashkëshorteve të profetit e prekën thellë në shpirt Muhamedin (a.s.) dhe në shenjë proteste për mënyrën e tyre të sjelljeve ai nuk i pat takuar për plot 29 ditë duke fjetur netëve në xhami. Vetëm me shpalljen e ajeteve kuranore (Ahzab, 33/28-29) situata u normalizua.

Në rastet kur ulej të hante bashkë me pjesëtarët e suffasë Muhamedi (a.s.) përherë e zgjaste dorën i fundit drejt ushqimit duke ekspozuar kështu shembuj të rrallë altruizmi. Një ditë prej ditësh Ebu Hurejreja (r.a.) duke mos i bërë ballë edukimit sipas mënyrës së suffa-s doli përjashta nga xhamia. Muhameti (a.s.) që e kuptoi se arsyeja e largimit të tij qe uria dhe etja e madhe që e kishin kapluar, kërkoi të sillnin një tas me qumësht



nga shtëpia dhe i ftoi të gjithë ata që gjendeshin brenda në xhami të pinin. Të gjithë pinë qumësht aq sa u ngopën, kurse profeti Muhamed (a.s.) piu i fundit. (Buhari, Rikak, 17; Ibn Hanbel, II, 515)

Shembujt e altruizmit janë të panumërt në historinë e shekullit të lumturisë. Një ndër shembujt më të bukur të saj është rasti kur një person i dhuroi një copë bukë një nevojtar që takoi. Ky i dyti duke menduar se ka edhe më nevojtar se ai ia dhuroi një të treti. I treti ia dhuroi një të katërti. E kështu me radhë derisa ajo copë buke mbërriti në duart e bamirësit dhe dhuruesit të parë. Ibn Umeri e shpjegon me këto fjalë atë epokë: «Kemi jetuar kohëra të tilla që, askush nga ne nuk e çonte ndër mend që të kishte pasuri në ar dhe argjend më shumë se të tjerët. Kurse sot jetojmë kohë të këtilla që pasuria në ar dhe argjend na duket shumë më e ëmbël sesa vëllazëria jonë prej myslimanësh» (Mexhmau>z-zevaid, X, 285).

I dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), nuk e mirëpriste qëndrimin dhe prirjen e pjesëtarëve të suffa-së që përpiqeshin të bënin sa më shumë pasuri nga kjo botë dhe pohonte se kjo nuk përputhej me botën afektive të kulturës shpirtërore, në të cilën dëshironin të hynin. Raportohet se kur i hoqën rrobën një pjesëtarit të suffa-së për ta veshur ne qefin ranë për tokë dy monedha ari. Profeti Muhamed (a.s.) që ishte prezent aty tha: «Ja dy arsye për t'u damkosur!» duke shprehur me këto fjalë habinë dhe pakënaqësinë e tij përballë kësaj pa-

mje. (Ibn Hanbel, Musned, V, 252, 253, 258)

Arsyet që një pjesëtar i suffa-s të ruante ato monedha ari mund të ishin dy: mungesa e sinqeritetit të tij ndaj asketizmit dhe mosvlerësimit të pasurive të kësaj bote, ose dobësia njerëzore për t'u dhënë me mish e shpirt pas pasurisë.

Një ndër shembujt më të mrekullueshëm të altruizmit u

**Kërkesat e pareshtura të bashkëshorteve të profetit e prekën thellë në shpirt Muhamedin (a.s.) dhe në shenjë proteste për mënyrën e tyre të sjelljeve ai nuk i pat takuar për plot 29 ditë duke fjetur netëve në xhami. Vetëm me shpalljen e ajeteve kuranore (Ahzab, 33/28-29) situata u normalizua.**

përjetua në fushëbetejën e Jermukut, kur të mbijetuarit nga lufta ku kishin marrë me dhjetëra plagë në trup, kërkonin të pinin një pikë ujë. Paçka se etja i kishte kapluar, aq më shumë

nga gjaku i humbur në betejë, ato monumente të rralla të ndjenjave shpirtërore preferonin që tasi me ujë që u zgjatej të pinin, t'i jepej vëllait dhe bashkëluftëtarit që kishte pranë, i cili mezi i mblidhte forcat për të artikuluar nga buzët e zhuritura fjalën: Ujë.

Një ditë prej ditësh Ibn Umeri pati dëshirë të hante peshk, të cilin bashkëshortja ia përgatiti menjëherë. Në momentin që Ibn Umeri do të drejtonte dorën për të kapur kurmin e peshkut, trokiti dera. Përrjashta qëndronte një lypsar, i cili u kërkoi t'i jepnin sadopak nga peshku i skuqur, era e të cilit kishte dalë përjashta. Ibn Umeri kërkoi menjëherë nga e shoqja që peshkun e skuqur t'ia jepnin lypsarit, por bashkëshortja i propozoi që në vend të peshkut të skuqur t'i jepnin ushqim tjetër apo para sa të donte, por Ibn Umeri nuk pranoi dhe peshkun ia dha lypsarit për ta ngrënë. (Ibn Sad, Tabakat, IV, 165)

Mendoj se ne duhet t'i përjetojmë në ditët e sotme këto ndjenja në përputhje me frymën e këtij hadithi profetik: «Ushqimi i një personi, mjafton për dy vetë, ai për dy persona mjafton për katër vetë, ndërsa haja e katër personave mjafton edhe për tetë vetë. « (Ibn Hanbel, III, 301; Ibn Maxe, II, 1084)

# E SHTRENJTA VUAJTJA IME!

Mundimi, brenga, pikëllimi... janë të vërteta të hidhura të jetës. Janë fjalë të cilat thjesht vetëm kur i thua, ta ngushtojnë shpirtin, ta ndrydhin zemrën. Janë fjalë që veç nga disa shkronja përbëhen, por s'do mjaftonte pafundësia për t'i treguar. Të moçmit thoshin: "Si pluhuri i qilimit, ashtu edhe vuajtjet nuk kanë të mbaruar"...dhe me të vërtetë...ato nuk mbarojnë kurrë...nuk mbarojnë deri sa të soset bota.

Ai që është më i dituri thotë: "Për t'ju sprovuar juve krijuam jetën dhe vdekjen". Meqenëse jeta në këtë botë është një sprovë, atëherë domosdoshmërisht edhe mundimet do zgjasin deri në përfundim të sprovës.

Mendo sikur vetëm për një çast t'i shohësh vuajtjet nga një këndvështrim tjetër. Allahu i cili tek çdo e shëmtuar krijoi diçka të bukur, padyshim që edhe tek vuajtjet të cilat syri i sheh si labirinte pa fund e pa krye, ka krijuar një rrugëdalje.

Si mendoni? Allahu i cili pas skllavërisë jep mbretërinë, pas ndarjeve të dhimbshme jep bashkimin kur thotë: "Tek ajo që ju e shihni si të hairit mund të ketë sherr dhe tek ajo që ju e shihni si të sherrit mund të ketë hair" a mos kërkon nga ne të lëmë mënjanë ankimet e të pajtohem me vullnetin e Tij?

Miku im! Me të vërtetë vuajtja është e hidhur... por kur ikën të dhuron ëmbëlsinë. Mundimet, vuajtjet e bëjnë njeriun të aftë të mbartë këtë emër. Brengat e pastrojnë njeriun nga gjynahet, vuajtjet e largojnë nga egoja, e mbrojnë shpirtin nga helmi i zilisë, ambicies, e mbrojnë zemrën nga pasionet e sëmura. Shkëmbin e akullit të formuar nga krenaria dhe mendjemadhësia vetëm kandili i vuajtjes mund ta shkrijë. Atë qetësinë shpirtërore që bota e shkatërroi, vetëm melhemi i vuajtjes mund ta shërojë.

Dhe mbase... e dua! E dua! E dua shokun e sekreteve të mia në netët e errëta... E pranoj vuajtjen. Jam i lumtur. Sikur të hyj në xhennetin e Allahut jam i lumtur.

Janë pikërisht vuajtjet që më kujtojnë Pejgamberin...mbase pak, por unë i ngjaj atij. Dhe duke i ngjarë e ndjej më afër rrugën e tij...nganjëherë le të vuaj sepse nuk dua të ndahem prej tij... mos më ndani nga i Dashuri im.

Miku im! A mendon se të zhytur në pasuri, në ngrohtësi... në rehati i ngjajmë Profetit të përveuajtur? A mund ta gjejmë kështu këtë të dashur? A mund t'i çlirojmë kalatë e shpirtit tonë? Të lutem, ndal dhe mendo! Nuk janë shenjat e lumturisë së vërtetë pasuria, ngrohtësia, të qeshurat që lëshojmë kur nuk përmbahemi dot. Këto s'janë tjetër veçse një pluhur përvëlues që buron nga brendësia e pavuajtur, nga brendësia e padashuruar e genies sonë. Nuk kërkohet i Dashuri në shtëpitë si saraje, në mbledhjet plot argëtim... I dashuri shëtiti në shtëpi të vetmuara, në sofra të varfra, në zemra të përmalluara.

Mos harro! Profeti nuk hyri dhe u kthye nga shtëpia e vajzës së tij të dashur e cila kishte blerë një qilim të ri duke thënë: "S'më lidh asgjë me gjërat e kësaj bote".

Allahu që thotë: "Mua s'më zë asnjë vend përveç zemrës së robit tim" mund ta gjejmë vetëm në çastet e heshtura para agimit. Mos harro se myslimani shembullor që dëshiron Profeti, është ai njeri i dhënë pak pas kësaj bote dhe shumë pas përkuajtimit (dhikrit)... Ne me vuajtjet tona, duke u dridhur si Hz. Merjeme, Hz. Nuh, si Hz. Musa duhet të themi "Të dorëzohem vetëm Ty, o Allah" duke dhënë çdo gjë në rrugën e Tij.

Miku im! Nuk është e mundur që pa shkrirë





trupin, të mund të arrijmë në detet e shpirtit. Kur trokasin mundimet e vuajtjet, më parë duhet t'i hapim perden e zemrës në mënyrë që të hyjë në rrugën që të çon drejt bashkimit me Të. Duhet ta mirëpresësh vuajtjen për të shijuar kënaqësinë pas saj. Mos u dëshpëro për atë që të vjen nga Zoti yt. Kurrë mos thuaj "U shkatërrova nga vuajtjet".

Nëse thua dua të vdes pa m'u thyer qoftë edhe një herë zemra, nuk ke jetuar fare. Ashtu siç mbledh trëndafila në ferrishte, ashtu në bahçen e vuajtjes duhet të kërkosh lehtësimin. Duhet t'i pranosh vuajtjet për t'u larguar nga indiferentizmi, për të arritur në shkallën e të vlefshëmve, ku hap pas hapi përjeton emocionet që të jep bashkimi me Krijuesin. Duhet të vdesësh shpesh në mënyrë që të ringjallesh. Mos harro që ditët lindin nga netët, pranvera...nga dimri i acartë.

Kaderi im, fati im! E shtrenjta vuajtja ime! Ti që më dhurove bashkimin, ti që më pritë në ato net të mistershme, që më bashkove me Atë për të cilin më kishte djegur malli!

Sa shume që më mësove... jo 40 ditë, por sikur të bëhem gjithë jetën skllavi yt, nuk mjafton. Më edukove aq bukur sa që arrita të shijoj kënaqësi të largëta.

Çdo gjë e mësova nga vuajtja ime! Nganjëherë më shëtiti botën duke më hipur në një kalë të bardhë. Nganjëherë si zog me lartësoi

drejt botëve të tjera...Çfarë s'më tregoi...! Si një mësues i zoti më dha mësim. Më edukoi si një mësues morali. Më prezantoi me vetveten time. Ah dhimbja ime!... Sa e çuditshme është kjo botë... një botë larg kënaqësive të vërteta. Më lini të jetoj vetëm me Mikun e vërtetë. Bashkimin tonë mos e lëndoni me fjalë të kota. Mos merrni mundimin të më ngushëlloni sepse shkaktoni mbylljen e dritares nga e cila flas me Zotin tim, uljen e perdes së syve të mi që shohin dritën e Pejgamberit.

I dashur miku im! Nëse dëshiron të marrësh këshillë kur më pyet si mund të depërtoj tek kjo rrugë bashkimi, të them "me lotë", me lotët e brendësisë... sepse këta lot janë mëshirë, të pastrojnë nga gjynahet. Lotët janë frymëzim. Ato që s'arrin t'i lexosh, i lexon me to, ato që s'arrin t'i kuptosh, i kupton me lot. Ato janë gjuha ku flet me Allahun. Me lot duhet të blerojnë shpirtrat e shkatërruar... Me lot duhen hedhur rrënjët e pemës së shpresës në këtë botë të thatë... duhen derdhur farat hyjnore për frymëzimin e zemrave...lotët të shpëtojnë nga e keqja dhe të hedhin në thellësinë e oqeanëve të mëshirës. Çfarë s'sheh në këto oqeanë...! Qan duke vështruar dhe duke qarë kërkon edhe më tepër!

Ai moment! Pikërisht ai moment! Ku shpërthen mëshira, ku hapen dyert e qiellit, ku zbresin me mijëra melekë, pikërisht atë moment, duke treguar pafuqinë tënde kërkko nga Allahu. Duke thyer zinxhirët e egos kërkko! Kërkko duke i dhënë lamtumirën e fundit ambicies, zilisë...Jeto kënaqësinë që të dhuron takimi me Allahun, kur rrezet e dritës akoma nuk kanë çarë perden e natës. Mundohu të arrish lumenjtë e përjetësisë, aty freskoje zemrën e djegur. Bisedo atje me të Dashurin për të cilin të ka djegur malli. Qetësoje atje zemrën e lodhur, të vuajtur, të mjerë. Mos u largo asnjëherë nga pragu i asaj dere... derisa të dëgjosh nga Allahu fjalët "Urdhëro robi im"...!

# *Re përdhe! Pse nuk ngrihesh?*

Të fitojmë pëlqimin e Allahut është një nga përpjekjet më të rëndësishme të jetës si në planin individual, ashtu edhe në atë shoqëror. Për ta realizuar këtë është e domosdoshme të bësh përpjekje dhe sakrifica të vazhdueshme. Ngathtësia dhe dobësia më e vogël në këtë fushë, mund të hapë plagë të rënda, kurimi i të cilave brenda shoqërisë është shumë i vështirë. Në këtë këndvështrim Profeti ynë Muhamedi (a.s.) që në vitet e para të predikimit të fesë Islame i ka kushtuar një kujdes tepër të veçantë mësimin të fesë, të jetuarit të saj dhe transmetimit të saj tek të tjerët. Pikërisht për këtë ai qe shembulli më i qartë.

Popujt që kanë ndjekur gjurmët e këtij shembulli kaq të përkryer kanë qenë të lumtur në të dy botët. Nën dritën e ajeteve të zbritura nga Allahu

i Lartë dhe të urdhëresave peygamberore besimtarët i kanë konsumuar përherë të gjitha fuqitë dhe mundësitë fizike e financiare në rrugë të Allahut. Por në disa periudha kur kushtet kanë qenë mjaft të vështira ngathtësia ka filluar të shfaqë vetveten dhe menjëherë pas kësaj kanë mbërritur paralajmërimet hyjnore. Një nga këto ka qenë edhe mobilizimi i përgjithshëm i bërë gjatë shpalljes për marshimin drejt Tebukut.

Kur myslimanët u urdhërua të dilnin për në luftën e Tebukut, ata sapo ishin kthyer nga Hunejni dhe Taifi. Edhe koha kishte qëlluar në një periudhë kur ndikonte i nxehti i verës dhe skamja vazhdonte të mbizotëronte. Vendi për ku do të shkohej ishte larg, ndër-sa armiqtë ishin të shumtë në numër, të fuqishëm dhe të armatosur. Kjo ishte arsyeja që

nevojat për këtë luftë të ishin më të shumta se në luftërat e tjera. Shpallja e mobilizimit shumëkujt i kishte ardhur rëndë për shkak të kushteve të vështira. Në disa besimtarë këto vështirësi dhe ky lloj dembelizmi për të marrë pjesë në radhën e ushtrisë ishte shfaqur më dukshëm. Pas kësaj zbritën këto ajete Kur'anore:

**“O besimtarë! Çfarë keni që ngurroni e mbërtheheni fort për toke kur ju thuhet: “Dilni në luftë në rrugën e Allahut?! A jeni të kënaqur me jetën e kësaj bote në vend të asaj së amshueshme?! Kënaqësia e kësaj bote, në krahasim me atë të botës tjetër, është shumë e vogël.”(et-Tevbe, 38)**

Kuptimi i shprehjes “ngurroni dhe mbërtheheni fort për toke” që kalon në ajete, është shprehur me fjalën “Issakal-





tum". Kjo fjalë në kuptimin leksikor të saj përshkruan një njeri që tregohet dembel për të bërë një punë dhe duke e marrë me shumë vështirësi atë, mbetet i rrëzuar përtokë. Në këtë formë ajeti përmban këto kuptime: Çfarë ju ndodhi juve kur u thuhet: "Mobilizohuni në rrugë të Allahut", u rrëzuar menjëherë për tokë, e morët me shumë vështirësi punën duke humbur nën ndikimet e vështirësitë duke u marrë me meditimet e kësaj bote, treguat dembelizëm, ju erdhi rëndë që të mobilizoheshit në rrugë të Allahut, u zbrapsët nga frika dhe tensioni dhe të gjithë këto nuk janë gjë tjetër vetëm parandjenja të këqija që e largojnë njeriun nga xihadi dhe shërbimi. Myslimani është i detyruar që të bëjë përpjekje dhe të mos paraqesë asnjë lloj preteksti për ato që duhen bërë. Në ajetin Kur'anor ata të cilët nuk i japin rëndësi urdhrat të luftës dhe ata të cilët e marrin me përtesë punën, janë poshtëruar dhe qortuar rëndë. Duhet të kemi të qartë se marrja me përtesë e punës nuk ka ndodhur te të gjithë myslimanët. Por fakti që disa individë të grupit, i cili e ka të detyrueshme të lë-

i prekin të gjithë myslimanët. Për këtë arsye thirrja që bëhet në ajetin Kur'anor, i drejtohet të gjithë besimtarëve pa bërë dallim. Në mënyrë të veçantë prej këtu kuptojmë se besimtarët që bënin përpjekje për të qenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që ka detyra, njëkohësisht ndjeheshin përgjegjës që të nxitnin dhe t'u tërhiqnin vëmendjen vëllezërve të tyre që vepronin me nge ndaj urdhrave të Allahut. Kështu vazhdojnë edhe këshillat e Allahut të Lartë:

**"Nëse nuk shkoni në luftë Ai do t'ju ndëshkojë me dënim të dhembshëm dhe do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër. Ju nuk do të mund t'i bëni dëm aspak Atij sepse Allahu është i fuqishëm për gjithçka."** (et-Tevbe, 39)

Sipas shprehjes së ajetit kur'anor nëse besimtarët nuk marrin pjesë të gjithë së bashku në luftën në rrugë të Allahut, Ai do t'i dënojë ata me një dënim të dhembshëm dhe do t'ju sjellë atyre fatkeqësi prej së cilave nuk do të shpëtojnë lehtë. Ai do t'u marrë nga duart e tyre botën, të cilën ata ose

e kanë braktisur, ose e kanë lënë mënjanë për hir të joshjeve drejt të cilave kanë shkuar, për shkak të arsyeve shumë të dhembshme, si: skamja, varfëria, humbja dhe dënimi dhe do t'i lërë ata në një gjendje të mjerrueshme. Ai do t'i marrë prej tyre tokat dhe vendbanimet që zotërojnë dhe do t'ua japë ato një popull tjetër. Urdhrat e tij Ai do t'i realizojë nëpërmjet këtyre të dytëve. Meqenëse lënia pas dore e përpjekjeve në rrugë të Allahut do të bëhet shkak i humbjes së mirësive dhe vlerave aktuale dhe i meritimit të dënimit hyjnor, Allahu Teala urdhëron e thotë për t'u treguar besimtarëve rrugën e shpëtimit:

**"Dilni në luftë qofshi të shëndoshë ose të sëmurë dhe luftoni me pasurinë dhe jetën tuaj në rrugën e Allahut! Kjo është më mirë për ju. Sikur ta kuptonit!"** (et-Tevbe, 41)

Në këtë këndvështrim kur t'u thuhet myslimanëve "Dilni në rrugë për Allahun!", ata menjëherë duhet të jenë të gatshëm shpirtërisht për këtë rrugë, u vjen e lehtë apo e rëndë, të rinj a të moshuar të jenë, be-

Në ajetin Kur'anor ata të cilët nuk i japin rëndësi urdhrat të luftës dhe ata të cilët e marrin me përtesë punën, janë poshtëruar dhe qortuar rëndë.



“Nëse nuk shkoni në luftë (kur ju thërret nevoja) Allahu do t’ju ndëshkojë me dënim të dhembshëm dhe do t’ju zëvendësojë me një popull tjetër. (et-Tevbe, 39)

qarë apo të martuar, me punë apo të papunë, të varfër apo të pasur. Pra sido që të jetë situata e tyre ata duhet të vrapojnë në rrugën e Allahut pa pritur aspak së bashku me pasuritë e tyre. Sjellja e tyre në këtë mënyrë do të jetë më e dobishme dhe më me vlerë për ta. Fjalja “Kjo është më mirë për ju. Sikur ta din!” e shprehur në fund të ajetit është tregues se përpjekja dhe lufta në emër të Allahut, apo siç njihet në terminologjinë islame xihadi, është me vlerë dhe dobi. Meqenëse thelbi i punës është të dish se ç’është më me vlerë dhe më me dobi, atëherë besimtarët duhet të kthjellohen në mendjet dhe të ndër-gjegjësohen në shpirtrat e tyre rreth kësaj teme. Umer bin Hat-tab kishte dhënë këto urdhra kur kishte qenë në krye të ushtarëve:

“Bëhuni fakih në fe! (pra konceptoni detajet e fesë!) Pasi një person nuk mund të quhet fajtor se shkon pas besëtytnive kur nuk e di të vërtetën!” (Ken-zu’l Ummân, V, 228)

Në mënyrë të veçantë është e nevojshme që njeriu para se të njohë armiqtë e tij të jashtëm të njohë vetveten dhe kjo është lufta që ai bën ndaj epshit të tij. Kjo quhet ndryshe edhe “xihadi i madh”. Njeriu duhet të jetë shumë i kujdesshëm përballë dëshirave të veta epshore dhe vesveseve të shejtanit, gjithmonë në përpjekje dhe në shërbim në rrugë të Allahut. Kjo pasi edhe një shkujdesje, një abuzim apo një mëdyshje sado e vogël mund të lindë përfundime shumë të dhembshme. Sa kuptimplote dhe rrën-



thëse është kjo ngjarje që rrëfen se pse për hir të Allahut duhet që të japësh shpirt me dëshirë dhe se çfarë përfundimesh do të lindin në rast të kundërt:

Në luftën e Mutes patën rënë shehid tre komandantë të rëndësishëm nga ashabët e Profetit. I dërguari i Allahut duke u ngjitur në minber po u transmetonte ashabëve me detaje të gjithë vijimësinë e luftës: “Zejd bin Harise mori në dorë flamurin. Shejtani menjëherë i shkoi pranë. Ai ia paraqiti jetën dhe botën shumë të dashur ndërsa vdekjen shumë të shëmtuar

dhe jo të këndshme. Kurse Zejdi tha: “Ky çast është një kohë në të cilën besimtarët do të forcojnë besimin në zemrat e tyre! Ndërsa ti po më bën që të dua botën?!”

Profeti vazhdoi: “Hyri në dyluftim dhe më në fund ra shehid”. U ngrit, i fali namazin e xhenazes dhe iu drejtua myslimanëve duke u thënë: “Kërkoni falje prej Allahut për të!”

Më pas Muhamedi (a.s.) injoftoi edhe për rënien dëshmor të Xhafer bin Ebi Talib duke u treguar se ai ka udhëtuar në xhenet me dy krahë prej rubini siç ka dëshiruar, dhe më pas vazhdoi:

“Pas Xhaferit flamurin e mori Abdullah bin Revaha”.

Më pas pushoi për një çast. Fytyrat e ensarëve ndryshuan dhe u zverdhën. Menduan se mos kanë bërë gjëra të padëshirueshme dhe të papëlqyeshme për Abdullah bin Revaha. Ndërsa ai në atë moment merr flamurin, hipën në kalë dhe duke iu drejtuar armikut në një rën anë po përpiquej që të përmirësonte nefsin e tij të pabindur.

“O nefsi im! Unë t’u betova ty që do t’i përullem vetes sime. O ti pranon vetë, ose unë të bëj që të pranosh me zor!... E shoh që nuk të pëlqen edhe aq xheneti!... Çfarë je ti tjetër veçse një pikë uji i ngjizur? O nefsi im! Nëse ti nuk vritesh tani, mendon se nuk do të vdesësh nesër?... Nëse bën atë që bënë më parë ata dy sahabë dhe



nëse e pranon martirizimin në rrugë të fesë, atëherë bën një punë të mirë. Por nëse vonon atëherë shkatërrohesh!”

Në këtë kohë Abdullahu i plagosur në gisht zbrit nga kali. Gishtin e tij të plagosur e futi nën këmbë. A nuk je ti vetëm një gisht që rrjedh, o i gjakosur? Në një anë ai bën një xhihad të vogël dhe nga ana tjetër vazhdon një xhihad të madh.

O shpirti im! Nëse frika ime vjen nga mendimi se mbes i vetmuar prej gruas, unë atë e ndava me tre formula shkuro-rëzimi (talak). Nëse vjen nga qëndrimi im larg skllëverve edhe ata i lashë të lirë. Por nëse mëdyshja jote vjen ngaqë kam toka të pasura edhe ato i lashë në emër të Allahut”

Ndërkohë që ushtria islame po shfaqte trimëri të jashtëzakonshme Pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.), vazhdonte të transmetonte skenat e luftës:

Abdullah bin Revaha i forcoi këmbët e tij, dhe ashtu siç ishte

me flamur u përlesh me armikun duke rënë shehid. Hyri në xhennet duke luftuar. Prandaj edhe kërkoni falje nga Allah.

Ky fakt i Abdullahut u erdhi shumë rëndë Ensarëve.

O i dërguari i Allahut! Cili ishte kundërshtimi i tij?

Pejgamberi ynë tha:

Kur ai u plagos u tërhoq nga përleshja me armiqtë. Më pas e fajësoi veten e tij, mori kurajo dhe ra shehid! Hyri në xhenet. Ata mu shfaqën mua në xhenet të ulur mbi frone mbretërore. Unë pashë që froni i Abdullahut ishte më poshtë dhe më i shtrembët se i shokëve të vet. Kur pyeta për shkakun më thanë:

Kur u fut në betejë Abdullahu pati disa dyshime dhe ngurtime.

Ndërsa u tregonte këto ngjarje myslimanëve nga sytë e Profetit Muhamed (a.s.) rridhnin lot. (*Ahmed bin Hanbel, Musned, V, 299, III, 113; Ibn Sad, Tabakat,*

*III, 46, 530; Vakidi, Megazi, II, 762; Ibn Hisham, Sire, IV, 17-18)*

Ja pra se çfarë përfundimesh të tmerrshme u hap rrugë mëdyshja shpirtërore më e vogël për të dalë në rrugë të Allahut! Momenti në të cilën këmba rrëshqet dhe njerëzit ndodhen në rënie, është i lidhur me nisabin e shpirtit më shumë se sa me mallin që zotëron. Allahu i Lartë dëshiron që robët e Tij t’i dorëzohen Atij, t’i zbatojnë urdhrat e Tij pa iu dridhur qerpiku dhe me përkushtim të madh, të mos shfaqin asnjë lloj lëkundjeje përpara kësaj bote dhe të blejnë xhenetin me pasuritë dhe shpirtrat e tyre. Besimtari duhet të tregojë kujdes të madhe dhe të sakrifikojë sa të ketë mundësi në mënyrë që mos ta hedhë jetën e tij në rrezik duke qëndruar indiferent në këto aspekte. Çdo njeri që ka problem ahiretin duhet ta sistemojë dhe rregullojë jetën e tij duke meditaruar thellë mbi ajetet e lartpërmendura në mënyrë që të mos privohet nga këto mirësi hyjnore.

## TE QASH APO TE QESHESH ?

*“Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje të sigurt, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëritjetrit të vërtetën dhe durimin” (el-Asr)*

Jeta që na ka dhënë Krijuesi i gjithësisë si amanet kalon shumë shpejt. Askush nuk mund ta di se kur mund të na kërkohet që ta kthejmë këtë amanet të çmuar. Prandaj gjithmonë duhet të jemi të përgatitur, se nga momenti në moment mund të na vij thirrja.

Do të vijë momenti që edhe ne një ditë do shtegtojmë si zogjtë nga ky vend. Duhet bërë përgatitjet e duhura për kohën kur njerëzit të përballen me të vërtetën, kur do ta kuptojnë që kjo jetë s’paska qenë gjë tjetër veçse një ëndërr. Momenti kur njerëzit të zhgënjyer nga vetvetja do të thonë “ah sikur”.....do jetë çdo gjë e kryer. Nuk do na bëj dobi asgjë përveç veprave të mira. Kjo jetë është shumë e shkurtër, fluturon si era.

Jeta është shumë e shkurtër dhe kalon si një stuhi.

Për të mos thënë “Ah sikur.....” kur të jemi përpara Krijuesit të gjithësisë duhet që jetën ta kalojmë me adhurim, çdo mundësi tonën duhet ta shfrytëzojmë për të bërë punë të pranueshme tek Allahu (xh.sh.). Për të parë bukurinë hyjnore

duhet që çdo punë që veprojmë të jetë vetëm për Krijuesin e gjithësisë. Çdo lëvizje dhe veprim i yni duhet të jetë një hap më afër drejt Allahut (xh.sh). Është mirë që të mos mbytemi në punët e kësaj bote dhe të mos bëhemi skllëvër të epsheve. Ta dëshirojmë jetën e përhershme dhe të punojmë sa më shumë për ta merituar shpërblimin që Krijuesi ka përgatitur për njerëzit që i binden urdhrave të Tij. Krijuesi i gjithësisë i përgëzon ata që i binden urdhrave të Tij me fitimin e sigurt dhe të përhershëm, pasi që tek Ai gjendet drejtësia absolute.

Kush i përballon helmet dhe hidhërimet e kësaj bote, në botën tjetër sheh shpërblimin e Tij të pakufishëm, e kush u lodh dhe mbeti i rraskapitur këtu, atje gjen shpëtim të rehatshëm dhe të pafund. Kurse të lidhurit ngushtë me këtë të shkurtrën jetë dhe adhuruesit e kënaqësive të saj mbeten të pangopur, ndaj kur këmbët ua prek zjarri i kësaj jete menjëherë bien poshtë, qëndrojnë të shqetësuar duke vajtuar momentet e ëmbla që u mbeten pa përjetuar, për shkakun se ata kanë vetëm këtë jetë, tjetrën as që duan ta çojnë ndër mënd.

Njeriu duhet t’i përkujtojë dhuntitë që ia ka dhënë Allahu (xh.sh.), t’i hedh një vështrim trupit të tij nga koka deri tek këmbët dhe të thellohet mirë në ato që zotëron. Do të bindet shumë shpejt se sikur të qëndrojë natë e ditë duke e falënderuar Allahun për këto të mira përsëri do të ishte e pakët, sepse ky falënderim nuk mjafton përpara asaj që ai zotëron.





Njeriu duhet t'i përkujtojë dhuntitë që ia ka dhënë Allahu (xh.sh.), t'i hedh një vështrim trupit të tij nga koka deri tek këmbët dhe të thellohet mirë në ato që zotëron. Do të bindet shumë shpejt se sikur të qëndrojë natë e ditë duke e falënderuar Allahun për këto të mira përsëri do të ishte e pakët, sepse ky falënderim nuk mjafton përpara asaj që ai zotëron.

Allahu (xh.sh.) na lajmëron se në qoftë se një njeri, i cili ka rrëshqitur dhe është zhytur në mëkate, ulet dhe me plot sinqeritet pendohet dhe kërkon falje për mëkatet e bëra, atij do t'i falen. "Thuaj. O robërit e mi që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, sigurisht, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i Madh dhe Mëshirëploti. (Zumer, 53)

Do të ishte një fatkeqësi e madhe sikur të mos i përgjigjeshim kësaj thirrjeje hyjnore. Njeriu vazhdimisht duhet të përgatitet për një të nesërme që është e sigurt. Duhet ta dijë që Krijuesi i gjithësisë është në dijeni të çdo gjëje që veprojnë krijesat e tij.

Allahu (xh.sh.) në një farë mënyre e paralajmëron njeriun për të gjitha pengesat që do hasë gjatë gjithë jetës, në varr, në mahsher si dhe kur të jemi para Tij. Kjo është një mëshirë që Allahu tregon për njerëzit. Duket sikur na i jep të gjitha pyetjet e zgjidhura para se të hyjmë në provim. Për fat të keq njeriu nganjëherë i harron të gjitha këto dhe bëhet rob i epsheve, harron që një ditë do të vdesë dhe do jap llogari për çdo vepër të

tijën. Duke vepruar kështu njeriu me vetëdije humbet mëshirën e Krijuesit të gjithësisë.

Iku edhe një ditë nga jeta jonë. Në vend që ta kalojmë me punë të mirë dhe të dobishme, për fat të keq e kalojmë duke u argëtuar me gjëra kahlitare. Njeriu duhet të bëjë punë të cilat nuk do ta turpërojnë, nuk do ta bëjnë që të skuqet fytyra e tij kur të jetë para Krijuesit të tij.

Padyshim që mire ose keq ka kaluar një pjesë e jetës sonë, sikur të japim me miliona nuk e kthejmë dot prapa. E rëndësishme është sa nuk është vonë të pendohemi për mëkatet që kemi bërë dhe të kërkojmë falje nga Krijuesi i gjithësisë.

"Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrohuni Atij, para se t'ju vijë dënimi, sepse atëherë nuk do mund t'ju ndihmoj askush". (Zumer, 54)

Do të vijë momenti kur s'do ketë asgjë vlerë përveç veprave tona të mira. Atëherë kur njeriu të thotë ah sikur!.....do jetë shumë vonë. Ai që e di se çfarë është amaneti nuk mund ta shpërdorojë jetën e cila i është dhënë si amanet nga Allahu (xh.sh.) vetëm për një kohë shumë të shkurtër.

Gjithsesi njeriu duhet ta dijë që dera e mëshirës së Krijuesit të gjithësisë është gjithmonë e hapur.



Harun Jahja

## SOLIDARITETI DHE BASHKËPUNIMI NË BOTËN E QENIEVE TË GJALLA

Uniteti, bashkëpunimi, vetësakrifica dhe dashuria që vërehet në gjirin e qenieve të gjalla e zhvlerëson krejtësisht teorinë e evolucionit, e cila i sheh gjallesat si qenie tërësisht egoiste dhe të pamëshirshme, në garë të vazhdueshme lufte për jetesë. Në të vërtetë evolucionistët e kuptojnë shumë mirë këtë harmoni dhe unitet që ekziston ndërmjet kafshëve, por ajo që përpiqen të bëjnë ata është përputhja e kësaj tabloje solidarizim tek kafshët me teorinë e evolucionit.

Për shembull evolucionisti i njohur Peter Kropotkin nga vrojtimit dhe kërkimet e tij në Siberinë lindore vuri re që ndërmjet kafshëve ekzistonte një bashkëveprim i habitshëm. Ishte kjo dukuri mahnitëse që e shtyu Peter Kropotkin të shkruaj një libër mbi këtë fenomen.

Për bashkëveprimin ndërmjet kafshëve Kropotkin në librin e tij ndër të tjera shkruan:

“Në kërkimin dhe përpjekjen tonë për argumentimin e konceptit “luftë për jetesë” gjëja që na habiti jashtë mase të gjithëve ishte vrojtimi i një numri të madh shembujsh mbi ndihmën e ndërsjellët që ekzistonte tek kafshët. Kjo ndihmë e ndërsjellët nuk ekzistonte vetëm për të bërë të mundur vazhdimin e jetës siç pretendojnë evolucionistët, por kjo ndihmë dhe përkrahje ekzistonte edhe në sigurimin e ushqimit dhe të jetës. Në botën e kafshëve ndihma dhe bashkëpunimi i ndërsjellët është rregull parimor. Ndihma e ndërsjellët në botën e kafshëve mund të vihet re edhe në qeniet më primitive.

Megjithëse një evolucionist, Kropotkin, përballë gjithë këtyre argumenteve u detyrua të bënte një shpjegim krejt ndryshe, që bie në kundër-

shtim të plotë me parimet e teorisë së evolucionit. Siç do ta shohim në shembujt e mëposhtëm ndihma dhe bashkëveprimi ndërmjet gjallesave dhe specieve të ndryshme ka një rëndësi jetësore për të siguruar kushte optimale jetese. Ky rregull dhe ekuilibër i përsosur që ekziston në natyrë është nga argumentet e qarta dhe të shumta që tregojnë për madhështinë e fuqisë së Allahut (xh.sh.) Ata që kanë qenë dëshmitarë të këtyre fenomeneve të jashtëzakonshme ku qeniet e gjalla pa ndërgjegje dhe arsye sillen si qenie me ndërgjegje dhe arsye, kanë mbetur të impresionuar dhe të mahnitur.

Një nga këta dëshmitarë të mahnitur nga sjelljet njerëzore ndërmjet kafshëve është edhe shkencëtari i njohur në fushën e fiziologjisë dhe mjekësisë Kenneth Walker.

Shikoni, si na i përcjell ai vëzhgimet e bëra në Afrikën e Jugut:

“Shumë vite më parë, nga vrojtimit që bëra në Afrikën e Jugut është akoma e gjallë në kujtesën time ndihma dhe mbështetja reciproke që ekzistonte ndërmjet kafshëve.

Në rrafshnaltën e Afrikës Lindore u bëra dëshmitar se si një tufë me zebra dhe sorkadhe për të paralajmëruar njëra-tjetrën përballë çdo rreziku në vende të caktuara kishin vendosur roje. Pothuajse ishte e pamundur të gjuaje për sorkadhe, sepse sapo t’i afroheshe njërës, zebra roje e ndjente rrezikun dhe i lajmëronte menjëherë sorkadhet e tjera.

Përsëri u bëmë dëshmitarë të qëndrimit së bashku të gjirafave dhe elefantëve. Dimë se

elefantët i kanë shqisat e dëgjimit tepër të ndjeshme, por shqisat e shikimit mjaft të dobëta. Kurse gjirafat me shikimin e tyre të mprehtë luanin rolin e rojeve të vendosur në kullat e vrojtimit.”

Në këtë bashkim forcash midis gjirafave dhe elefantëve ishte e pamundur t’u afroheshe pa u vënë re. Një shembull tjetër mjaft interesant nga bashkëveprimi midis kafshëve është edhe ai i rinocerontit me zogjtë, të cilët qëndrojnë mbi kurrizin e këtyre kafshëve gjigande, duke u ushqyer me insektet që jetojnë duke thithur gjak nga lëkura e tyre. Këta zogj në të njëjtën kohë luajnë edhe rolin e rojës për rinocerontin. Ata sapo të shohin apo të nuhasin ndonjë rrezik që po afrohet menjëherë e lajmërojnë rinocerontin për rrezikun që e pret”

Këto vëzhgime të bëra nga ana e Kenneth Walker janë vetëm një pjesë e vogël e shumë shembujve të bashkëpunimit dhe solidaritet që ekziston në botën e larmishme të kafshëve. Çdo njeri mund të bëhet dëshmitar i shumë rasteve të tilla të bashkëpunimit midis kafshëve. Është shumë e rëndësishme për njeriun që të nxjerrë mësim nga këta shembuj mbresëlënës.

Një qenie që është krijuar krejt rastësisht dhe që gjithë jetën e kalon duke luftuar për të siguruar ekzistencën e vet, a është e mundur që të jetë kaq e arsyeshme dhe të bëjë kaq sakrificë, jo vetëm për kafshët e llojit të vet, por edhe për kafshët jashtë llojit të saj. A është e mundur të ndodhin të gjitha këto dukuri mahnitëse krejt rastësisht siç pretendojnë evolucionistët? Padyshim që jo. Një qenie e krijuar rastësisht dhe pa ndërgjegje është e pamundur të gjendet në sjellje kaq të arsyeshme dhe të vetëdijshme. Nuk mund të imagjinohet që një qenie pa arsye të arrijë të sakrifikojë veten për të mbrojtur të tjerët. Të gjithë këta shembuj nga bota e kafshëve janë argumente të qarta për ekzistencën e Allahut, dhe është pikërisht Ai që i ka pajisur kafshët me këto veçori mahnitëse.

Qeniet e gjalla kur nuhasin ndonjë rrezik lajmërojnë njëra-tjetrën.

Një nga avantazhet më të mëdha të jetës në kope është edhe sigurimi i një mbrojtje sa më të mirë. Një nga kafshët sapo nuhat rrezikun, me gjithë mundësitë që ka përpiket të lajmërojë edhe kafshët e tjera. Çdo lloj qenie ka sistemin e vet tipik të dërgimit të sinjaleve lajmëruese.

Për shembull lepujt dhe disa drerë sapo të parandiejnë rrezikun ngrenë në mënyre vertikale bishtin dhe me këtë formë japin sinjalin ‘sos’ për kafshët e tjera. Kurse sorkadhet bëjnë disa kërcime tipike në raste rreziku.

Një sërë zogjsh të vegjël sapo nuhasin afrimin e armikut, japin alarmin duke cicëruar.

Kurse harabelat kur parandiejnë rrezik lëshojnë disa tinguj me frekuenca të shkurtra që njeriu i dëgjon në formë fishkëllime. Mosdallimi i drejtimit se nga vjen fishkëllima është një veçori interesante e këtyre tingujve, ky është një avantazh për tufën e zogjve. Duke qenë se është e pamundur dallimi se nga vjen zëri, zogu, jo vetëm që ndihmon tufën e zogjve, por në të njëjtën kohë nuk tërheq drejt vetes rrezikun duke e ulur në minimum rrezikun.

Edhe tek insektet që jetojnë në koloni ndodh e njëjta dukuri. Insekti që nuhat rrezikun lajmëron gjithë koloninë, por insekti që lëshon sekrecion me një erë karakteristike tërheq drejtë ve-





tes rrezikun, ai me këtë mënyrë është i gatshëm të sakrifikojë veten .

Tek një lloj urithi që jeton në koloni në Amerikën e Veriut, foletë janë të ndara, në çdo fole jetojnë afërsisht 30 urithë. Interesant është fakti që të gjithë njihen me njëri-tjetrin. Në çdo hyrje dhe dalje tuneli në një vend të lartë ku mund të shikohet nga të gjitha drejtimet, qëndron urithi roje. Urithi roje sapo të nuhasë rrezikun, me një tingull jep sinjalin “sos” për një grup urithësh, ku këto të fundit lëshojnë një tufë sinjalesh që përhapen ndër kafshët e tjera në formë vale nga një grup në një grup tjetër deri sa arrin në gjithë vendbanimet. Është shumë impresionant fakti që kafshët sinjalizojnë njëra-tjetrën për rreziqet që u kanosen. Por më mahnitëse dhe e rëndësishme është aftësia e tyre për të komunikuar, për t’u kuptuar kafshët ndër veti. Siç e pamë më sipër në shembullin e lepurit ku të gjitha kafshët ngritjen e bishtit të lepurit vertikal e perceptojnë si sinjal rreziku dhe menjëherë pas sinjalit marrin masat e duhura, nëse u duhet të fshihen, nëse u duhet të vrapojnë, vrapojnë. Ajo që e bën njeriun të mendojë rreth këtij fenomeni është nevoja e veprimit në grup. Si është e mundur që të jenë marrë vesh ndër veti për t’u larguar në një drejtim të caktuar sapo të marrin sinjalin “sos”.

Shpjegimi i vetëm është se këto kafshë janë krijuar dhe programuar nga Allahu.

Nuk mundë të anashkalohet sjellja mjaft e arsyeshme dhe e vetëdijshme në shembullin midis zogut dhe rinoceronit ku zogjtë lajmërojnë rinoceronin për rrezikun që i kanoset dhe ky menjëherë merr masat e duhura sipas perceptimit të sinjalit. Është e pamundur që të ndodhë një komunikim i tillë rastësisht ndër kafshët. Kjo na çon në përfundimin se të gjitha sjelljet që ekspozojnë kafshët përballë çdo situatë specifike u janë mësuar atyre nga i gjithëfuqishmi dhe i gjithëmëshirshmi Allah.

Kafshët përballë çdo rreziku bashkëveprojnë midis tyre

Kafshët që jetojnë në kope jo vetëm që lajmërojnë njëra-tjetrën në rast rreziku, por në të njëj-

tën kohë i kundërvihen së bashku atij. Për shembull, zogjtë e vegjël, skifterët dhe bufat kur hyjnë në zonën e shpendëve grabitqarë, bashkohen në tufa të mëdha duke paraqitur sjellje agresive në mënyrë që të mbajnë larg prej tyre shpendët grabitqarë.

Gargujt fluturojnë në tufa, duke mbajtur një distancë të konsiderueshme nga njëri-tjetri, por sapo dallojnë një skifter menjëherë e mbyllin hapësirën boshe ndërmjet tyre duke e vështirësuar shumë depërtimin e skifterit në mes të tufës, dhe në rast se do të tentonte ta bënte një gjë të tillë, do dëmtonte pendët.

Nga bashkëveprimi përballë rrezikut edhe familja e gjitarëve nuk bën përjashtim.



Për shembull, zebra të vegjlit e tyre i fusin në mes të kopesë. Një shembull mjaft interesant të bashkëpunimit midis zebrave e jep shkencëtari anglez Jane Goodall. Gjatë vëzhgimeve që ka bërë në Afrikën Lindore ai ka qenë dëshmitar i një sulmi ndaj zebrave. Gjatë largimit nga zona e rrezikut 3 zebra mbesin mbrapa, ndërsa zebra të tjera sapo dallojnë që tre shoqet e tyre janë në rrezik, kthehen menjëherë pas duke përplasur këmbët për tokë dhe kërcëllojnë dhëmbët. Në këtë mënyrë shpëtuan 3 shoqet.

Në përgjithësi kur zebra të përballen me një rrezik, zebra lider qëndron në fund, të vegjlit dhe femrat vrapojnë para, kurse meshkujt qëndrojnë në fund të tufës duke vrapuar në mënyrë zigzage dhe hedhur shqelma.

Edhe delfinët lëvizin në grup dhe i kundërvihen së bashku peshkaqenit, armikut të tyre më të rrezikshëm. Kur peshkaqenët u afrohen të vegjëlve të delfinëve, dy delfinë ndahen nga grupi duke tërhequr vëmendjen e peshkaqenëve drejt vetes, në këtë çast me të shpejtë një grup delfinësh rrethojnë peshkaqenin dhe fillojnë t'ia japin goditje të forta.

Por një sjellje tjetër me interesante e delfinëve është fakti se ata notojnë së bashku me peshqit e vegjël ton dhe ushqehen me peshk ton, por qëllon shpesh që në rrjetat e hedhura për peshk ton të mbesin delfinë, në raste të tilla delfini duke mos kryer dot procesin e frymëmarrjes shokohet, futet në panik dhe fillon të



bjerë poshtë në fund të detit, pjesëtarët e tjerë të familjes menjëherë vrapojnë në ndihmë për ta nxjerrë nga fundi i detit në sipërfaqe atë.

Kur plagoset një balenë gri, e ndihmojnë një ose më shumë balena meshkuj dhe për të kryer procesin e frymëmarrjes e mbajnë në sipërfaqe të ujit balenën e plagosur.

Drerët përballë një armiku agresiv në vend që të largohen formojnë një rreth fortifikues ku në mes qëndrojnë të vegjlit. Kur një dre mashkull sulmon armikun për të mos u krijuar hapësirë boshe në rrethin e formuar kthehet menjëherë në vendin e tij.

Bashkëpunimi midis kafshëve nuk ekziston vetëm në rast rreziku, por edhe në sigurimin e ushqimit. Për shembull, pelikanët gjuajnë

peshk gjithmonë në grup.

Të gjithë së bashku formojnë një rreth dhe vijën duke e ngushtuar atë për të kapur të gjithë peshqit që futen në rreth.

Uniteti, bashkëpunimi, vetëmohimi, harmonia dhe dashuria që vërehet në gjirin e qenieve të gjalla të bën të mendosh thellë, sepse këto nuk janë qenie njerëzore që mendojnë, logjikojnë dhe arsyetojnë, por janë kafshë pa arsye dhe pa logjikë.

Si e kuptojnë elefantët kohën e lindjes së një pjesëtari të familjes që me nxitim i shkojnë në ndihmë? Si është e mundur që kafshët kuptohen aq mirë me njëra-tjetrën kur ata nuk kanë aftësi për të logjikuar dhe menduar? Këto janë pyetje që duhet t'ia bëjë çdo njeri vetes.

Është çmenduri të thuash që këto sjellje të virtytshme të kafshëve janë pasojë e vullnetit të tyre të lirë. Përballë këtyre dukurive një njeri me mendje të shëndoshë do të arrinte në përfundimin se: Çdo gjë në natyrë është vepër e të Gjithëdijshtimit dhe Gjithëfuqishtimit Allah. Ai është Zoti që ka krijuar pa përjashtim të gjitha qeniet e gjalla dhe jo të gjalla. Ne duhet të mendojmë thellë mbi këto ajete kuranore:

Falënderimi i goftë vetëm Allahut, Zotit të qiejve, Zotit të tokës, Zotit të gjithësisë. Vetëm Atij i takon lartmadhëria në qiej dhe në tokë. Ai është ngadhënyyesi, më i urti! (Xhathije,36-37)

Zot i qiejve dhe i tokës dhe ç' ka mes tyre, i Plotfuqishmi, Mëkatfalësi! (Sad,66)

Është shumë e qartë që të gjitha fenomenet që ndodhin në natyrë janë argumente dhe prova të qarta për ekzistencën e Krijuesit dhe Ai krijues është i madhi, i urti, i gjithëmëshirshmi Allah.

# SIKUR TE ARRINIM QOFTË DHE 1%...

Kur thuhet “njeri i formuar” nga ana teknike për herë të parë në mendjen tonë vjen ky përkufizim: njeri i zoti, me profesion mjeshër etj.

Menjëherë duhet t’ju kujtojmë se do të ishte jo e drejtë po qese do ta përkufizonim me termi “njeri i formuar” si një makinë e cila është prodhuar posaçërisht për të bërë detyrën mirë. Por duhet të pranojmë se në një farë mënyre vrojtimi i kësaj makine është pothuajse i detyruar. Dimë se programet e detyruara të vrojtimin mund të ndahen në dy pjesë, në materiale dhe në shpirtërore. Mund të themi se vrojtimi material bëhet me metodat dhe recetat më të mira të standardeve botërore. Ndërsa në vrojtimin shpirtëror jemi të detyruar të japim një bindje më tepër sipas koncepteve individuale. Për këtë arsye termin “njeri i formuar” mund ta kuptojmë si, njeri i aftë, mjeshër, profesionist i kualifikuar etj, të cilit i bëhet një trajtim dhe vrojtim i mirë qoftë nga ana materiale dhe ajo shpirtërore.

Pra këta njerëz përveçse duhet të marrin një formim të mirë, përgjatë jetës së tyre duhet të investohen dhe të vrotjohen mirë.

Ka njerëz që ndoshta nuk janë mjeshër a profesionistë të kualifikuar, por është e mundur që ata të jenë njerëz të përkryer në karakter. Ky shqyrtim i yni është i kufizuar me grupin e parë. Në botën e globalizuar

popujt ose shtetet të cilët janë të mbyllur në vetvete kanë shanse të pakta progresi.

Për një komb duhet që përveç aspektit numerik, pasurive natyrore, prodhimit pozitiv në të gjithë botën, të zotërojë të paktën një për qind të menaxhimit të tyre. Një për qind të popullsisë duhet ta zënë njerëzit e formuar, një për qind tjetër duhet ta zënë inxhinieret, juristët, sociologët, teologët, artistët dhe sportistët.

Por edhe pse tek ne numri i njerëzve të specializuar dhe të formuar është i pakët, asnjëri prej nesh nuk e ngre zërin për investimin dhe sponsorizimin e këtyre njerëzve.

Për sa i përket institucioneve edukative më të cilat bëhet një shërbim ndikues dhe bashkëkohor sipas standardeve botërore, nuk mbetemi shumë pas.

Edukatorët e botës islame, krahasuar me ato të shteteve të zhvilluara, janë më pasivë në perceptimin e objektivave botërore.

Veçanërisht në shkollë, edukimi profesional është i kufizuar me 3-4 vjet, ndërsa jeta profesionale zgjat rreth 30-40 vjet. Në qoftë se mbas studimeve shkollore dijen tuaj nuk e zgjeroni në punë dhe në jetën e përditshme, nuk mund të dilni fitimtarë dhe të posedoni titullin “njeri i formuar”.

Ndërmarrjet e këtij drejtimi, marrëdhëniet edukator-ndihmës dhe organizatat e firmave të mëdha, nuk duhet të mbeten të kufizuara vetëm me programet edukative, por duhet të zgjerohen më shumë.

Mbase bukë dhe ushqim kemi, mirëpo masa, cilësia dhe llojshmëria e tyre është e pakët, sepse janë të paktë ekspertët e prodhimit të ushqimeve. Qoftë industria, ekonomia, edukimi, letërsia, arti, sporti fatkeqësisht në botën islame nuk kanë rezultat.

Në shkencat sociale, jemi pothuajse nën nivelin e duhur. Për shembull, duke qenë se në shtetet myslimane për vite me radhë po përjetohej shumë shpesh inflacione, ekonomistët myslimanë duhet të ishin ekspertët më të mirë në këtë fushë. Natyrisht po të ishte kështu atëherë do të arrinim të mposhtnim inflacionin dhe krizat ekonomike.

Fatkeqësisht ne myslimanët nuk po mundemi t’i drejtojmë institucionet tona dhe nuk jemi në gjendje të edukojmë e të nxjerrim ekspertë dhe profesionistë të kualifikuar nga radhët tona. Akoma rrimë dhe presim zgjidhjen e problemit nga perëndimi. Por harrojmë nganjëherë se mbase atje nuk ekzistojnë probleme të tilla.

Mangësia më e madhe del në pah në art dhe në shkencat humane. Sot në artin, letërsi-



në, jurisprudencën, filozofinë dhe dijet teologjike botërore, sa ekspertë të kualifikuar kemi nga radhët tona të cilët do të kontribuonin ose do të kishin ndikim në investigimet e tyre?

Të gjithë e dimë se qytetarizmi nuk është makina kompjuterike apo teknologjia, por arti dhe humanizmi. Në shtetet e zhvilluara planifikimi i forcës njerëzore bëhet duke vënë disa qëllime përpara vetes dhe duke u mbështetur në disa të dhëna. Sot ndodhemi në këtë pikë, kurse pas kaq vitesh do të arrijmë në këtë pikë dhe për këtë arsye për çdo vit do të kemi nevojë për një numër të caktuar profesionistësh të kualifikuar.

Atëherë iu drejtohen institucioneve ose organizatave që bëjnë të mundur edukimin dhe kualifikimin e tyre, kështu që për gjatë gjithë jetës profesionale ky edukim të ecë sistematikisht.

Në firmat e mëdha nuk ka vetëm institucione të drejtorive edukative, por organizata të ndryshme apo komplekse institucionesh edukative që për fat të mirë gjithmonë janë të frekuentuara nga shoqëria.

Në këto firma nuk mungojnë edhe shtëpitë e botimit, libraritë etj. Universitetet madje, për disa tema marrin informacion prej tyre.

Më sipër ju parashtrua temën për njeriun e aftë e të formuar, si dhe marrëdhëniet midis vrojtimit apo kujdesit material me atë shpirtëror.

Në shtetet e pazhvilluara,

me vështirësi të madhe mund të gjendet ndonjë njeri i kualifikuar, i cili ose do të jetë i detyruar të pranojë sypaçelësinë e tij ose do të pranojë emigrimin në një nga shtetet e zhvilluara. Njerëzit në përgjithësi emigrojnë nga fshati në qytezë, nga qyteza në qytete të mëdha, madje edhe nëpër qytetet e mëdha ekziston i njëjti emigrim.

Ndoshta thellë në zemrat tona nuk mund ta pranojmë, por fatkeqësisht ky është një pasqyrim i pikëve tona maksimale.

Bindja shpirtërore nuk duhet të matet vetëm me durimin ndaj skamjes, ndihmesës së anasjelltë dhe përballimin e vuajtjeve.

Sikur ne myslimanëve të na shtoheshin mundësitë tona në edukim, shëndet dhe fusha të tjera, të gjitha të drejtat dhe liritë tona do t'i fitonim pa asnjë vështirësi dhe do të rritej njëkohësisht edhe niveli i bindjes sonë shpirtërore.

Bota perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës konsiderohen si bota bindëse dhe vlerësuese e suksesit. Në këtë mënyrë ato i japin një shtytje çdo kujt për të arritur një nivel më të lartë nga ç'janë, dhe më e rëndësishmja është ndikimi i madh i tyre në edukimin dhe në kualifikimin e njerëzve. Ajo që na tërheq vëmendjen është se kur kërkohet personel për një detyrë ose për një post, pranohet ai person i cili është më i aftë dhe më i kualifikuar, jo ai i cili është më i privilegjuar. Mbase të gjendet personi i duhur, atij i dorëzohet posti. Si rrjedhojë

njerëzit tashmë nuk vrapojnë pas posedimit të privilegjeve, por pas specializimit dhe kualifikimit të tyre.

Ndërsa po t'i hedhim një sy mënyrës sonë së punuarit, fatkeqësisht shohim se nuk i japim shumë rëndësi suksesit, për më tepër ai injorohet me emrin "xhelozia shoqërore".

Kryesisht shkak i mangësisë që kemi tek njerëzit e aftë dhe të formuar është perceptimi dhe konceptimi me vonësë i metodave edukative, si dhe mosnjohja e mënyrës së vlerësimit, ruajtjes dhe përdorimit të forcës njerëzore.

Sikur të donim që në kopshin tonë të kultivoheshin fruta, pemë, lule etj, po të mjaftoheshim vetëm me mbjelljen dhe ujitjen e tyre me një herë të vetme, do ta dinim fare mirë se nuk do të na realizohej dëshira.

Do të duhej patjetër ujitja, plehërimi dhe dezinfektimi me ilaçe në mënyrë të vazhdueshme, pra do të ishim të detyruar të shërbenim pandërprerë.

Nëse duam që në shoqërinë tonë të drejtohem nga njerëzit e aftë, ne nuk do ta arrinim këtë gjë vetëm nëpërmjet edukimit të disa personave të caktuar. Ne jemi të detyruar të bëjmë sa më saktë dhe drejtë trajtimin dhe mbështetjen materiale e shpirtërore të këtyre njerëzve. Në të kundërt çdo anë do ta zaptonte barërat e këqija.

# Gruaja sakrifikuese: shtylla e shtëpisë

Një grua myslimane, është shenja e sakrificës dhe dashurisë së familjes. Ajo sikur ia përkush-ton jetën familjes, bashkshortit dhe fëmijëve të saj. Gëzimi, lumturia dhe qetësia e tyre bëhen burim lumturie edhe për të.

Harxhimi i kohës së grave në rregullimin dhe punët e shtëpisë, kujdesi dhe përkushtimi ndaj bashkeshortit si dhe edukimi i kujdesshëm i fëmijëve, i ka kthyer ato në një zog femër që mirëkujdeset për çerdhen e saj.

Që nga periudha e të Nderuarit tonë (a.s.) zonjat e sahabeve ndihmonin bashkeshortët në punët e tyre pasi që kishin mirëmbajtur shtëpitë e veta.

Nëse do të duhej të jepnim një shembull, shumë të vlefshmit e Familjes Profetike dhe sa-habeve, Fatimeja dhe Aliu kishin ndërtuar një familje model duke i ardhur në ndihmë njëri-tjetrit. Këta dy të rinj që ishin rritur në duart e Profetit (a.s.) kishin vënë kurorë martesore po me duart e tij. I dërguari i Allahut ia kishte ndarë detyrat, duke ngarkuar Aliun me punët e jashtme e Fatimen me punët e brendshme të shtëpisë. Pastaj i ishte shprehur kështu vajzës së tij:

“ Bija ime, Fatime! Ti bëhu robëreshë e Aliut që edhe ai të bëhet skllavi ty...”

Duke u nisur nga kjo këshillë e të atit Fatimeja u mundua përherë të mos i shkaktonte asnjë shpenzim të kotë të shoqit duke u mjaftuar me ato çfarë zotëronte. Kohën përtej kohës së adhurimit, ia kishte kushtuar mirëmbajtjes së shtëpisë dhe edukimit të fëmijëve. Nganjëherë tërhiqte dhe e barte vetë ujin nga pusi për në shtëpi, qepte vetë të gjitha rrobat e pjestarëve të familjes, bluante me mulli dore grurin. Madje nga kjo e fundit në duar i ishte formuar kallo, e për këtë shkoi pranë të atit që ai ti caktonte një ndihmëse. I dërguarit i Allahut (xh.sh.), Muhammedi (a.s.), edhe pse i dhimbsej vajza e tij e shtrenjtë, nuk e gjykoi të

përshtatshme që bija e tij të kishte një shërbëtorë ndër kohë që ishte i madh numri i nevojtarëve të shumtë në Medine. Atë e ngushëlloi duke i thënë:

“Bija ime, Fatime, ka njerëz më nevojtarë se ti. Dhimbjet e kësaj bote piji për shijen e Ahiretit”

Edhe Esmaja (r.a.) ndihmonte bashkeshortin e saj Zubejrin, po ashtu kujdesej për kalin, barte mbi kokë farë dhe bërthama hurmash. Ashtu sikurse zonjat muslimane kujdesen duke sakrifikuar tepër për shtëpinë dhe familjen e tyre, edhe bashkeshortët duhet t'i ndihmojnë me aq sa kanë mundësi zonjat duke ia lehtësuar punët. Në këtë aspekt i dërguari i Allahut gjithnjë arnonte vetë, riparonte këpucët, mjelte qumështin e bagëtive, mundohej gjithnjë të kryente vetë nevojat e tij pa iu bërë barrë askujt.

Përkujdesi, edukimi dhe rritja e fëmijëve është detyrë e përbashkët si e burrit ashtu edhe e gruas. Për këtë arsye, nëse ndonjëherë gratë lodhen apo mërzhiten nga punët e përditshme, burrat duhet ti ndihmojnë ato.

Shkurtimisht, në një familje myslimane secili duhet të mbështesë dhe të ndihmojë njëri-tjetrin. Edhe pse sakrifica dhe përkushtimi i një personi të vetëm nuk humbet asnjëherë tek Allahu, duhet të dihet se një zog nuk mund të fluturojë vetëm me një krah. Të dy palët duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin me aq sa kanë mundësi.

Pikërisht kjo është rruga e qetësisë shpirtërore dhe e lumturisë!





# INJEKSION JETE

Është mirë të punosh, të mundohesh, por pangopësia e ambicia është e keqe.

Të bësh përpjekje është mirë, por ta kalosh kufirin e të lodhesh më shumë se sa duhet, është keq.

Sa mirë është të jesh i thjeshtë e i sinqertë dhe sa keq të kesh formalitete dhe “ të bësh sikur je”...

Të zgjidhësh një punë me mirëkuptim e tolerancë, të mënjanosh problemet, të jesh zemërgjerë është përherë mirë, gjaknxhtësia, ngutësia dhe të shohësh mangësitë e tjerëve është një e keqe.

Është mirë ta kthesh jetën në një vepër arti, ashtu sikurse është keq ta shndërrosh atë në një torturë.

Për hatër të Krijuesit, është mirë t'i japësh krijesave ushqim mendor, trupor e shpirtëror, ashtu sikurse është keq të presësh duartrokkitjet dhe komplimentet e njerëzve.

Të mos ndjesh nevojën e njerëzve të tjerë është mirë, e të presësh gjithnjë diçka nga ato është keq.

Të qëndrosh gjithnjë mbi këmbët e tua, e në disa raste të mbështesësh tjetrin është mirë pa qenë nevoja të bëhesh barrë e tjetrit, jo.

Modestia e dinjiteti është i mirë, mendjemadhësia jo.

Të praktikosh në jetë formulën “ Allahu krijon, robi prodhon”, të shfaqësh e të përdorësh çdo mundësi materiale e shpirtërore për krijesat është mirë, amullia, pesimizmi, e të sjellurit si parazit, jo.

Mëshira është e mirë e paaftësia jo.

Sezai Karakoc ( Allahu i dhuroftë jetë të gjatë e të begatshme) thotë kështu:

“ Nëse jemi të kënaqur nga vendi ku ndodhemi, nëse ky nuk është një mashtrim, nëse kjo nuk buron nga mosvlerësimi i ndjeshmërisë tuaj njerëzore, nëse është realizuar ajo çfarë quhet lumturi...Nëse zemra juaj jeton një jetë sipas dëshirës së Allahut(xh.sh.) dhe paralel me natyrën njerëzore, nëse thoni “kjo është ajo që kërkoj” atëherë ç’ rëndësi kanë kushtet? A nuk varet mjaftueshmëria dhe përshtatshmëria e këtyre kushteve nga vetë gjendja shpirtërore e njeriut? Disa kushte mund të tërheqin dikë, por të njëjtat kushte dikë tjetër mundet edhe ta mërzhisin.

Të thuash “ajo çfarë kërkoja është tamam kjo” ndoshta është një ëndërr në këtë botë të fundme. Si të harrojë nënën e saj një vajzë e ikur nuse në kurbet, apo si ta fshijë mallin? Edhe sikur njëren dorë në dhjamë e tjetren në mjaltë ta kishte, a do mund të harronte mallin për nënën?

Kaq për këtë botë mik i dashur, nuk je në xhenet.

Edhe mistik sikur të jeni, ju pëlqen kjo gjendje, por ja që ndodh një problem që ju prish qefin.

Cilin aspekt duhet të përmbushim për të qenë të lumtur?

Lumturia absolute mund të arrihet vetëm në xhenet. Duket sikur nuk do na bie për hise të jemi të lumtur por, “të dukemi” si të tillë.

“Të jesh i kënaqur...” Të mos kesh asnjë



kundërshtim .... E zorshme.

Nganjëherë njeriu vendos në kokë gjëra të parealizueshme, brengoset nga çështje që e mundin. Nuk sheh trëndafilin por gjembat, mërzitet dhe revoltohet. Nëse mangësitë do vazhdojnë të shtohen edhe prapambetja po ashtu... Sa mirë do ishte që një dorë prej ushtai ta zinte lehtë këtë kokë e ta sillte nga trëndafilin.

Ka edhe nga ato njerëz që janë përherë të gëzuar, të qeshur e që ruajnë dëshirën për të jetuar. E këta të fundit sikur të ishin injeksion lumturie e jete për njerëzit.

Këto tipa të grupit të fundit duhet të shihen me kujdes dhe duhet të kuptohet rregulli mbi bazën e të cilit buron lumturia e tyre. E ky rregull të pranohet nga shoqëria.

Nga erdhi e nga buroi gabimi i atyre të parëve në sytë e të cilëve ishin ngulitur një palë syze të errëta? Ku është gabimi?

Kjo duhet gjetur, e pastaj mendoj se njerëzit duhet të mbahen larg nga ky gabim.

C' është ky shtrembërim që shuan ndjenjën e falënderimit dhe lumturisë?

Ashtu sikur gjallëria e trupit, edhe ajo shpirtërore lidhet me disa rregulla të caktuara. Janë dijetarët e fesë e të psikologjisë ata të cilët do gjejnë e përcaktojnë këto rregulla.

Ku e si do të gjinden këto dijetarë?

Njerëzimi mund të adoptojë një mënyrë jetese instiktive, që buron nga përpjekjet e dendura të "bijve të shejtanit" ose nga injoranca e metodës së atyre që thonë " unë jam mysliman", ose nga pamundësia për t'ju përmbajtur vrapimeve të gjata, ose nga pamundësia për të ndrequr dobësitë.

Vetëm se nuk duhet harruar diçka: sado që e shtrembra të zbukurohet, sado që e gabuara të imponohet përmes mediave, është përsëri e gabuar, që i bie ndesh natyrës njerëzo-

re e që dëmton njerëzimin, që godet botën shpirtërore.

Nëse njerëzimi kërkon lumturi dhe drejtësi, duhet të kthehet nga fjala e Zotit, ku do të gjejë qetësinë e shpirtit, përndryshe dhimbjeve dhimbje kanë për t'ju shtuar..

Ngrihu, e gjej një rrugë të bukur për ta jetuar jetën. Të gjesh një botë pa ferra është e pamundur por të arrish kënaqësinë e Zotit, po.

Është e mundshme të rrezatojmë përreth ndjenjën e sigurisë e mirësisë.

Të zbukurosh jetën me sa ke mundësi është përherë e mundur.

Lidhu në një mënyrë me jetën, por këtë lidhje mos e shndërro në pasion.

Në çfarëdo lloj kushtesh që të ndodhemi, jemi të detyruar që pyetjeve t'ju japim përgjigjet e duhura.

Nuk e kemi caktuar ne vendin dhe kohën e sprovës. As nuk na ka pyetur kush se " Në ç'kushte do donit të merreshit në provim?". Ne nuk kemi të drejtë të ankohe mi dhe na duhet të kuptojmë mirë rolin tonë e ta luajmë mirë atë.

Jeta jetohet një herë e nuk ka kthim prapa. Nuk ka kohë e as arsye për lodhje koke me mendime të ndryshme. Jemi rrethuar në çdo anë nga kamera, "policët" që shkruajnë çdo gjë, janë gati.

Ngrihu dhe luaje me dinjitet e sukses rolin që të është dhënë

Kushtet janë këto apo ato... Kjo s'ka ç'të duhet. Të duhet vetëm të jesh i suksesshëm, me këto kushte...

Mik! Kaq është e gjitha...

# Durimi dhe Sakrifica

Thuaj: Namazi im, sakrifica ime, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun, Zotin e gjithësisë". El- En'am,162.

Allahu i madhëruar në këtë botë i sprovon robët e tij në forma të ndryshme, por jep edhe sihariqin që pas vështirësisë vjen lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi. (Inshirah, 5-6) Në Kur'anin e madhërshëm shohim që pejgamberët dhe besimtarët e devotshëm në jetën e tyre janë përballuar me shumë vështirësi, por Allahu (xh.sh.) u ka krijuar lehtësime. Allahu (xh.sh.) na tregon në Kur'anin famëlartë për ata të cilët duke u përpjekur në rrugën e Allahut (xh.sh.) u përballuan me pengesa të ndryshme aq sa u detyruan të braktisnin vendlindjen dhe të emigronin.

Në suren Nisa Allahu (xh.sh.) thotë: "Kush shpërngulet për hir të (fesë) së Allahut, ai gjen mundësi të madhe dhe begati në tokë. E kush del prej shtëpisë si emigruet tek Allahu dhe i dërguari i Tij, e zë vdekja (në rrugë), shpërblimi i tij i takon Allahut. Allahu është mëshirues dhe mbulues i të metave. (Nisa, 100) Ata që luftuan për të mbrojtur veten dhe fenë e vet kanë gradë të lartë te Allahu (xh.sh.) Por shpërblim kanë edhe ata që patën dëshirë, por ishin të paaftë, siç janë, të gjymtuarit, të verbëritë ose të sëmurët.

Sahabet kanë sakrifikuar shumë në rrugë e Allahut (xh.sh.) me të gjitha mundësitë e tyre. Nga ky moral i lartë i tyre Zoti (xh.sh.) i ka shpërblyer me mirësi të mëdha. Në suren Enfal Zoti (xh.sh.) thotë: "Kujtoni kur ishit pakicë e dobët në tokë dhe frikësoheshit se do t'u rrëmbejnë njerëzit (idhujtarët), por Allahu u mundësoi vend të sigurt dhe u përkrahu me ndihmën e Tij. (Enfal, 26)

Të gjitha të mirat që i qenë dhënë Ejubit (a.s), iu morën prej duarsh një e nga një, si një provë hyjnore. Pas kësaj e zu një sëmundje e rëndë, por du-

rimi dhe nënshkrimi i Tij është bërë legjendar në historinë e njerëzimit. Ky durim i jashtëzakonshëm i Ejubit (a.s), ashtu siç është i lavdëruar në Kur'an, është ngritur lart edhe në hadithet profetike: "Ejubi (a.s) që më i buti i njerëzve, më i duruari dhe ai që e përmbante më shumë zemërimin!" (Osman Nuri Topbash, "Vargu i Profeteve 3", fq. 114)

Durimi është gjëja më e rëndësishme për njeriun. Që të jesh i suksesshëm duhet të durosh. Që të adhurosh Zotin e Madhëruar, duhet të durosh. Që të largohesh nga gjynahet, duhet vendosmëri dhe durim. Që të përballosh fatkeqësitë e ndryshme, duhet të durosh. Që të jesh trim, duhet të jesh i duruar.

Një çift nga Medina kishin vetëm një djalë, Ebu Talhan. Një ditë, kur burri ishte jashtë shtëpisë, femija vdes. Kur kthehet dhe pyet për djalin se ku ishte, gruaja i thotë se e ka zënë gjumi. Pasi i jep të hajë dhe e lë të çlodhet, ajo e pyet të shoqin:

Nëse kemi marrë diçka hua nga komshinjtë, a t'ua kthejmë?

Sigurish,- i thotë i shoqi.

Edhe nëse e kemi ruajtur në shtëpinë tonë për një kohë të gjatë?"- e pyet përsëri e shoqja.

Po,- ia kthen i shoqi.

Atëherë duro, se Zoti (xh.sh.) na e mori atë që na e kishte lënë amanet deri tani, djalin tonë".

Historia e njerëzimit, dhe sidomos historia e përhapjes së Islamit, është plotë me shembuj që flasin shumë qartë se asnjë sukses, qoftë edhe më i vogli, nuk mund të arrihet pa sakrifica. Sa herë që bashkësia e myslimanëve bëhej e fuqishme shpirtërisht dhe tregoheshin të gatshme të jepte çdo gjë prej vetes, myslimanët ecnin përpara dhe gëzonin prosperitet.



## ***Thirre yllin e dëshirave!***

Thirre yllin e dëshirave,  
Thirre!  
Strehoje në beben e syrit tënd...  
Thirre dhe hënën si një bukuri qiellore,  
Thirre!  
Në vetminë tënde mos e quaj të trishtuar...:  
Se ylli nuk i ngjan më qiellit,  
Por detit me dallgë  
Sa edhe një yll dëshirash nuk mund të lundrojë më...  
Hëna loton dëshirat e tua...  
E lodhur në agun e një ëndrre flë...

Thirre yllin e dëshirave,  
Mos e braktis!  
Mos..!  
Dëshirat nuk u ngjajnë meteorëve,  
Edhe në udhëkryqe shkëlqejnë...

Thirre yllin e dëshirave  
Kësaj nate  
Qielli hap shpirtin e dëshirave...  
Mos hesht e mos rri i përvuajtur,  
Mos rri i lodhur e i drobitur  
Mos..!  
Qiellin humb dhe e kërkon,  
Beben e syrit humb dhe e vajton,  
Yllin humb dhe e ëndërron...

Thirre yllin e dëshirave,  
Thirre!  
Lutu për dritën qiellore,  
Jo për shtegun e harruar,  
Lutu për gëzimin njerëzor,  
Jo për një çerdhe të trishtuar...  
Lutu  
Beben e syrit shndërroje në yll!  
Lutu  
Qiellin e dëshirave mos e kthe në të frikshmin pyll!  
Lutu  
Lutu për një yllësi dëshirash!..

**XHAHID BUSHATI**




## Histori e hazreti Ibrahimit e Ismailit “Alehimysselam”

Në këtë tregim në vargje Hafiz Abdullah Zemblaku[1] trajton një temë shumë interesante të fesë islame. Ideja themelore është kjo: Dashuria për Allahun është më e larta, më e kulluara, më e gjëra, asaj nuk ia përngjet asnjë tjetër, qoftë kjo për familjen, për gruan apo edhe për fëmijën. Fabula është e thjeshtë. Hazreti Ibrahim i lutet Zotit që “t’i falë një evlad të ndershëm”. Zoti ia pranon lutjen dhe Ibrahimit i lind një djalë, Ismaili. Kohët kalojnë dhe Ibrahimit i kujtohet betimi që ka dhënë se ai do të bënte kurban për hir të Allahut çdo gjë që të ishte më e shtrenjtë për të. Bëri kurban 100 desh, por përsëri, betimi nuk është kryer, 100 desh nuk janë gjëja më e shtrenjtë për të. Bëri përsëri kurban 100 deve, e pas tyre 100 kuaj, por as këto nuk mjaftojnë. Për këtë poeti shkruan: “Për një më të dashur ti ke dhënë fjalë”. Ai më i dashur është Ismaili. Ibrahim kur u ngrit nga gjumi “Zu qan për të birë ay i uruar”. Gruas nuk i tregon, e porosit ta lajë e ta veshë djalin se do të shkonte në mal për dru. Përmes një pyetjeje retorike poeti shpreh gjendjen emocionale të nënës për djalin e vetëm: “Ku ta dij e ëma çështjen e vërtetë?/ Se i bir-i saja do vdesë për jetë.” E lau, e veshi me rroba të reja, e puthi në sy, e vështroi me dashuri dhe e porositi që të mos i ndahet babait sepse: “Nuri im i syve tha me ty më mbahet/ Se botën të tërë me ty e shoh unë/ Me të shpejtë, o djalë, të vish prap dek’unë.” Ngjarjet rrjedhin shpejt. Hazreti Ibrahim e shtrin djalin ta prese, por thika nuk e kryen detyrën. I bie gurit dhe e çan në mes. Në këtë moment Xhebraili sjell një kurban, i urdhëruar nga Zoti xh.sh., dhe që nga ajo kohë besimtarët islamë e kanë për detyrë të presin një kurban ditën e Bajramit të Vogël, ose siç quhet Kurban Bajrami.

Krahas idesë qendrore që parashtruan në fillim, dashuria për Zotin është dashuria më e madhe, në këtë tregim dalin qartë edhe disa ide tjera me vlera të mëdha morale, të cilat përdoren si shembuj të larte edukate.

Së pari, mbajtja e fjalës së dhënë. Hazreti Ibrahim është betuar që në se Allahu bën emër që t’i lind djalë, ai do të bëjë kurban gjënë më të shtrenjtë. Dhe ai është gati të mbajë fjalën e dhënë për hir të Allahut. Ky është një shembull i lartë devotshmërie. Vërtetë prindi ka dashuri të pakufishme ndaj fëmijës, djali është gëzimi i jetës “..botën e tërë me ty e shoh unë”, por Ibrahim ka dhënë fjalën dhe ajo do të mbahet. As 100 desh, as 100 deve, as 100 kuaj nuk i dhimben fare, por djali është tjetër gjë. “Ai zë qanë për të bir e uruar” dhe kjo është njerëzore. Po sakrifica sublime për hir të Allahut është mbinjerëzore, ajo është një shembull profetik edukativ i përkryer për mbarë njerëzimin.

Së dyti, Hazreti Ismaili simbolizon djalin e bindur ndaj një vendimi të drejtë të babait, të marrë për hir të Allahut. Në momentin kur Ibrahim do të kryejë detyrën, therjen e të birit, heziton, mendon ta vonojë veprimin, dhe duke e hequr për dore të birin e uruar



"... lotët i vinin ishte i helmuar" Ismaili vëren babain dhe e pyet: "... përse kjo e qarë?/ Ce më gënjen mua, për se më ke marrë? Kur merr përgjigjen se kishte urdhër nga Zoti që ta bënte kurban, me bindje të plotë i flet të atit: "...E sill në vend tinë urdhërin që ke marrë". Ideja është e qartë: Ibrahim kishte një djalë, Ismaili kishte një shpirt, e nuk ishte diçka e madhe që ta sakrifikonin të dy për hir të Allahut. Këto fjalë në gojën e Ismailit tregojnë qartë idenë e bindjes ndaj babait e mbi të gjitha ndaj vullnetit të Zotit. Vëreni skenën ashtu siç e përshkruan poeti :

"Karshi nga Qabeja ndënji Ismaili/ Me thikë përsipër i erdhi Halili/ Tërë kafshëria i kanë erdhur pranë/ Ismail e dashur që të gjithë e qanë."

Në këto momente sublime djali i vogël gjen forca t'i thotë babait që të ketë kujdes, kur ta presë se mos i ndotet këmisha me gjak: "Po këmishë me gjak mos më shohë mëma". Gjithashtu ai nuk pranon që i ati ta lidhë, sepse do të mendonin të tjerët se ai nuk ishte i bindur, por ndaj tij po kryhej një veprim me dhune. Hazreti Ismaili është simboli më i lartë i një fëmije që i nënshtrohet me bindje të plotë vullnetit të prindit dhe të Allahut.

Së treti, nëna, Hazreti Haxhireja, djali, Ismaili dhe babai, Hazreti Ibrahim vihen para një prove shumë të vështirë. Në këtë vepër

Në çdo shteg të jetës së njeriut do të dalë djalli dhe do të përpiqet t'i tërheqë njerëzit me bukuritë e kësaj bote. Rruga për në xhenet është e gjatë, plot vështirësi, e në këtë rrugë shejtani përpiqet të nxjerrë njëmijë pengesa për t'i drejtuar bijtë e Ademit për në zjarrin e xhehnemit.

që nis të kryhet për hir të Allahut, ndërhyjnë djalli.. Ai përpiqet për t'i kthyer njerëzit nga rruga e drejtë dhe për t'i futur në rrugën e shtrembër. Për të realizuar qëllimin e tij ai gjen çastet më të vështira tek njerëzit, fut në shpirtin e tyre hijen e dyshimit dhe i nxit me fjalët e tija dredharake të ndryshojnë drejt së keqes. Në çdo shteg të jetës së njeriut do të dalë djalli dhe do të përpiqet t'i tërheqë njerëzit me bukuritë e kësaj bote. Rruga për në xhenet është e gjatë, plot vështirësi, e në këtë rrugë shejtani përpiqet të nxjerrë njëmijë pengesa për t'i drejtuar bijtë e Ademit për në zjarrin e xhehnemit. Natyrisht me fjalët e tij të bukura i drejton nga ëmbëlsitë e kësaj jete, i nxit të plotësojnë nevojat e tyre biologjike, epshet e tyre, i fut në shtigjet e haramit dhe aty mundohet t'i mbajë të harruar nga detyra e tyre.

Kjo ide është shprehur qartë në këtë tregim në vargje. Sapo nënë Haxhireja përcolli burrin dhe të birin, në rrugë i doli përpara djalli dhe e lajmëron nënën për gjëmën që do ta gjente: "Atë për të therur e ka marrë Halili,/ O bobo të shkovi tynë Ismaili", dhe më poshtë kur nëna e habitur për këtë lajm kundërshtoi: "E ç'thua kështu tinë ?/ Për dru e ka marrë ato parap do vinë." Po djalli ngul këmbë: "Ismailë qaje,/ Preje shpresën tinë edhe helmin mbaje." Nëna nuk beson e si do ta therte babai djalin: "I tha Haxhireja: t'u nxitë surrati,/ e si mundt ta vrasë të birë i ati ?" Sapo merr vesh nëna që ky ishte vullneti i Zotit, iu drejtua djallit duke e mallkuar dhe duke e gjuajtur me gurë: "Me gur të Haxhiresë theu qafën Iblisi". Por djalli në veprën e tij është këmbëngulës, në se nuk ka sukses në një drejtim, ai vazhdon në një tjetër. Nëna vërtetë është shumë e dhembshur për birin e vet, por ajo është e rritur dhe e bindur ndaj vullnetit të Allahut, e kupton ndërhyrjen djallëzore të shejtanit, dhe e shporr atë duke e gjuajtur me gurë, por shejtani këmbëngulës



në rrugën e vet djallëzore, drejtohet tek djali, duke menduar se ai është fëmijë i njomë dhe jeta do t'i dhimbsej, ai do të frikësohej, kur ta marrë vesh qëllimin e vërtetë të babait. Djalli i afrohet dhe ashtu siç di vetëm ai, i pëshpërit se nënë Haxhireja po qante dhe e kishte dërguar ta kërkonte. Dhe kur i kumtoi se babai do ta therte, Ismaili ka marrë një gur dhe e ka gjuajtur shejtanin: "Një sy ja ka nxierë n'atë çast leinit,/ i çavi dhe kokën armikut të dinit."

Gjuajtja e shejtanit me gur nga të gjithë haxhijtë e botës që vizitojnë vendet e shenjta, është një simbol i njohur prej të gjithëve. Çdo haxhi mbasi ka vizituar Qabënë e shenjtë, ka kaluar një ditë në fushën e Arafatit, një natë në Myzdelife, zbret në Mina dhe niset të kryejë ritin simbolik të gjuajtjes së shejtanit me gurë në kujtim të Z.Ibrahimit, Haxhiresë dhe Ismailit që shpreh përmes këtij veprimi aktin e ndarjes së haxhiut nga e keqja që mund t'i vijë nga djalli i mallkuar. Dhe me atë urrejtje që gjuajti nëna, djali dhe babai djallin, po me atë vullnet dhe urrejtje haxhinjtë kryejnë ritin e gjuajtjes së shejtanit me gurë. Pas këtij veprimi secili, tashmë i pastruar nga të këqijat, kthehet i gëzuar për të shijuar festën e kurban bajramit.

Është interesante të theksohet se ndonëse ngjarja ka ndodhur në muzgun e shekujve,

Për të analizuar këtë tregim jemi mbështetur në "Mevludi Paq", "Nuri Ahmedije", Hafëz Abdull-llah Sëmbllaku, botim i dytë, Hëna (I) Muharremyl Haram 1350, Korçë, Shtyp.& Kartoleria Peppo-Marko, 1931. Vepra ka gjithësejt 84 faqe.

Në vargun e krijesve të Mevludit bën pjesë edhe Hafiz Abdullah Zemblaku, një figurë e njohur dhe e nderuar e intelektualëve islamë shqiptarë që ka kontribuar në disa drejtime për gjallërimin e fesë në të gjitha anët e vendit tonë.

Ai ka lindur në vitin 1892 në Bilisht në një familje me tradita fetare, atdhetare e arsimore. Babai i tij ka qenë mësues në krahina të ndryshme të vendit, i cili djalin e edukoi me traditat familjare. Abdullahi pasi përfundoi shkollën fillore e qytetes në atdhe, u dërgua në Turqi, ku studjoi në medresetë e larta Perpelat dhe Darylhilafe dhe në vazhdim mbaroi studimet e larta teologjike në shkollën "Darylfunani sherijë" në Universitetin e Stambollit.

Në vitin 1921 u kthye në atdhe dhe nga Ministria e Arsimit u emërua mësues në shkollën Kuç-Belorta të rrethit të Korçës. Pas tre vjetësh dha dorëheqjen për të qenë i lirë për t'u marrë me veprimtari fetare e botuese. Në këtë kohë punoi si imam në fshatin e vendlindjes dhe filloi të përkthejë libra fetarë. Për këtë arsye nuk pranoi poste me përgjegjësi si myfti i Korçës etj.

Me punën e përkushtimin e tij fitoi popullaritet, nderim e vlerësim të madh, sepse gjashtë muaj qëndronte në Zemblak dhe gjashtë muaj të tjerë aty linte një zëvendës dhe vetë udhëtonte në gjithë Shqipërinë, duke dhënë mësim fetare në qytete e fshatra, duke drejtuar rite fetare e duke kënduar mevlude. Kjo dukej qartë edhe në poezinë e tij: "Një vizitë mes Shqipërisë", ku shpreh përshtypjet e



udhëtimit, rezultatet e aritura dhe mikpritjen, ku tregon efektin e veprimtarisë së gjerë që ka zhvilluar.

Për meritat e tij Këshilli i Përhershëm i Komunitetit Mysliman Shqiptar e emëroi inspektor për të gjitha shkollat fetare të Shqipërisë. Në këtë detyrë ai zhvilloi një veprimtari të gjerë fetare e patriotike për edukimin e besimtarëve e të popullit.

Hafiz Zemblaku u bë i shquar për botimin e Mevludit më 1924 në Korçë, të ribotuar më 1931 po në Korçë dhe më 1991 në Michigan në SHBA. Në botimet e Hafiz Abdullahit bëjnë pjesë edhe këto: "Pesë kasidete e Imamllarëve", "Hutbe me këshilla fetare", "Muhamedija (jeta e pasosur)", "Bilbil i 1 Abetare me ca jetëshkrime të arta", "Bilbil i 2 Enami sherif me harfe shqip", "Bilbil i 3 Histori e shenjtë me 130 faqe vjersha", "Bilbil i 4 Hadithi sherif (fjalë profetike)", "Bilbil i 5 Sheriati Muhammedija (fetare e madhe)", "Bilbil i 6, ëndërr e fëmijëve me kalendar", "Bilbil i 7 Shqiponja besare", "Bilbil i 8 Fëllëza", "Bilbil i 9 Pëllumbi", "Bilbil i 10 Stergu (Tefsiri 1001 qelam)", etj.

Hafiz Abdullahi u përdoq nga diktatura, se ai shprehu revoltë e papajtueshmëri me këtë regjim. Në vitin 1946 arrestohet dhe dënohet me 2 vjet heqje lirie. Lirohet, por përsëri arrestohet dhe dënohet me 6 muaj të tjera burgimi.

Vdiq në vitin 1960. Këtij personaliteti fetar iu bë një varrim madhështor me shumë nderime jo vetëm nga bashkëfshatarët dhe besimtarët e rretheve të Korçës e të Bilishtit, por edhe nga shumë hoxhallarë e besimtarë islamë nga e gjithë Shqipëria, se kudo kishte miq e dashamirës.



kur bashkohet realja me mrekullinë, përsëri në kujtesën popullore ideja e kurbanit është një veprim që shoqërohet me gëzim e hare. Dhe kjo është e natyrshme. Kur të gjithë prisnin vdekjen e Hazreti Ismailit, e jo vdekje të zakonshme por që do vinte nga thika në dorën e babait, kur të gjithë prisnin të derdhej gjaku i një djali krejt të ri, të flijohej djali nga babai për hir të Allahut, pikërisht në këtë moment, me urdhër të Zotit thika nuk pret dhe në vend të flijimit të djalit, Xhebraili zbret një kurban. Hazreti Ibrahim kishte përgatitur qindra desh, deve dhe kuaj, por asnjë nga këto nuk mund të zëvendësonin djalin. Prandaj prerja e kurbanit, ndonëse është përsëri një shpenzim jo i vogël, kryhet me një ndjenjë gëzimi të natyrshëm. Ai është një sakrificë, është një shprehje devotshmërie për hir të Allahut, është një veprim që shoqërohet me mundësinë për të sjellë gëzim edhe në shumë familje nevojtare që nuk kanë mundësi të ushqehen. Prandaj gëzimi i kurbanit nuk është vetëm gëzimi i sakrificës për hir të Allahut, por ky shoqërohet me një ndjenjë bujarie e mirësie ndaj të varfërve dhe dashamirëve. Nuk është aspak rastësi rregull i vendosur për shpërndarjen e mishit të kurbanit që ndahet në tri pjese: për familjen, për të varfëritë, për miqtë e dashamirët..

# UNI: KANCERI I RRUGËS SË SHËRBIMIT

Pranimi nga ana e krijuesit të gjithësisë i adhurimeve të bëra është i lidhur me pastërtinë shpirtërore dhe zjarrin e dashurisë. Ashtu sikurse sa e sa punë të mira që në pamje të parë mund të duken madhështore pakësohen deri në humbje të plotë kur janë brenda një shpirti të vogël, ashtu edhe punët e mira të pandehura si të vogla dhe të thjeshta mund të bëhen shkak i një fitimi të përhershëm brenda një shpirti të lartë që nuk e zë as tokën dhe as qiejt.

“Ne i hymë kësaj rrugë jo thjesht duke lexuar librat e tasavvufit, por duke i vënë në jetë ato që kishim lexuar dhe duke u shërbyer njerëzve brenda mundësive tona. Secilin e çojnë drejt një rruge, ndërsa ne na çuan drejt udhës së shërbimit.”

## Ubejdullah Ahrar

Allahu Teala, aq sa dëshiron që veprat tona të jenë të vlefshme dhe të mira aq edhe i sheh ato se deri në ç' shkallë i kemi realizuar duke iu përshtatur parimeve të devotshmërisë. Pra Ai sheh jo vetëm se si i kemi realizuar sjelljet dhe adhurimet tona për sa i përket parimeve dhe drejtimit të marrë, por edhe se me çfarë gjendje dhe pastërtie shpirtërore i kemi kryer ato. Duke u nisur nga ky këndvështrim arrihet në mendimin se, ashtu sikurse një njeri i dobët nga ana materiale, por i pasur nga ana shpirtërore mund të fitojë xhenetin qoftë edhe me një hurmë, e kundërta e tij, pra një njeri i pasur materialisht por i varfër nga ana shpirtërore, pra nëse është i sëmure dhe i pavetëdijshëm të gjithë pasurinë mund ta humbasë.

Kjo do të thotë që pranimi nga ana e krijuesit të gjithësisë i adhurimeve të bëra është i lidhur me pastërtinë shpirtërore dhe zjarrin e dashurisë. Ashtu sikurse sa e sa punë të mira që në pamje të parë mund të duken madhështore pakësohen

deri në humbje të plotë kur janë brenda një shpirti të vogël, ashtu edhe punët e mira të pandehura si të vogla dhe të thjeshta mund të bëhen shkak i një fitimi të përhershëm brenda një shpirti të lartë që nuk e zë as tokën dhe as qiejt.

Atëherë çështja më e rëndësishme është thelbi, ndjesitë shpirtërore. Pra janë parimet dhe etika e shpirtit në adhurim, një e vërtetë kjo që fiton një rëndësi edhe më të madhe në shërbim. Gjithashtu në Kur'an Hazreti Pejgamberit (a.s) i është urdhëruar që të falë namaz në Mesxhidin Kuba i ndërtuar me mirësi dhe devotshmëri, por të shembte edhe Mesxhidi Dirar që kishin ndërtuar munafikët mbi bazat e grindjeve, përçarjeve dhe ngatërresave. Duke u parë nga jashtë që të dy këto ndërtesa janë mesxhide, por nga brenda kanë dallime si lindja me perëndimin apo xheneti me xhehenemin.

Ja pra ky është raporti mes shërbimeve të realizuara në bazë të parimeve të etikës dhe atyre jashtë këtyre parimeve.

Në këtë aspekt ka parime të panumërta që duhen zbatuar me përpikëri.

## 1. Të ruash ekuilibrin (itidal)

Ashtu sikurse në çdo punë edhe në shërbim

është mjaft e rëndësishme të respektosh brendësinë e temës. Nuk është e drejtë që një person që merret me shërbim, të lërë mënjanë dhe të shmangë familjen e tij, nënën dhe babanë.

Allahu Teala e ka këshilluar ymetin e Muhamedit që të veprojë mbi bazën e këtij parimi dhe ka urdhëruar duke thënë:

“Kështu Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju....” (el-Bakare/ 143)

Ndërsa Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s) në çdo aspekt i ka paraqitur ymetit të vet një parim sjelljeje duke thënë: “Puna më e dobishme është ajo që bëhet me drejtësi.” (Bejhaki, Shuabu’l Iman, V, 261).

Përsëri në një tjetër hadith është thënë:

“Kur njëri prej jush t’u prijë njerëzve në namaz, të falet ngadalë pasi në mesin e tyre ka njerëz të dobët nga shëndeti, të sëmurë dhe të moshuar. Çdo njëri prej jush kur të falet vetëm, ta zgjasë sa të dëshirojë.” (Buhari, Ilim, 28)

Ashtu siç mund të kuptohet edhe nga ky ajet dhe këto hadithe, ruajtja e ekuilibrit në çdo punë që ka lidhje me këtë botë dhe me botën e përtejme është një parim i veçantë që ka vendosur Allahu dhe i Dërguari i Tij. Për sa kohë që të respektohet ky parim, është e pamohueshme që do të ketë përherë qetësi, harmoni dhe rregull si nga ana individuale ashtu edhe ajo shoqërore. E parë në këtë këndvështrim njeriu i cili shërben duhet të jetë një njeri i ekuilibruar. Psh një ligjërues në xhami duhet ta ndërpresë ligjëratën e tij menjëherë me ezanin. Pra ai duhet t’i marrë para sysh gjendjen e udhëtarëve, të të sëmurëve, të moshuarve dhe atyre që e kanë kohën e kufizuar. Ai duhet të ndikojë dhe në qetësinë gjatë adhurimit që bëjnë xhemati duke marrë parasysht ndjenjat e tyre.

Pasi njeriu që merret me shërbim është ai që i shndrit shpirti dhe fytyra me dritën e maturisë dhe të mendjemprehtësisë, është ai që është largpamës. Ai nuk duhet ta humbë kontrollin dhe ta tejkalojë kufirin në gëzime dhe hidhërimi, në lëvdata dhe kundërshtime, por duhet të gjejë një rrugë të mesme. Ai duhet të jetë një njeri i sinqertë që nuk arrin deri në një shturje etike dhe me dinjitet që nuk arrin deri në mburrje, duke ruajtur në një anë modestinë nuk duhet të arrijë deri në greminën e poshtërsisë.

Një nga veprat më të rëndësishme që e prish ekuilibrin e brendshëm është edhe inati apo zemërimi. Inati është një lloj pafuqie. Është një dobësim i pjesshëm i ekuilibrit mendor. Është një shprehje e dobësisë së njeriut, gati gati thuajse t’i japësh shpirtit një goditje. Në këtë aspekt njeriu që merret me shërbim duhet ta kapërdijë zemërimin e tij. Veprimet më të gabuara që përfundojnë me pendim, në përgjithësi janë vendimet që jepen në momentet e zemërimit. Duke u nisur nga kjo e vërtetë i Dërguari i Allahut Muhamedi (a.s) ka thënë:

“Askush mos të japë vendim mes dy njerëzve kur është i zemëruar.” (Muslim, Akdije, 16)

Për të ndaluar një person nga një gjë e papëlqyeshme duhet t’ia themi gabimin në mënyrë që mos t’ia ulim personalitetin e tij dhe duhet t’ia shpjegojmë një gjë të tillë. Kjo pasi edhe Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s) duke thënë: “Çfarë po më ndodh mua që po ju shoh juve kështu.” ka treguar një kujdes tepër të madh duke mos ia thënë në fytyrë tjetrit gabimin por duke përdorur një mënyrë më të butë.

Ja pra të gjithë ato personalitete që janë rritur dhe edukuar në këtë etikë shembullore gjatë gjithë historisë, i kanë vlerësuar të gjithë njerëzit që nga shkalla më e ulët e shoqërisë e deri tek shkalla më e lartë e kryetarëve.





Sa të thella dhe kuptimplote janë këshillat që Shejh Edebal i ka bërë Osmanit dhe përmes tij të gjithë autoriteteve shtetërore, bile çdo njërit prej drejtuesve që nga më i vogli e deri tek më i madhi:

O biri im! Je zotëri! Këtej e tutje:

Mërzitja dhe mëria le të jetë e jona, ndërsa bindja dhe pajtimi të tutë...

Fyerja të jetë e jona, zemërgjerësia e jotja...

Fajësimi i joni, pajtimi i yti...

Pafuqia e jona, toleranca e jotja...

Mospajtimet, përplasjet, mospërputhjet dhe mosmarrëveshjet le të jenë tonat, drejtësia e jotja...

Fjala e keqe, goja e papërmabajtur, komenti pa vend qoftë i yni, falja le të jetë e jotja...

O biri im!

Këtej e tutje të ndash na takon neve, ndërsa plotësimi apo bashkimi është për ty...

Dembelizmi na takon neve,

paralajmërimi, sakrifikimi dhe përforcimi të takon ty..."

Ja pra të gjitha këto nuk janë gjë tjetër vetëm se parime ekulibri që një person i cili merret me shërbim duhet t'u përshtatet.

## ***2. Ti japësh rëndësi të madhe dhe parësore shërbimeve në lidhje me mësimdhënien dhe nxënien e Kur'an-i Kerimit.***

Një nga detyrat më parësore dhe më të rëndësishme është edhe përcjellja e Kur'anit që është i dërguar si udhëzues njerëzimit duke filluar që nga vetja jote në radhë të parë dhe duke e mbartur atë edhe tek robërit e tjerë të Allahut. Në një hadith është thënë:

"Më i dobishmi prej jush është ai është ai që e mëson dhe ia mëson dikujt Kur'anin." (Buha-ri, Fedailu'l Kur'an 21) Shërbimi më i madh që mund t'i bëhet një njeriu, është ta ndihmosh atë që të fitojë të ardhmen e përhershme.

Kur'ani është një libër hyjnor, udhëzimi i të cilit do të vazhdojë deri në ditën e gjykimit. Çdo besimtar që qëndron nën hijen

e tij, duhet të jetë nën drejtimin e Kur'anit deri sa të arrijë në derën e përhershme të vdekjes. Ai duhet t'i qëndrojë besnik udhëzimit të Kur'anit në këtë drejtim dhe duhet ta ndjejë si obligim që me këtë porosi të lartë të projektojë dhe të reflektojë tek brezat e ardhshëm duke u bërë shkak i qetësisë dhe i udhëzimit të njerëzimit. Se sa madhore është një detyrë e tillë këtë na e tregon edhe kjo ngjarje e jetuar në periudhën e lumturisë:

Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s) kishte u dërguar rreth 70 mësues të Kur'anit të quajtur "kurra" fiseve Ra'l, Zekvan, Usajje, Benu Libjan sipas një kërkesë të tyre. Kur këta mbërritën në vendin e quajtur Bi'r-i Maune, një nga përfaqësuesit e këtyre fiseve i tradhtëtoi duke i vrarë ( duke i lënë shehit). Mbase i mbërriti Pejgamberit (a.s) ky lajm, plot një muaj rresht i mallkoi ato vrasës.

Pejgamberi ynë i mëshirës dhe i dhembshurisë nuk i mallkoi ata që e gjuajtën me gurë në Taif, por përballë tradhtisë së kryer ndaj mësuesve të Kur'anit gjuha e tij e bekuar i mallkoi përgjegjësit e këtij krimi, duke treguar kështu se sa gabim të madh bëjnë ata që pengojnë



Pejgamberi ynë i mëshirës dhe i dhembshurisë nuk i mallkoi ata që e gjuajtën me gurë në Taif, por përballë tradhtisë së kryer ndaj mësuesve të Kur'anit gjuha e tij e bekuar i mallkoi përgjegjësit e këtij krimi, duke treguar kështu se sa gabim të madh bëjnë ata që pengojnë shërbimin ndaj Kur'anit.

shërbimin ndaj Kur'anit.

Koha që jetojmë është një periudhë ku përpjekje të tilla janë jetësore. Shërbimi i vërtetë që mund të realizojë apo të mundësojë shkundjen përsëri dhe kthimin në vetvete të të gjithë ymetit në këtë kohë, është t'i japësh vlerë interesimit që të drejton ndaj Kur'anit.

Në kohën tonë kur njerëzit i janë drejtuar më tepër anës materiale, është e domosdoshme që mësuesit e Kur'anit t'u kushtojë më tepër kujdes dhe vëmendje nxënësve të tyre. Shpirti i nxënësit duhet të mbushet me dashurinë e mësuesit. Para se të fillojë me Elifbanë (Alfabetin) ai duhet të kuptojë dhe të mësojë të vërtetën e "Elifit". Në shpirtin e tij duhet të pasqyrohen shkëndija të dashurisë për Allahun dhe Profetin dhe ky shpirt duhet të brumoset dhe të formohet me këto ndjenja. Të gjitha bukuritë dhe madhësitë e Islamit duhet të gjejnë vend në zemrat e vetmuara. Si përfundim shërbimi ndaj Kur'anit është një punë shpirtërore që kërkon një kujdes tepër të madh dhe një dhuratë e madhe që Allahu ia ka dhuruar robit të vet.

### ***3. Ta zhvillosh përherë veten tënde si nga ana shkencore ashtu edhe nga ana etike***

Njeriu që shërben, për të dhënë një shërbim me kënaqësi nuk duhet ta lërë mënjatë zhvillimin e vetvetes. Përpjekja për të ecur përpara dhe për t'u zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme duhet të jetë një detyrë e natyrshme dhe parimore e tij. Ai që nuk ka një njohuri dhe përvojë të mjaftueshme dhe që nuk vlerëson zhvillimin etik

dhe shpirtëror të vetes së vet, një person që nuk e di punën e vet, nuk mund të bëjë një shërbim serioz.

Nga ana tjetër zhvillimi apo pjekuria dhe ndryshimi në jetë janë një ligj hyjnor që Allahu i Lartë e ka vendosur. Çdo qenie që nuk mund t'i përshtatet kësaj rrjedhe të jetës, do të fshihet dhe të zhduket me kohën. Në këtë aspekt edhe një njeri që shërben duhet ta ndjejë si detyrë dhe obligim të tij që ta zhvillojë veten e tij duke respektuar këtë ligj hyjnor, pasi një brez që ka dëshirë për punë është vepër e atyre personaliteteve të pjekur që kanë edukuar edhe nga aspekti shkencor dhe etik.

### ***4. Të dish dhe të kuptosh që gabimet janë nga vetja jote ndërsa sukcesi nga Allahu***

Është tepër e rëndësishme që të mos përzihet armiqësia në shërbimet e bëra për hir të Allahut. Një person që bën shërbim duhet të dijë që sukcesi nuk është apo nuk vjen nga vetja e vet por nga Allahu. Allahu i Lartë duke folur për sukseset e luftës së Bedrit, ka njoftuar se sukcesi i vërtetë në realitet është vetë Ai duke thënë: "(O i dashuri im!) Ju nuk i vratë ata në luftë por ishte Allahu Ai që i vrau. Edhe kur i hodhi ishte Ai që i hodhi"- (el-Enfal/ 17)

Besimtari nuk duhet të mburret për shkak të sukseseve të tij për sa i përket shërbimeve që bën duke besuar kështu se forca dhe fuqia janë vetëm prej Allahut. Përkundrazi ai duhet t'i shtojë më tepër falënderimet ndaj Allahut për forcën dhe fuqinë që i ka dhënë në realizimin e një shërbimi të tillë.



Një nga veprat më të rëndësishme që e prish ekuilibrin e brendshëm është edhe inati apo zemërimi.

Inati është një lloj pafuqie.

Ata që ndodhen në shërbime asnjëherë nuk duhet ta heqin as nga goja dhe as nga shpirti i tyre këtë lutje të të dërguarit Muhamed (a.s):

"O Zoti im! Të mbështetem Ty nga pafuqia, dembelizmi, frika dhe nga mungesa e takatit..."

(Buhari, Deavat, 38)



Njeriu i shërbimit nëse e respektton këtë etikë, zhvishet nga uni i vet dhe kështu rritet edhe modestia ndaj Allahut. Ai shpëton edhe nga ajo përkëdhelje që është edhe pika më e rëndësishme ku këmba rrëshqet gjatë shërbimit. Në ajetin kuranor thuhet:

“Mos u përkëdhel! Ta dish që Allahu nuk i do ato që përkëdhelen.”(el-Kasas/76)

“Uni” dhe “Pretendimi” janë kanceri i rrugës së shërbimit. Kurimi i kësaj sëmundjeje është mjaft i vështirë. Zakonisht nëpër teqe gjendet një pllakë në të cilën shkruhet “Hiç” e cila e shtyn njeriun të mendojë dhe gjykojë që të heqë dorë nga përkëdhelja dhe të kuptojë pafuqinë e tij. E gjithë çështja është që të kuptosh pafuqinë tënde dhe të jesh i vetëdijshëm për robërinë.

Ai që bën një shërbim nuk duhet të fajësojë dikë tjetër për shkak të disa mangësive që mund të dalin gjatë shërbimit, por duhet që fajin apo turpin ta kërkojë së pari tek vetja e tij. Ai duhet të dijë që t’i shfaq tolerancën tjetrit dhe ta vërë në

pyetje vetveten.

### **5. Përpjekja për të qenë shembull në shërbim**

Ata që merren me shërbim duhet që t’i futen vetë shërbimit me ndjenjën për t’u bërë, aq sa munden, zotërues i asaj pune dhe jo të ndjekin metodën e dhënies së punës dikuj tjetër. Ata që pandehin se bëjnë shërbim apo një punë duke dhënë urdhra rreth e rrotull të ulur në një qoshe pa e prekur punën as me dorë, janë ata njerëz që nuk kanë arritur të konceptojnë thelbin e çështjes.

Ai që qëndron në krye të shërbimit duhet që t’i shtrengohet punës në mënyrë më aktive dhe të bëjë përpjekje më tepër se të tjerët që janë nën urdhrat e tij, në mënyrë që të jetë shembull. Një sjellje e tillë do ta shtonte më tepër dëshirën dhe pasionin e vëllezërve dhe do të mundësonin që ata ta bënin shërbimin dhe punën e tyre me dëshirë dhe pasion. Shumë shembuj të kësaj natyre mund t’i shohësh me shumë qartësi tek jeta e të Dërguarit të Allahut. Mbartja e gurëve nga Profeti Muhamed dhe ashabët në kohën e ndër-

timit të mesxhidit Kuba dhe të Mesxhidi Nebevi, puna që bëri së bashku me ta në luftën e Hendekut dhe aq më tepër shërbimi që u bëri kohë pas kohe edhe vetë ashabëve janë disa nga shembujt e kësaj natyre.

Shprehja e të Dërguarit të Allahut “Zotëria i një fisi është ai që i shërben atyre.”(Dejlemi, Musned, II, 324) nxjerr në pah faktin se ata të cilët ndodhen në krye të detyrës duhet që të kenë një shpirt që jep shërbim dhe jo që pret prej të tjerëve.

### **6. Mos ta humbësh atë emocion që të jep shërbimi dhe t’i qëndrosh fjalës së dhënë**

Ajo që e bën njeriun të nxitojë drejt punës dhe shërbimit dhe që mundëson ta realizojë atë me pasion dhe dëshirë është pikërisht emocioni, pasioni dhe dashuria që qëndron në shpirtira.

Disa personave që merren me shërbime për një kohë të gjatë, me kohë u krijohet si një ndjenjë ngopjeje ndaj shërbimit dhe një situatë e tillë është

Të bësh një shërbim me tolerancë, dhembshuri dhe është një punë shpirtërore që kërkon një durim dhe shërbim është i brumosur me cilësi të larta etike, si: m qëndron larg smi



fillimi i një rreziku për atë që merret me shërbim. Ndjenja e të menduarit “Mjaft tashmë” është një shkëndijë që e tërheq njeriun drejt kësaj bote. Ky transmetim i përcjellë nga Ebu Imran e nxjerr në pah shumë qartë rëndësinë dhe domosdoshmërinë që mbart fakti për të mos humbur gjatë gjithë jetës emocionin që të dhuron pikërisht shërbimi.

Në një rrethim të Stambollit në të cilën merrte pjesë edhe Ebu Ejjub el- Ensariu në kohën e Emevijëve, njëri nga Ensarët e pat marrë kalin e tij me vete deri tek Bizantinët dhe pat mbetur në mesin e tyre. Besimtarët që e panë atë duke u nisur nga ajeti kuranor “Mos e hidhni veten me duart tuaja në rrezik”, patën mbetur të habitur duke thënë: “La ilahe il-lallah! Shihni këtë! Ai e hedh veten me vetëdije në rrezik!”

Pas kësaj Ebu Ejjub el- Ensariu pat thënë:

O besimtarë! (Mos të keqkuptohet!) Ai ajete kuranor është zbritur për në shoqërinë e Ensarëve. Kur Allahu e ndihmoi

Pejgamberin e tij dhe kur solli fitore të fesë ne patëm thënë: “Atëherë të qëndrojmë në krye të mallrave tona dhe të merremi me drejtimin e tyre.” Pas kësaj Allahu Teala i shpalli këtë ajete Kur’anor të Dërguarit të Tij

“Shpenzoni në rrugë të Allahut dhe mos e shkatërroni veten me duart e juaja.” (El- Bakare/195) Ajo që nënkuptohet nga shprehja “të rrezikosh veten tende me duart e tua” të braktisësh dhe të lësh mënjane shërbimin dhe përpjekjen në rrugë të Allahut duke u marrë me kopshtin apo punën tende.” Ebu Ejjub el- Endsari duke i dhënë rendësi dhe duke i kushtuar kujdes me gjithë sinqeritetin e tij kësaj urdhërese hyjnore, asnjëherë nuk qëndroi mbrapa shërbimeve në rrugë të Allahut dhe më në fund u varros pranë mureve rrethues gjatë një udhëtimit ku mori pjesë. (Shih: Ebu Davud, Xhihad, 23, Tirmidhi, Tefsir, 2)

Fakti që Ebu Ejjub El- Ensariu vazhdonte akoma të qëndronte në shërbime deri në moshën 80 vjeçare, megjithëse kishte pasur fatmirësinë që të kishte

në shtëpinë e vet për gjashtë muaj Pejgamberin Muhamed (a.s) dhe që kishte qenë me të në sa e sa udhëtime, është një shembull mjaft i bukur dhe i qartë se ndjenja dhe emocionin që të dhuron besimi qëndron e papërkulur dhe e fortë gjatë gjithë jetës.

Besimi që e lidh besimtarin me Allahun fuqiptotë në të njëjtën kohë është edhe një emocion. Syri i një besimtarit që ka një emocion të tillë nuk duhet të frikësohet nga asgjë, nuk duhet t’i thahet pasioni i madh i tij dhe nuk duhet të bjerë në pesimizëm. Pasi edhe Allahu i Lartë i urdhëron kështu besimtarët që të mos bien asnjëherë në plogështi:

“Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni sepse ju gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë.” (Al-i Imran/139)

Të bllokohesh para vështirësive dhe problemeve dhe të futesh në pesimizëm, të paraqesësh veten të mposhtur dhe të tërhiqesh është mungesë fuqie. Dhe një pafuqi e tillë nuk i shkon një myslimani. Ata që

mëshirë në shërbim të qenies dhe krijesës së Allahut e sakrificë të fortë. Një njeri i pjekur dhe i matur në mëshira, dhembshuria, sakrifica dhe zemërgjerësia. Ai rrës dhe urrejtjes.

ndodhen në shërbime asnjëherë nuk duhet ta heqin as nga goja dhe as nga shpirti i tyre këtë lutje të të dërguarit Muhammed (a.s):

“O Zoti im! Të mbështetem Ty nga pafuqia, dembelizmi, friksha dhe nga mungesa e takatit...”(Buhari, Deavat, 38)

Çelësi më kryesor i suksesit në shërbim është durimi. Allahu Teala në ajetin kuranor thotë:

“O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë, bëhuni të vendosur dhe vigjilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun që të shpëtoni!”(Al-i Imran/200)

Është tepër e natyrshme që një person i cili merret me shërbime të përballohet me lloj lloj sakrificash dhe mundimesh. Ja pra, nëse tregohet tolerancë përballë këtyre vështirësive dhe nëse vazhdohet me durim në këtë rrugë, do të vijë ndihma hyjnore dhe me ndihmë të Allahut do të arrihet sukcesi.

Si përfundim, pranimi nga ana e Allahut i shërbimeve të bëra, varet nga realizimi me kujdes dhe me etikë serioze të tyre. Ashtu sikurse në të shumtën e rasteve nuk është e mundur që të merren rezultate të pritura nga përpjekjet e bëra, madje nganjëherë mund të merren edhe rezultate të padëshirueshme. Në këtë këndvështrim njeriu që merret me shërbim, duhet të zotërojë njohuri dhe aftësi në fushën e këtij shërbimi. Nëse nuk fitohet kjo vlerë ashtu sikurse nuk do të mund të bëhet një shërbim i



duhur, mund të ndodhë edhe e kundërta që të bëhet një shërbim i dëmshëm. Shërbimet e bëra në mënyrë të rregullt dhe të plotë asnjëherë nuk humbasin. Allahu Teala në Kur'an urdhëron e thotë:

“...Ne asnjëherë nuk e humbasim veprën e atij që e bën punën më të mirën e mundshme.”(el-Kehf/30)

Edhe Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s) ka thënë:

“Allahu Teala e do atë që e bën punën më mirë dhe më bukur”(Dejlemi, Musned, I, 157)

Ashtu siç mund të kuptohet edhe nga këto të dhëna, njeriu që merret me shërbim, është

të i obliguar që të mësojë se si mund të bëhet puna e tij sa më mirë të jetë e mundur në mënyrë që të pranohet edhe nga ana e Allahut. Pasi të bësh një shërbim me tolerancë, dhembshuri dhe mëshirë në shërbim të qenies dhe krijesës së Allahut është një punë shpirtërore që kërkon një durim dhe sakrificë të fortë. Një njeri i pjekur dhe i matur në shërbim është i brumosur me cilësi të larta etike, si: mëshira, dhembshuria, sakrifica dhe zemërgjerësia. Ai qëndron larg smirës dhe urrejtjes.

Gjithashtu njeriu i cili merret me shërbim në çdo lloj grupimi shoqëror që të bëjë pjesë, mund të ruajë dhe të mbrojë besimin, emocionin dhe ekzistencën e tij në çdo rast dhe moment, është ai njeri që zemrën e mban larg çdo dyshimi, interesi, posti dhe pasurie, është ai që u jep shpirt dhe i dëgjon thirrjet e pazëshme të të vetmuarve që presin një shërbim.

Zoti ynë na e mundësoftë që të marrim pjesë siç duhet nga këto parime etike. Zoti ynë na mundësoftë një jetë në shërbim të mbushur plot me përpjekje, mund dhe sakrifica që do të na bëjnë të ndjejmë në shpirtin tonë përgjegjësinë për mundësitë që kemi për të dhënë në shërbimin tonë në vende të ndryshme, por që nuk mund ta japim. Gjithashtu na mundësoftë të gjithë neve të na japë atë emocion që të dhuron shërbimi në zemrat tona që të bëjmë përpjekje për të arritur suksesin për të fituar pëlqimin e Tij.

Amin!



# KURBANI - SAKRIFICA DHE NORMA E TIJ NE SHERIATIN ISLAM

Për gëzimin e familjeve të pasura apo të varfra, Allahu i Madhëruar ka paraparë dy festa madhështore për myslimanët. Këto festohen vetëm një herë në vit. Ato janë Fitër Bajrami dhe Kurban Bajrami. Që të dy këto festa sjellin lumturi dhe hare në familjet myslimane. E para, se pas një muaji që myslimanët agjërojnë, Allahu i shpërblen me sevape që vetëm Ai i di. Festa e dytë është ajo e Kurban Bajramit, ku gjatë kësaj kohe myslimanët nga çdo kënd i botës shkojnë për të kryer haxhillëkun. Disa kryejnë obligimin e prerjes së kurbanit, ndërsa të tjerët, që nuk kanë mundësi materiale, mirëpresin mishin e kurbanit që u dhurohet nga pasanikët myslimanë. Kjo është sakrifica e madhe që myslimanët e bëjnë në përkujtim të aktit të Ibrahimit (a.s.) i cili qe i gatshtëm të sakrifikonte djalin e tij, Ismailin (a.s.).

Historiku i prerjes së Kurbanit e ka zanafillën qysh nga koha e Ibrahimit (a.s.) (Saffat, 37/102-107) Kjo traditë apo normë fetare është edhe në sheriatin që solli Muhamedi (a.s.) nga Allahu (xh.sh.) Nga kjo konstatojmë se prerja e kurbanit ka ekzistuar tek çdo popull. Në këtë kontekst Allahu i Madhëruar thotë: “Ne i kemi caktuar çdo popull vend therjen (e kurbanit), që ta përmendin emrin e Allahut për



Është traditë që kurbanit të ndahet në tri pjesë, por kjo është e vërtetuar edhe me traditë profetike.

arsye se i furnizoi ata me kafshët” (Haxhxxh, 22/34)

Kurban (udhijje) quhet ajo kafshë e cila është bërë nijet që në ditët e caktuara dhe në një kohë të caktuar të pritet me qëllim afrimin tek Allahu (xh.sh.) Prerja e kurbanit është lejuar që në vitin e dytë hixhri, dhe është argumentuar me Kur’an, synet, ixhma dhe kijas: “Prandaj ti falu dhe pre kurban për hir të Zotit tënd!” (Kevther, 108/3); “E devet (therrjen e tyre për kurban) ua kemi bërë prej dispozitave të Allahut” (Haxhxxh, 22/36). Hadithi; “Kush ka mundësi të presë kurban e nuk e pret, le

të mos i ofrohet xhamisë” (Ibn Maxhe, Edahi, 2; Ahmed Ibn Hanbel, Musned, II, 321)

Në lidhje me normën e prerjes së kurbanit, juristët myslimanë kanë mendime të ndryshme. Disa thonë se ai është vaxhib, ndërsa disa të tjerë e konsiderojnë sunneti muekkede. Në këtë rast shumica e dijetarëve hanefi thonë se është vaxhip për ata që kanë mundësi materiale.

## *Kafshët që mund të priten për kurban*

Pasi që Allahu i Madhëruar njeriun e bëri mëkëmbës të misionit të Tij në këtë botë, Ai çdo krijesë tjetër e vuri në shërbim të tij. Për këtë, prerjen e kurbanit nuk e kufizoi vetëm me një kafshë, por i dha edhe alternativa të tjera. Nga kafshët që mund të priten për kurban mund të numërojmë dhinë, delen, lopën dhe llojet e saja, gjedhi dhe deveja, qofshin këto të gjinisë mashkullore apo femërore.

## *Kushtet që duhet t'i plotësojë kafsha*

Kërkohet dhe është kusht që kafsha e cila bëhet nijet për t'u prerë kurban duhet të mos jetë shumë e dobët, të mos jetë e verbër në njërin apo të dy sytë, të mos jetë e sëmurë, dhe të mos ketë ndonjë sakatllëk. Por dijetarët, në krahasim me këto të meta, kanë thënë se është





mekruh dhe pengesë që kafsha e cila do të bëhet kurban ta ketë këmbën e thyer, të jetë e lodhur sa që të mos ketë mundësi të ecë gjerë tek vendi ku do të theret, t'i ketë dhëmbët e rënë (nëse shumicën e dhëmbëve e ka, atëherë lejohet), nëse është e lindur pa vesh, nëse i ka të prera majat e gjinjve apo të thara, nëse gjinjtë i ka të zëna e nuk i rrjedhin as një pikë qumështi, të jetë nga ato që kanë gjëra të fëlliqura, ta ketë të prerë një të tretën e veshit apo bishtit. Të gjitha këto kafshë nuk mund të bëhen kurban. Nëse këto duken pasi të blihet kafsha për kurban, atëherë, po qe se blerësi është i pasur, mirë është që të blejë një tjetër apo ta ndërrojë, kurse ai që nuk ka mundësi ta bëjë këtë, e mban atë që e ka blerë.

### ***Koha e prerjes së kurbanit***

Prerja e kurbanit duhet të bëhet brenda 3 ditëve të bajramit, d.m.th. nga koha e kryerjes së namazit të bajramit gjerë në ditën e tretë para perëndimit të diellit. Lejohet që edhe në mbrëmje të pritet, por kjo është mekruh tenzihen. Natyrisht

që therësi i kurbanit duhet që të jetë mysliman, i lirë, i vetëdijshëm, vendas dhe të jetë në moshën madhore. Me prerjen e kurbanit janë të obliguar vetëm myslimanët, kurse jomyslimanët nuk kanë obligime fetare.

### ***Numri i viteve që duhet të ketë kurbanit***

Juristët myslimanë, lidhur me këtë çështje kanë mendime të ndryshme, por jo me dallime të mëdha. Sipas Hanefive, dhia duhet të ketë plotësuar një vit komplet dhe të ketë hyrë për në vitin e dytë. Lopa dhe llojet e sajë dhe gjedhi duhet të ketë mbushur dy vite të plota dhe të ketë hyrë për në vitin e tretë, kurse deveja të plotësojë pesë vite dhe të hyjë në vitin e gjashtë. Delja sipas Hanefive duhet të jetë dy vjeçare, kurse sipas disa Shafiive dhe Malikive mjafton që të ketë mbushur një vit dhe të ketë hyrë për në vitin e dytë. Kurse sa i përket qengjit i cili ka mbushur gjashtë muaj dhe ka hyrë për në muajin e shtatë, lejohet që të bëhet kurban me kusht që të jetë i majmë sa një dele apo në

rast se kur qengji të shikohet nga larg në mesin e deleve, të mos dallohet se është qengj.

### ***Numri i personave që mund të presin kurban***

Lejohet bashkimi i disa personave që të therin një kafshë të madhe si lopën, gjedhin apo devenë. Delja dhe dhia bëhen kurban vetëm për një person dhe nuk lejohet për më tepër. Kurse kafshët e mëdha mund të priten për shtatë persona, por jo për më tepër se shtatë. Lejohet që më pak se shtatë persona të bashkohen në therjen e një kafshe të madhe p. sh. dy, tre, katër etj. Mirëpo në këtë rast duhet pasur kujdes rreth një çështje shumë me rëndësi. Sot kur në mesin tonë, ata të cilët bashkohen në prerjen e kurbanit janë të pasur vërejmë se ka nga këta njerëz që, kur vjen koha e prerjes së kurbanit, ata llogarisin më shumë mishin e kurbanit që do të rezervojnë në frigorifer, duke harruar se qëllimi i therjes së kurbanit nuk është ky. Ata bashkohen p. sh. katër persona dhe e ndajnë lopën në katër pjesë, kështu që këta katër persona kur ta shpërndajnë mishin në 3 pjesë, një për vete, për komshiun dhe për të varfrin, atëherë kjo lopë i bie të ndahet në 12 pjesë ( $4 \times 3 = 12$ ). Nga kjo del se nga ky mish i ndarë në 12 pjesë, katër pjesë i mbesin pronarëve që e kanë therur lopën dhe vetëm 8 pjesë u shpërndahen të tjerëve, ndërsa po qe se këtë lopë e presin 7 veta e të kenë pjesë nga kjo 21 familje – gjegjësisht 14 familje të varfra (sepse 7 pjesë ndalen për pronarët). Kur bashkohen vetëm katër persona apo edhe më pak të varfrit e tjerë nuk kanë

mundësi të gëzohen në ditën e bajramit, atëherë lind bëhet pyetja se a lejohet që vetëm dy apo katër persona ta therin një kafshë të madhe? Përgjigjja është se po, lejohet, por nëse e marrin parasysh këtë që theksuam, atëherë më mirë është që të bashkohen shtatë veta në mënyrë që të shpërndahet më shumë mish.

### *Ndarja e mishit të kurbanit*

Siç e theksuam edhe më lart, është bërë traditë që kurbanit të ndahet në tri pjesë, por kjo është e vërtetuar edhe me synet. Një të tretën e merr personi që bën kurbanin, një të tretën ia dhuron komshiut, të afërmit edhe nëse këta janë të pasur, ndërsa një të tretën që mbetet ia jep të varfërve. Në këtë kontekst Allahu thotë: “Hani pra prej tyre (kurbaneve) dhe ushqeni ata që kanë mbetur ngushtë dhe të varfëritë”, “...hani prej tyre dhe ushqeni nevojtarin dhe atë që lyp...”. (Haxhxh, 22/28, 36)

### *Pjesët e mbetura nga kurbanit*

Këtu hyjnë lëkura, koka, këmbët apo edhe mishi i tij, të cilat janë haram që të shiten. Nëse lëkura shitet dhe paratë e saj dhurohen tek vendtubimet e ndihmave, atëherë kjo lejohet. Nëse kasapi e pret kurbanin, nuk lejohet t’i jepet atij, t’i jepet vlera në para, d.m.th. të mos i jepet mish nga kurbanit. Këto pjesë që përmendëm duhet t’u dhurohen falas atyre që kanë nevojë. Nëse pronari ka nevojë që lëkurën ta mbaje për vete, kjo lejohet.

## **MËNYRA E PRERJES SË KURBANIT (KAFSHËS)**

Një nga çështjet kryesore që duhet të ketë parasysh pronari i kurbanit, është fakti se duhet që vetë ai apo kasapi që e pret kurbanin së pari të bëjë nijetin dhe të fillojë punën me emrin e Allahut; pra të thotë Bismil-lah, Allahu ekber. Nga kushtet tjera që duhet të ketë parasysh therësi, është se mjeti prerës duhet të jetë i mpohur mirë, në mënyrë që të mos mundohet kafsha, e cila duhet të kthehet nga drejtimi i kiblës. Të rrëzohet ngadalë pa e munduar. Duhet që të theret në fyt duke i prerë të dy damarët e qafës dhe gabzherin. Sipas disa dijetarëve nuk



Historiku i prerjes së Kurbanit e ka zanafillën qysh nga koha e Ibrahimit (a.s.) (Saffat, 37/102-107) Kjo traditë apo normë fetare është edhe në sheriatin që solli Muhamedi (a.s.) nga Allahu (xh. sh.) Nga kjo konstatojmë se prerja e kurbanit ka ekzistuar tek çdo popull.

lejohet që t’i pritët palca dhe se ky veprim është haram; kurse sipas disa të tjerëve prerja e saj është mekruh.

Mënyra siç praktikohet sot nga kasapët, të cilët përmes plumbit apo me të shpuar në kokë e rrëzojnë kafshën dhe i humbin vetëdijen, nuk është aspak e pëlqyer. Një veprimi i tillë është i ndaluar, sepse kafsha aty e humb vetëdijen, pasi që kafsha nuk ka mundësi që të kthehet në gjendjen e më parme, nëse qëndrojmë për ta pritur një kohë dhe kjo nuk vjen në vetëdije, atëherë konstatojmë se kjo kafshë është mbytur. Por pasi që kjo çështje është e diskutueshme, nuk mund të themi në mënyrë të prerë se kjo është haram. Qëllimi i prerjes së kafshës është derdhja e gjakut, nëse gjaku nuk derdhet atëherë do të mbesë në mish. Duke e pasur parasysh se pira e gjakut apo përzieja e tij me mish është haram, atëherë përsëri mund të konstatojmë se me shpimin e kafshës në kokë gjaku do të përzihet me mishin. Në këtë mënyrë edhe mishit do i humbet shija por edhe do të hamë mish të ndaluar. Këtë më së miri e dinë kasapët që kanë përvojë, se a rrjedh gjaku apo jo. Neve na mbetet të theksojmë vetëm se nuk duhet të veprohet në këtë mënyrë.

#### Referencat:

- Abdurrahman el-Xheziri, “Kitâbu’l Fikhi Alâ Medhâhibi’l Erbea”, Dâru’l Fikr, Bejrut, 2002
- Ibni Rushd el-Hafid, “Bidâjetu’l Muxtehid Nihâjetu’l Muktesid”, boton; Beyan Yayinlari, Stamboll, 1991
- Ilmihal II, “Islam ve Toplum”, grup autorësh, boton; Türkiye Diyanet Vakfı, Ankara, 2003.
- Molla Husrev, “Dureru’l Hukkâm fi Sherhi Gureri’l Ahkâm”, përktheu Arif Erkan, boton, Ensar Nesriyat, Stamboll, 1979.
- T. D. V. Islam Ansiklopedisi, vëll. 26, Ankara 2002.
- Vehbete Zuhajli, “el-Fikhu’l Islâmiyyu ve Edil-letuhû”, Dâru’l Fikr, Dimeshk, 1985.



## Dialogu ndërkulturor:

# Themel për kultivimin e marrëdhënieve të shëndosha ndërnjerëzore

Në dhjetëvjetëshin e fundit ka filluar të përmendet më shpesh fjala dialog si edhe të organizohen diskutime në tryeza e simpoziume shkencore me qëllim aktualizimin e dialogut për tema të ndryshme aktuale të kohës sonë.

Janë mbajtur takime për dialogun ndërmjet qytetërimeve, ndërmjet feve etj. Sot këtu, është vënë në tryezë Dialogu ndërkulturor.

Procesi i dialogut në shoqërinë njerëzore ka qenë gjithmonë aktual, herë më shumë e herë më pak, dhe në nivele të ndryshme, si në atë politik, kulturor, ekonomik, fetar, teknik..., por jo gjithmonë në nivelin dhe në fushën e merituar. Për shembull, shekulli njëzet karakterizohet me kultivimin e frymës së luftës së ftohtë me gara në armatim, tensione midis fuqive të mëdha, me ankth e frikë të popujve të vegjël etj. Edhe në këtë periudhë është zhvilluar një farë dialogu, por jo ndërkulturor. Ishte koha e reklamimit të forcave...

Unë do të përmend kalimthi dialogun ndërmjet qytetërimeve dhe dialogun ndërmjet kulturave – vetëm shkurtimisht – për të trajtuar më gjerësisht një nga format e dialogut ndërkulturor që sipas bindjes time është dialogu ndërkulturor i zhvilluar. Ai zhvillohet në formën e shkruar dhe që në esencë proklamon forcën e moralit, kulturës shpirtërore e mirëqenies njerëzore, dhe

jo forcën teknike për shkatërrimin e njerëzimit.

Unë mendoj se akoma duhet të diskutohet edhe më shtruar përkitazi me nocionin qytetërim dhe kulturë. Mendimi se qytetërimi është tërësia, kurse kultura dhe faktorë tjerë janë vetëm pjesë e qytetërimit nuk është mendim i qëlluar dhe as i qëndrueshëm. Njeriu – njerëzimi, fillimisht njohu kultin për krijuesin e vet dhe më vonë qytetërimin. Qytetërimi sipas S.Ranismen mund të ketë dy rrugë të zhvillimit:

Qytetërim barbar dhe qytetërim i kulturuar.

Qytetërimi shfrytëzon, në radhë të parë, burimet fizike dhe më pas edhe ato kulturore e shpirtërore të njerëzve, prandaj në situata të caktuara i imponon kulturës oportunitetin ose ç'është edhe më keq ndonjëherë e shtyn të vihet në shërbim të qytetërimit, qoftë

edhe qytetërim barbar. Këto nuk janë çështje të thjeshta dhe as diskutime të lehta. Për këto duhen angazhime të gjithanshme dhe konstruktive, jo me tendencë të mbizotërimit të forcës fizike, por me qëllim që t'i hapet rrugë arsyes dhe dialogut ndërkulturor që është në dobi të mbarë njerëzimit, pa ndjenjën e superioritetit, as atë të inferioritetit. Këtë mund ta bëjnë vetëm kulturat e zhvilluara pa imponim të qarqeve e ideologjive çfarëdo qofshin ato: politike, strategjike, ekonomike, ushtarake etj.





Njerëzimi duhet të bëjë një gjë, të heq dorë nga bindja iluzore se ai është sovran dhe është në gjendje të veprojë pa ndihmën e askujt. Po të kishte qenë kështu, në Kur'an nuk do të thuhej njerëzve "... ju jeni nga njëri- tjetri... dhe për njëri- tjetrin.... Në anën tjetër Krijuesi i gjithësisë na tërheq vërejtjen se na ka krijuar çift, mandej na thotë se duhet "ta njihni njëri-tjetrin... Njohja e njëri-tjetrit bëhet përmes fjalës dhe dëgjimit me respekt të njëri-tjetrit dhe me dialogim ndërkulturor, siç porosit Kur'ani, nuk bëhet me ekskomunikimin e tjetrit vetëm se ka fe apo flet gjuhë tjetër, aq më pak bëhet përmes shpatës e barutit.

Gjithë këto qëe thamë na shtyjnë kah përfundimi se të tëra krijesat kanë nevojë për njëra-tjetrën, sidomos njerëzit, dhe se realizimi i këtyre nevojave nuk mund të arrihet ndryshe vetëm përmes dialogut ndërkulturor.

Dialogu si mjet dhe mënyrë për ndërtimin dhe kultivimin e raporteve ndërnjerëzore është i vjetër sa edhe vetë njeriu. Kjo nënkuptohet nga fakti se njeriu si krijesë është e vetmja krijesë që është e pajisur me cilësinë e të folurit dhe di të artikulojë zërin, tonin dhe di të harmonizojë mendimet e veta në një formë shumë të përsosur dhe këto ide e mendime di t'i shpreh edhe me shkrim.

Hazreti Ademi (a.s.) dialogun më konkret e zhvilloi me djemtë e vet, Kabilin dhe Habilin, në rastin e mospajtimit të tyre rreth martesës, kur u tha të presin nga një kurban...

Kështu ka vazhduar edhe Jakubi (a.s.), i cili pasi e dëgjoi rrëfimin e ëndrrës së Jusufit i tha "Mos ua trego ëndrrën vëllezërve..." Kështu ka vazhduar edhe në kohëra të tjera.

Dialogu edhe si formë letrare është paraqitur shumë herët. Këtë formë e futën në përdorim filozofët e Greqisë së vjetër, Sokrati dhe Platoni.

Unë këtu për dialogun do të filloj nga shekulli i shtatë dhe do të mbështetem në burime të dorës së parë, për të cilat kanë qasje të gjithë

ata që merren me studime të historisë, letërsisë, historisë së kulturës etj.

Paraprakisht, më duket e rëndësishme të përmend disa ajete të Kur'anit që na sugjerojnë se jemi krijesa çift dhe asnjë krijesë nuk mundet pa tjetrin – qoftë ta marrim në kuptimin individual apo në konceptin më të gjerë, shoqëror. Kur'ani thotë *haleknakum zevshejni...*, mandej, jo vetëm si individ, i kufizuar vetëm në dy vetë, por edhe në shumës – si nevojë e individit të bisedojë, të qajë hallet me shumicën, *shavirhum fi-l-emri... litearefu*, ngase ajeti i fundit kërkon dialogun dhe angazhimin e ndërsjellë...

Në frymën e këtyre ajeteve Pejgamberi Muhamed (a.s.), pasi u zgjerua rrethi i atyre që pranuan thirrjen e tij dhe përqaftuan fenë Islame, hapin vijues e bëri me shkrim. Këtë hap e ka bërë, sigurisht, në pajtim me thirrjen e Kur'anit "Ejani të bisedojmë, të merremi vesh për gjërat që i kemi të përbashkëta – e kjo bisede e marrëveshje, pa diskutim të ndërsjellë nuk mund të merret me mend.

Kjo flet për një vetëdije kulturore të lartë, ngase nuk fillon nga dallimet por nga pikëpjekjet e përbashkëta, dhe, nuk paraqitet me diktat por me urtësi. Diktati është metodë e qytetërimit, zhvillimit teknik, dhunës, kurse dialogu është metodë e kulturës dhe jo dhunës. Ai u dërgoi mesazhe me shkrim disave nga paria e fiseve arabe dhe disa sunduesve të popujve tjerë fqinjë: Mukavkisit, Kisraut, Herakliut etj...

Dialogu ndërkulturorë është reflektuar në masë shumë të madhe, sigurisht në tëra nivelet kulturore e artistike.

Në dialogun ndërkulturor është e pashmangshme ikja nga roli dhe dialogu ndërfaqësor. Konstatimi se numri i grupeve të njerëzve që flasin gjuhë të ndryshme arrin deri në njëzetekatër mi nxjerr në shesh dialogun e zhvilluar në shkallë të ndërdijes – jo të vetëdijes – me Pejgamberin Muhamed a.s. i cili ka thënë se numri i të dërguarve: resul dhe nebij, është 24 mi.

Këtu do të përmendi disa ilustrime që u

referohen veprave filologjike.

Vështroni termat sherif dhe chandelier.

I pari ka arrit në SHBA dhe atje ka bartë edhe formën edhe funksionin që e ka në origjinal, në gjuhën arabe. Ka pësuar vetëm ndryshime minimale që ka të bëjë me rrethana dhe vende konkrete. Sherif do të thotë: fisnik, njeri me autoritet, të cilit i shkon fjala, fjala e tij nuk kthehet pas – ajo duhet zbatuar. Ndryshime mund të ketë, fjala vjen te shtrirja e kompetencave të sherifit në SHBA-ës dhe Mekës e Medinës, prej nga ka ardhur termi sherif, por ato ndryshime janë rrjedhojë e kohës dhe vendeve konkrete.

Termi i dytë, ka pësuar ndryshime në formë, porse funksioni praktik është i njëjtë si në gjuhën turke që e ka fjala shamdan... Ky është një mjet, në të cilin vendoset një a më shumë qirinj për të bërë dritë, i cili është përdor para se të zbulohej rryma elektrike.

Si rezultat i dialogut ndërkulturorë në radhë të parë, është aplikimi dhe vënia e energjisë elektrike në shërbim të tërë njerëzimit. Ai dialog ka kultivuar Homerin, D. Aligerin, Goten, A. Mojsiun, O. Sherifin, I. Kadaren, S. Frashërin.. etj., por është edhe rezultat i harmonizimit të qytetërimit-zhvillimit tekniko- industrial me kulturën

Nikolla Tesla, një hulumtues i zellshëm nga hapësira e varfër e Ballkanit, vetëm në SHBA arriti të shpijë përpara hulumtimet dhe eksperimentet e nevojshme për të provuar rezultatet konkrete të idesë së tij gjeniale.

Po të mos kishte qenë dialogu ndërkulturor lindje-perëndim, në Itali, nuk do të ishte Danteja me Komedinë hyjnore.

Po të mos ishte harmonizimi i Stambollit me Janinën, nuk do të ishte Sami Frashëri me Kamusët e tij të përmendur një gjuhësor, dygjuhësor dhe enciklopedik si Kamusu-l-alam, Kamus-i-turki, Kamus-i-fransavi, Kamus-i-arabi, dhe një varg veprash tjera që shpijnë e trasojnë rrugë të gjera për bashkëpunim e bashkëbised-

im të popujve me gjuhë e me kultura të ndryshme, siç bën Turqia me shqiptarët sot.

Sikur të mos kishte qenë dialogu ndërkulturor Paris – Tiranë, letërsia shqiptare dhe ajo evropiane a botërore nuk do të kishte një Kadare çfarë e ka sot.

Kultura është kulturë. Nuk ka kultura të mëdha e kultura të vogla.

Mund të ketë kultura të popujve e shteteve të mëdha, kultura të popujve të vegjël e shteteve të vogla dhe mund të ketë nivele të ndryshme kulturore, nivel të lartë, nivel mesatar dhe nivel të ulët kulturor, që janë të kushtëzuara nga rrethana të caktuara kohore dhe hapësinore, por ama një shkallë të kulturës e disponon çdo krijesë me intelekt sado e kufizuar qoftë.

Këto nuk maten me madhësinë fizike por me madhësinë shpirtërore

Shkrimet janë faktori që i ka vënë në kontakt kokat kreative si Danteja, Goteja, Shardeni, Galandi, Samiu, Hafizi, Fuzuli, Ibn Rushdi, Al-Maarri, Mehmet Akifi, N.Hikmeti, T.Husejni, N.Mahfuzi, Al-Bajati, Dervishi... e deri te Kadareja e Z.Gërvalla, që ta shpijnë edhe më tej dhe ta thellojnë dialogun ndërkulturor përtej kufijve politikë e ideologjikë.

Ndarjet politike e ideologjike, të inkurajuara nga qytetërimi barbar e shtypin faktorin kulturor dhe tentojnë të ndajnë popujt me thirrje për ekskluzivitet – jo për dialog. Ata në gojë kanë dialogun por në zemër monologun dhe bisedojnë me vetveten, nuk kanë forcë shpirtërore të bisedojnë me të tjerët. Mbasi t'ua mbjellin farën e ftohjes ndërmjet veti, i nxisin kundër njëri tjetrit me qëllim të përfitimeve materiale të një grupi të vogël njerëzish, apo vetëm të disa individëve.

Bota e sotme duhet të nxjerr mësimë dhe të kujdeset për kulturën dhe dialogun ndërkulturor në mënyrë që të mos bie nën ndikimin e politikës ditore destruktive, por të mbajë qëndrim kulturor-human. Duhet të kundërvihet me forcën e kulturës, tendencave të qytetërimit

barbar që plasojnë pengimin e integriteteve kulturore, ekonomike e shoqërore.

Dallimi i këmbimeve ndërkulturore, në raport me këmbimet ndërmjet qytetërimeve është se, i pari sa më shumë që të japë bëhet edhe aq më i pasur, askush nuk varfërohet, kurse ky i dyti vetëm duke marrë pasurohet...

Njerëzimi sot i ka në tryezë fatin dhe fatkeqësinë, prandaj merr përsipër edhe përgjegjësinë që i takon.

Fati i njerëzimit është në harmonizimin e kulturës dhe qytetërimit. Ky harmonizim mund të arrihet vetëm me qytetërimin e kulturuar, i cili e pranon edhe kulturën e tjetrit, respektivisht pranon dialogun si formë për njohje të ndërsjellë.

Fatkeqësia qëndron në vënien e kulturës në shërbim të qytetërimit barbar, i cili është ekskluziv. Nuk e pranon askënd tjetër. Jeton në iluzione se vetëm ai meriton të jetojë kurse të tjerët, pa përjashtim duhet të mendojnë dhe të sillen sipas diktatit të tij.

Fati është në harmonizimin e qytetërimit me kulturën... ( Stambolli e S. Frashëri, N.Teslla e ShBA, Parisi e I. Kadareja etj.)

Fatkeqësia është në mosrespektimin e kulturës së tjerëve. (Romakët me bibliotekën e Aleksandrisë,

luftërat e fundshekullit 20. në Ballkan dhe tjera .)

\* \* \*

Bota le të bëjë gara kush do të bëjë më shumë biblioteka, libra, teatro, takime ndërkulturore, rrugë a hekurudha për tua lehtësuar jetën njerëzve dhe komunikimin reciprok,

Në vend se të bëjnë gara, se kush do të bëjë më shumë armë apo të prodhojë më shumë barot e dinamit, apo mjete tjera për shkatërrimin e njerëzimit...

Le të bëhen gara kush do të hap më shumë shkolla në vende të ndryshme, kush do të këmbëjë më shumë studentë ndërmjet tyre, për të njohur kulturat e ndërsjella...

Sa më shumë libra, teatro e salla leximi aq më e qetë do të jetë bota

Sa më shumë armë aq më i rrezikuar do të jetë njeriu, madje edhe nëse nuk përdoren fare ato mjete, ngase vetvetiu ndotet hapësira që i duhet njeriut për jetë: ajri, uji, bimët, kafshët, shpezët, etj.

Sa më pak edukatë kulturore aq më e rrezikuar shoqëria njerëzore.





# Tregim

Isha i zgjuem edhe pse në mesin e gjumit. Errësina e dhomës dendësohej edhe ma tepër nga njollat e mureve të vizatueme nga lagshtina. Rrobat e bashkë me to edhe batanijet nuk kryenin mire funksionin e tyre. Ish-te ftohte...

Si gjithmonë, i pari i qenies teme u zgjue zani. Orvatej të përkufizonte ditën e kalueme e ma vonë të mbërrinte në ditën e sotme. Detyronte vazhdimisht arsyen me ligjet e moralit a të besimit. Fliste me një gjuhe që jo vetëm arsyeja por as unë s'e kuptoja.

Lufta kishte fillue. Egzistenca kishte rimarrë tashma shpirtin, e dialogu lidhte përmasat e mija. Një natë e brishtë, e zhvirgjërueme shumë shpejt nga dita që i ngjante një vrapuesi të dehun prej dëshirës me arritë dikund i pari... Ajo më duket se kishte harrue lodhjen që më kishte kaplue këto kohët e fundit e priste vazhdimisht ma shumë prej meje. Kurse unë mezi flisja. U ktheva në krahun tjetër a thue se zani vinte nga ana e braktisun e me tanë forcën thirra gjumin që kishte marrë valixhet e kishte ikë në një qoshe tjetër të globit, aty ku nata kishte hedhë spirancën e saj...

Pasi përpjekjet e mija për me kalue edhe disa orë në rehatinë e gjumit rezultuen të kota, u çova nga shtrati e u hodha në ditën e sapo çelun me një vetëdije të naltë. Të tjerët flinin e nganjëherë edhe flisnin. Por unë s'kuptoja as gja. Në pamundësi

me krijue një dialog me diçka të dukshme, u shfaqen përsëri elementet mistike që gjallonin në jetën time të vetmueme. Ato nuk ishin tema, pasi nuk arrija t'i lidhja me fillin e arsyes së dobët. E si rezultat edhe fjalët nuk kryenin asnjë punë. Ato mund të ishin ndoshta disa sy të harruem diku këtu, apo ndjenja të dhurueme këtij planeti të vogël, por kurrsesi fjalë. U ula, vetëm pashë e përjetova, pasi vetëm këtë mund të baja. Çdo gja ishte e pajisun me një kuptim që shfaqej në formë vizioni. Çdo gja ishte rrugë ku përjetësisht mund të udhëtohej. Problemi ishte vetëm tek rezistenca, që ishte padyshim edhe pengesa ma e madhe që shfaqej vazhdimisht aty ku s'e pritsha...

Trupi, si gjithmonë dridhej në sapozgjim për të prodhue pak nxehtësi në këtë ambient të ftohtë. Intensiteti i dridhjeve rritej me nevojën për energji... Por dielli sapo doli e bashkë me te edhe ngrohtësia e ditës...

Dyert e dhomave filluan të hapeshin, gja që tregonte edhe ardhjen e orës për të ngrënë. I ngarkuari me këtë detyrë, nuk harroi të vinte edhe në dhomën tonë për të ba zgjimin. "Mëngjesi asht gadi!" - bërtiti ai. Të gjithë u zgjuan me një shpejtësi që karakterizon njerëzit e uritun, që kishin hangër darkën herët në orarin e caktuem si në ushtri. Për një minutë, të tanë ishin të rreshtuem në tavolinat e bashkueme. Hanin pitet e ngrohta... Avujt, ishin shporetit ku mund te ngrohej mjedisi i stermadh i mbushun me karri-

ge që mbanin vetëm ajër.

- A kanë ardh' gazetate? - pyeti Ardiani.

- Po, - u pergjigj Fisniku, - por s'kishte gja me randësi. Mos e lexo se e kam lexue unë për ty...

Një tjetër nga ato u ndie tek fliste në telefon:

"Urdhno, alo... he babë, pse more në këtë orë në telefon, mos ka ndodhë gja?! Ik he... a të kam thanë që s'duhet me e lanë me dal at' kur un nuk jam në shtëpi e aq ma teper kur don me shkue ne gjini te e ama, që mezi ç'pret me na pa të ndamë nga njeni-tjetri...?!"

Ai u çue i revoltuem nga tavolina e bukës e vrapoi drejt një drejtimi të paditun shërues...

\* \* \*

"...Mbramë u kënaqa nga ndeshja, ishte e shpejtë e plot surpriza apo jo?! - filloi te fliste Andi që studionte për mjeksi, meqë aftësia e tij e vetme ishte me mësue përmendësh. Të tjerët me t'u përmend fjala ndeshje i thanë ditës mirëserdhe.

Ato po luanin futboll me minutat e para të kësaj dite, që mue më kishte tregue fytyrën e saj të çuditshme. Hapa gojën edhe unë të flisja me to për gjanat që deshta unë...m'u morr goja para fytyrave të tyre të ngrime, që për çudi u zhytën edhe një herë në një gjumë të thellë. "A ka mundësi me më ndie një minutë se pasha njat Zot do t' ju kapi të tanëve në grushta?!", - zani jem thellonte edhe ma gjumin



e të lodhunve. Ata zgjoheshin vetëm nga frekuenca të veçanta dhe qëndrimi në jetë ishte tërësisht i varun nga jetëgjatësia e ktyne frekuencave shpirtdhansë... Për secilin jeta kishte rezervue një litar të veçantë për ta mbajt të lidhun mbas vetes. Secili gjente të ngjashmin e tij aty në një kallaballëk të huej, por problemi ishte si gjithmonë tek unë, që nuk po gjeja dikë me nda diçka që për mue ishte shumë e nevojshme.

"Shikoni pak! Më falni! ...A mund të shpjegoj diçka të vogël e mandej flisni ju sa të doni, jam gati me ju ndigjue deri në fund." Ato filluen të flasin për gjana të ndryshme e tue ma shtue edhe ma tepër çudine e vetmisë që më kishte kaplue kaherë. "Nuk ju dhashë leje me folë!" – bërtita i nevrkosun tue marr kompetencat e një kujdestari të rreptë konvikti. Ardiani më shikoi me çudi e më pyeti: "Mos kujton se ke kujtesë ma të fortë se unë, që merr kompetencat e mia? Unë e kam mësue ma përpara gjuhën e këtyne. E di mirë sesi t'i gjallnoj apo t'i vdes. Jam ma i vjetër se ti në këtë konvikt. I kam shndërrue tanë në objekte të çuditshme me ndihmen e bisedave të gjata pa ndonjë fryt. Ato ushqehen me fjalët e mia sepse sigurisht nuk kanë mundësi tjetër..." I thashë se unë nuk di shumë gjuhë për me ndikue tek njerëzit, madje as gjuhën teme nuk e di mirë, përderisa nuk jam i zoti me e përmisue atë. Habitem me ty që beson në aftësitë tuaja me fol me tanë e sidomos kur ato janë së bashku e me ndikue vetëm me një stil komunikues... un shoh se si ti jep vetëm urdhna, e kësaj nuk i thonë me ditë gjuhën e tanve, por të asnjënit. E randësishme asht që ti me kenë

i kënaqun se tjerat shkojnë e vijnë. I kënaqun me të tashmen e të njëjtën kohë edhe me të ardhmen, për të cilën po investon mirë qysh tash...

- Ti je shumë ndryshe nga të tjerët, nuk e di nga vjen, cilës gjuhë i përket? - më pyeti. - Unë jo vetëm që nuk di se prej nga jam e cilës gjuhë i përkas, por as që besoj se kam me muejt me e ditë ndonjiherë ose ma mirë me thanë se atëherë kur të mundem me e ditë, kam me qenë i hymun në një tjetër botë ku ti s'ke si me kenë përkrah meje. Ti edhe atje ke me kërkue njerëz për me i drejtue apo luejtë me ta. Ah i shkreti ti sa njeri me shije je!...

Ndërkohë të tjerët ishin në fundin e luftës se kush mund t'i hante i pari ato pite të ngrohta që vinin nga jashtë, prej larg... Mëngjesi mbaroi e tanë u çuen nga tavolinat me ngut e me ide të qarta për ditën e sapofillue me. Kurse unë nuk dija çka me ba me tanë këtë ditë, që s'kishte me mbaru kurrë, ose kishte me mbarue tragjikisht. Dola jashtë i revoltuem me veten e me gjanat që s'po i merrja vesht. Tanë ishin larg nga unë ose e kundërta, por kjo s'kishte shumë randësi. Me të kalue pragun e derës, mora në të djathtë. Po përshkoja rrugën e përditshme. Ndeza një cigare e pastaj e lashë vedin të lirë në format e asaj rruge. Çdo gja njësoj me të djeshmen, ndoshta për faktin se qysh dje tek unë nuk kishte ndodhur asnjë ndryshim. Të njëjtit sy, të njëjtit veshë, e njëjta ekzistencë zvarritej në po atë rrugë. E çka mund të ishte ndryshe në këtë realitet të shurdhët e të verbët. Mos e vetmja rrugëzgjdhje do të ishte vetmia absolute apo asketizmi?!

Dy pika lot ...

Dikush po me ndiqte nga pas. Jo mue por rrugën që po baja. Ndieva baptime hapash e gjithashtu një erë kundërmuese... Zani i kësaj qenieje (padyshim burri) bahej gjithnjë edhe ma i perceptueshëm nga veshët e mi... Kishte një rrjedhshmëni të lakmueshme e gjithashtu një vetsiguri profetike.

- Unë jam mirë, s'qahem e quhem Filani (...se e kam harrue për momentin). Po ti a mbahesh, apo s'e ke fuqinë teme për me egzistue? Nuk ke si me e pasun, jo! Ty s'të ka lindun e njëjta nanë me mue! Ha, ha, ha...! Mirë, mirë e n'dashtë Zoti do bahet edhe ma mirë!

\* \* \*

Ai po përpiquej dhunshëm me folë me vedi, e... këtë e kishte shumë larg... e kishte humbun diku në rrugët e jetës... në ndonjë pikë kulmore të dashunive njerëzore... në ndonji shikim të përhumbun tue pa fytyrën e të dashtunes së tij diku ndër qiej... Rranjt e tija lulëzonin atje... vedin ia kishte falun Atje-hit... Ai besonte në kotsinë e çdo lloj optimizmi që lidhej sadopak me realitetin e njerëzve normal që kishin pasë frikë me dashurue... që kishin frenue vedin... që s'kishin kalue asnjherë këtë tue u gjerrun... që kishin kalue me njerëz të tjerë tue mos u shqetësue me i dhurue të pakten një përhëndetje vedit... Krijesa këto që mbështeten kamngulshëm në domosdoshmërinë e të pasunit dike aty afër... një tjetër i pavedi... një hije mëngjesi... një gjeth i mbërthem fort në kërcellin e një dege tashma të rame... kurse unë isha ai që qysh në mëngjes më kishte gjetur vetja. Ishim një. E...çuditnisht s'po i thoja asnjë gja.



# KRIJIMI

Ndër cilësitë më të veçanta të njeriut si krijesë e pajisur me aftësinë e të menduarit është dëshira dhe këmbëngulja për të kuptuar çdo gjë. Kjo dëshirë e ky merak për të ditur e për t'i dhënë kuptim çdo gjëje, është po aq i vjetër sa vetë historia e njerëzimit.

Ashtu si në çdo temë njeriu, halifetullah ( zëvendës i Allahut në tokë) kërkon të gjejë përgjigjen e “ pse-së” apo “pse-ve” të shumta, të njëjtën “pse” ka drejtuar edhe në temën e krijimit të gjithësisë: “ Pse dhe si është krijuar gjithësia, cila është origjina e saj?” Çështja e krijimit është një problem i përbashkët i historisë së njerëzimit, çështje kjo e trajtuar si në sistemet e vjetra të menduarit filozofik ashtu edhe pas ardhjes së Islamit, mes dijetarëve islamë. Edhe sot, zhvillimi i shumë aktiviteteve dhe studimeve kozmologjike, është tregues i karakterit bashkëkohor të kësaj teme : Krijimi!

Le të shohim se sa dhe si trajtohet “ krijimi” në Kur’an dhe hadithe:

“Në Kur’an përmendet gjithsej 236 herë fjala krijim (halk) për tema dhe përmbajtje të ndryshme në krye të të cilave tërheq vëmendjen krijimi i qiejve dhe i tokës.” (D.I.A., Bekir Topaloglu, Halik, v.15, fq.303)

Gjithashtu “fjalët qiejt (semavat) dhe tokë (ard) përmenden bashkë me njëra-tjetrën 176 herë në kuptimin gjithësi, kozmos. Në këto ajete përcillet mesazhi se qiejt dhe toka janë krijesa të Fuqplotit dhe si të tilla janë në “duart” e Tij, çdo krijesë që jeton në to, mendore apo jo, i përulet Atij.” (M.F.Abdulbaki, Mu’xhem, semavat)

Sipas shumicës së dijetarëve islamë, ajetet e para që i zbritën Muhamedit (s.a.s) ishin pesë ajete e para të sures Alak. Në ajetin e parë të kësaj sureje Allahu do t'i drejtohej njerëzimit për herë të parë : “ Lexo me emrin e Zotit që krijoi.” (Kur’ani, Alak, 96/1)

Me këtë ajet që i zbritet për herë të parë Profetit, ai dhe mbarë njerëzimi mëson se Allahu është krijues.

Krijesës më të nderuar të Allahut, njeriut, është dhënë dituri, fuqi, aftësi për të folur, dëgjuar, shikuar, vendosur etj, por as edhe në nivelin më të ulët nuk i është dhënë aftësia e krijimit. Krijimi është aftësi vetëm e Allahut.

Të njëjtin “fluks” njohurish rreth krijimit të qiejve dhe tokës, gjithësisë, e shohim edhe në traditën profetike, synet.

Qëllimi i përmendjes së kaq shumë ajeteve dhe haditheve që lidhen me krijimin mos është hedhja dritë e Kur’anit ndaj shkencës dhe zhvillimit teknologjik? Apo diçka tjetër?

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetjeje le të kujtojmë pak gjendjen dhe nivelin intelektual të njerëzve në kohën kur u zbrit Kur’ani : njerëzit e asaj kohe mësohet se ishin analfabetë dhe nuk kishin kurrfarë dije dhe njohjeje rreth qiejve dhe shkencës së astronomisë, prandaj edhe gjuha e këtyre ajeteve është fare e thjeshtë dhe e kuptueshme nga njerëzit, konkrete për nivelin e tyre të të menduarit. Përmendja e këtyre ajeteve nuk ka për qëllim përcjelljen e dijeve dhe shkencës por, tërheqjen e vëmendjes së këtyre njerëzve, të cilët duke vështruar madhësinë dhe bukurinë e yjeve, diellit, hënës e trupave të tjerë qiellor të arrijnë tek Krijuesi.

Dikush mund të arsyetojë në këtë mënyrë: Kur’ani nuk ka zbritur vetëm për atë kohë dhe ato njerëz analfabetë. Kur’ani vlen për çdo kohë dhe çdo njeri, prandaj këto ajete janë burim i shkencës.

Në radhë të parë është e pakuptueshme meraku i këtyre njerëzve për të vërtetuar në çdo rast nënshkrimin e “paqes” së Islamit me shkencën , në një kohë që për nënshkrim “paqeje” mund të bëhet fjalë pas luftës dhe vetëm pas luftës....



Është e vërtetë se Kur'ani nuk ka zbritur për një kohë apo grup njerëzish të caktuar por se vlen të përmenden edhe disa cilësi të Kur'anit në këtë aspekt dhe të theksohet arsyeja përse Kur'ani nuk jep të dhëna të detajuara për shkencën:

1. Në radhë të parë kapaciteti fizik i Kur'anit si libër hyjnor nuk jep mundësi për përfshirjen e gjithë dijeve shkencore. D.m.th. sikur çdo temë të përfshihej në Kur'an me gjithë hollësitë e saja atëherë në duart tona do kishim një libër gjigand, ku do ishte tepër i vështirë leximi e përfitimi, pa menduar mësimin përmendësh që do ishte i pamundur. Vetë Allahu thotë se sikur i gjithë deti të ishte bojë, nuk do të mjaftonte për të shkruar fjalët e Zotit. (Kur'ani, El-Kehf, 18/109)

2. Sikur çdo gjë të jepej gati në Kur'an atëherë nuk do ishte e arsyeshme që njerëzit të punonin, të kërkonin e të arrinin. E rëndësishme është që njeriu të jetë kërkues i së vërtetës madje edhe atëherë, kur bëhet fjalë për çështje të besimit.

3. Më e rëndësishmja e të gjithave është se Kur'ani si libër hyjnor nuk ka zbritur për të pajisur njerëzimin me dituri shkencore. Në Kur'an ka njohuri rreth historisë ( rreth ¼ flet për historinë e Profetëve, kisas-i enbija), por Kur'ani nuk është libër historie; ka njohuri rreth gjeografisë por ai nuk është libër gjeografie; ka njohuri rreth matematikës, astronomisë, fizikës,... por nuk është libër matematike, astronomie, fizike... Qëllimi kryesor i Kur'anit është përulja e njerëzimit ndaj Krijuesit dhe shtimi i besimit të tyre ndaj Tij.

Ashtu si në çdo temë njeriu, halifetullah (zëvendës i Allahut në tokë) kërkon të gjejë përgjigjen e “pse-së” apo “pse-ve” të shumta, të njëjtën “pse” ka drejtuar edhe në temën e krijimit të gjithësisë: “Pse dhe si është krijuar gjithësia, cila është origjina e saj?”

Dijet e hollësishme nuk duhen kërkuar në Kur'an por në kërkimin, vështrimin e punën e njeriut, përndryshe do zbehej imazhi i tij si krijesë që punon, fiton e gëzohet kur sheh frytet e punës së tij.

Përmendja në hadithe ashtu sikurse në ajete kaq shumë i çështjes së krijimit ka një urtësi: “Vërtetimin kozmologjik të ekzistencës dhe njësisë së Krijuesit.” (Tevfik Yücedogru, Yratilis, fq.27)

Pasi hodhëm vështrimin shkurtimisht rreth trajtimit të krijimit dhe urtësisë së tij në Kur'an, le të shohim shpjegimin që shkenca jep rreth kësaj çështjeje.

Ç'thonë teoritë pozitiviste rreth krijimit?

Sipas teorisë “Steady State” të Thomas Gold kozmosi ka ekzistuar gjithmonë. Gjithnjë ai zgjerohet duke krijuar galaktika të reja.

Sipas George Gamoë bota është krijuar nga një shpërthim i madh, “Big Bang”.

Steven Ęinberg me teorinë e tij “Standart Model” flet pak a shumë për të njëjtin shpërthim.

Nuk është rasti t'i bëhet një analizë e hollësishme këtyre teorisve baza e të cilave është “hipoteza” dhe “imagjinata”. Bie në sy përdorimi i fjalëve “krijim vetvetiu e zhvillim e zgjerim e botës “vetvetiu”, gjë e cila bie në kundërshtim me parimet e Islamit, por edhe me logjikën dhe arsyen e thjeshtë.



Megjithatë me këto fjalë nuk duhet të nxjerrim përfundimin se dijet e të dhënat e shkencës nuk kanë vlerë e janë të papranueshme. Gjithashtu bie në sy edhe pamundësia e këtyre teorive për të dhënë një moshë të saktë të kozmosit. Këto teori flasin për shifra të rrumbullakosura, konkretisht mes 2-3 dhe 6-8 miliard vjeç duke dhënë kështu kufijtë minimalë dhe maksimalë të moshës së kozmosit. Në këtë mënyrë vërtetohet pamundësia e të folurit prerazi në këtë temë; Krijuesi thotë: “ Unë nuk ua prezantova krijimin e qiejve e të tokës atyre që po i adhuroni e as krijimin e vetë atyre, e as nuk mora ndihmëtarë të humburit.” (Kur’ani, El-Kehf, 18/51)

Në këtë botë njeriu sheh në mënyrë të vazhdueshme dy kufijtë e tij, qiellin e tokën, ai është në një farë kuptimi i kufizuar me to. Përmendja aq shumë sidomos e tokës rëndësia e së cilës është e patjetërsueshme për njeriun ka pikërisht këtë kuptim. Në Kur’an kur përshkruhet një tablo e kozmosit përmenden më tepër qielli dhe toka e jo planetët e trupat e tjerë qiellorë, sepse lidhja e njeriut me to nuk është aq shumë e ngushtë. Prandaj themi se kur Kur’ani flet për krijimin vizaton një tablo ku mbizotëron njeriu dhe kërkesat e tij.

Kujtojmë se para zbritjes së Kur’anit, teoria e Batlamjunit fliste për kozmosin me epiqendër tokën, pas Kur’anit teoria e Kopernikut foli për kozmosin me epiqendër diellin. Këto teori folën për rrotullimin e trupave qiellorë rreth tokës apo diellit, rreth kësaj apo asaj. E ndërsa Kur’ani nuk tërheq vëmendjen rreth rrotullimeve por rreth “psesë” së rrotullimeve të këtyre trupave qiellorë. “Përse dhe për kë” rrotullohen? Përgjigjja: Për njeriun.

“Dhe për ju nënshtroi natën e ditën dhe diellin e hënën . Edhe yjet janë të nënshtuar me urdhrin e Tij. Vërtetë në këto ka argumente për një popull qe mendon. Edhe për atë që ju krijoi në tokë (bagëti, bimë, pemë, minerale etj.) ka fakte për një popull që di të marrë përvojë. Pastaj, Ai është që nënshtroi detin, që prej tij të hani mish të freskët, e prej tij të nxirrni stoli që i bani (i vishni), e i sheh anijet si çajnë (lundrojnë) në të. Ua nënshtroi që të përfitoni nga begatitë e Tij dhe ashtu të falënderoni” (Kur’ani, Nahl, 16/12-14)

“ Atëherë pra a është njësoj Ai që krijon, sikurse ai që nuk krijon? A nuk mendoni?” (Kur’ani, Nahl, 16/17)



## Recension i librit:

# *Haxhi ideal dhe umreja*

Autori i mirënjohur Osman Nuri Topbash gjendet sërish mes lexuesve shqiptarë me librin e tij të fundit të titulluar “Haxhi ideal dhe Umreja në klimën e përsjirtshmërisë”.

Të gjitha adhurimet fetare, jo vetëm që janë akte të urdhëruara nga Allahu (xh.sh.), por edhe përbëjnë nevojën shpirtërore më të pashmangshme për njeriun. Shpirti dhe bota afektive nuk mund ta sigurojnë askund tjetër atë ushqim që marrin nga kryerja e adhurimeve.

Njerëzit e ditëve të sotme që nuk e kuptojnë këtë të vërtetë, nuk mund të bëjnë asgjë tjetër, veçse të rrinë dhe të bëjnë sehir se si shpirtrat e

tyre përpëlitën në rropatje. Ndërsa fatlumët që mund të marrin ushqimin e shpirtit, brenda një klime tjetër që është e mbushur me prehje dhe harmoni, i shndërrojnë edhe brengat e dhimbjet e kësaj bote në ngazëllim, madje, ndërtojnë një jetë mbi bazat e dashurisë shpirtërore dhe orientimit në rrugën e drejtë, sepse shija dhe frymëzimi hyjnor që ndiejnë, i pengon të bien brenda vorbullës së pistë të kësaj bote.

E thënë shkurtimisht, disa adhurime janë bërë të detyrueshme për njeriun, në mënyrë që ai të plotësojë nevojat e tij shpirtërore dhe të shndërrohet në një rob që sillet me mirënjohje para begatave të panumërta të Zotit dhe që jeton me ndjenjën e falënderimit për Të. Kjo gjë i ngjan doktorit që shkruan recetën, ku shënon ilaçet dhe i kërkon të sëmurit t’i pijë patjetër ato, nëse do që të shërohet. Kjo ndodh për arsye se njerëzit shumë herë, qoftë për shkak të përtacisë së tyre, qoftë për shkak të mosnjohjes siç duhet të këtij problemi jetësor, tregojnë indiferencë ndaj nevojës së tyre për të kryer adhurimet. Për këtë arsye Allahu (xh.sh.) duke i shpallur obligime të pashmangshme adhurimet që përbëjnë nevojën më jetike për shpirtrat e njerëzve, dëshiron që nëpërmjet tyre, t’i shpëtojë ato nga privimet e pafundme.

Një adhurim fetar që kryhet si nga ana financiare, ashtu edhe nga ajo fizike është **haxhi**.

Haxhi është një adhurim i rëndësishëm që përsos besimin në shpirtin dhe na bën që të përjetojmë që në këtë botë, një pamje të ngjashme me atë të mahsherit. Ai na ndihmon që të mbërrijmë në enigmën e fjalëve: “**Vdisni para se t’ju vijë vdekja!**”.

Në këtë libër të përkorë, autori Osman Nuri Topbash është përpjekur t’i thotë me pak fjalë rregullat dhe edukatën me të cilën duhen kryer adhurimet e haxhit dhe umresë duke u fokusuar tek kriteret e aspektit shpirtëror dhe të përkush-





timit. Ai pohon se shkrimet e tija të botuara në libra apo në formë artikujsh, hartuar në lidhje me këtë çështje vite më parë, ua ka prezantuar me anë të këtij libri vëllezërve të fesë, të cilët kërkojnë të mësojnë dhe të informohen në mënyrë të përmblodhur dhe të shkurtër rreth aspekteve në fjalë, por në rastin e këtij libri ato do t'i gjejnë të rigrupuara dhe të ritrajuara në një formë të re.


Por duhet pasur parasysh se aspekti shpirtëror dhe moral i haxhit paraqet më shumë rëndësi se sa aspekti formal i jashtëm që ka. Edhe haxhi, të cilin profeti Muhamed (a.s.) e emëronte me fjalët "haxhi i pranueshëm", është një adhurim, i cili karakterizohet fund e krye nga hijeshia e cila konsiston tek mbushja me vlera shpirtërore. Nga ky aspekt haxhi është ura e shpirtit për tek mëshira, begatia dhe virtytet hyjnore, gjë që realizohet me anë të lutjes, pendesës dhe kërkesës për falje të mëkateve të kryera. Haxhi është rimëkëmbja e një jete të tërë me vepra të mira. Por nuk duhet të harrosh t'i japësh fjalën Allahut (xh.sh.) se kjo botë shpirtërore ku jeton, do të vazhdojë edhe pas kryerjes së haxhit.

Përveç adhurimit të haxhit që është i obliguar të kryhet një herë të vetme në jetë dhe brenda ditësh të caktuara, duhet ta perceptojmë mirë edhe vlerën që ka adhurimi i umres. Duke pasur parasysh vlerat e larta që ka, duke pasur parasysh se është një akt që mund të kryhet në çdo kohë të vitit dhe sa herë të dëshirojmë, ajo është cilësuar ndryshe edhe si "haxhi i vogël".

Pika ndaj së cilës duhet treguar më shumë kujdes ndaj gjithë kë-

tyre adhurimeve, është kushti që ato të kryhen me sinqeritet dhe me zemër të paqtë. Në qoftë se dëshirojmë që të qenit tonë rob ndaj Allahut të pranohet në audiencën e Tij (xh.sh.), zelli dhe përpjekjet tona duhet të jenë të orientuara ndaj kryerjes me dashuri dhe edukatë të adhurimeve tona. Vetëm atëherë adhurimet tona do të vishen me cilësinë e punës së mirë dhe do të shndërrohen kështu në kapitalin tonë të lumturisë për botën e përjetshme.

Do ta përfundoj këtë artikull me fjalët e arkitëktit shpirtëror të Pakistanit, Muhamed Ikbali, të cituara nga ky libër. Duke vizituar një ditë prej ditësh haxhilerët që ishin kthyer nga Medineja, Muhamed Ikbali iu drejtua me këto fjalë:



*"E vizituar Medinen Mu-nevverë! Me çfarë dhuratash e mbushët shpirtin tuaj nga tregu shpirtëror i Medinës? Dhuratat materiale që keni sjellë, taket, tespihe e sexhadet pasca kohësh do të vjet-rohen, do të vyshken dhe do të marrin fund. A na keni sjellë nga Medineja dhurata që nuk fishken kurrë, që i japin jetë shpirtit?"*


*A ka mes dhuratave tuaja dorëzim dhe besnikëri si të Ebu Bekrit, drejtësi si të Ymerit, ndjenjë turpi dhe bujari si të Osmanit, klimë shpirtërore dhe zjarr të xhihadit si të Aliut? A do të mund t'i falni botës Islame që sot përpëlitet në mijëra halle, emocionet e shekullit të lumturisë?"*

*U urojmë lexim të këndshëm të këtij libri.*

Adhurimet fetare, jo vetëm që janë akte të urdhëruara nga Allahu (xh.sh.), por edhe përbëjnë nevojën shpirtërore më të pashmangshme për njeriun. Shpirti dhe bota afektive nuk mund ta sigurojnë askund tjetër atë ushqim që marrin nga kryerja e adhurimeve.



## Klerikët myslimanë shqiptarë në dosjet e Myftinisë së Stambollit



Në dosjet që ruhen brenda arkivit të myftinisë së Stambollit, hasim edhe në ato të hoxhallarëve të arsimuar nga trojet shqiptare, por ne do të ndalemi në këtë artikull rreth dosjeve të hoxhallarëve shqiptarë nga qytetet, fshatrat apo lokalitetet që kanë mbetur brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë, si dhe atyre që janë nga shqiptarët e republikave të Malit të Zi dhe Greqisë, ndonëse dosjet e tyre janë të pakta aq sa të numërohen me majat e gishtave.

Për herë të parë këto dosje u sistemuan dhe u zberthyen në përgjithësi nga studiuesi turk Sadëk Allbajrak, punë voluminoze të cilën ai e kurorëzoi me një botim të punës së bërë. Pas një pune tetë vjeçare në arkivat e myftinisë së Stambollit dhe pasi pati kaluar nëpër duar me mijëra dosje që shkonin pas deri në vitin 1884, regjistrat e gradave të marra nga nëpunësit e fesë dhe regjistrat shtatë vëllimesh të të dhënave personale

të tyre. Numri total i dosjeve është për 2845 persona, nga të cilët 199 janë shqiptarë. Në mesin e tyre numrin më të madh e zënë nëpunësit e fesë nga Gjirokastra dhe Libohova, plot 109.


Që të gjithë personat, rreth të cilëve do të flasim, qenë hoxhallarë. Kjo nuk ka nevojë për sqarim, pasi edhe vetë dosjet e tyre u krijuan nga nëpunësit e komunitetit mysliman me qendër

në Stamboll, i cili siguronte mbarëvajtjen e punëve të fesë në mbarë kufijtë e perandorisë osmane dhe u ruajtën ashtu sikur se ruhen edhe sot në arkivin e myftinisë së Stambollit. Do të ishte e pafalshme nëse do të përpiqeshim të krijojmë në mendjet e lexuesit idenë që ata qenë thjesht shërbyes në objektet e kultit mysliman.

Dokumentacioni ofron të dhëna të tërthorta në lidhje me myftilerët, medresetë, mësimdhënësit (myderiz) dhe nxënësit në këto institucione të arsimit fetar.

Një vend i rëndësishëm në dokumentacionin e grumbulluar në dosjet personale të teologëve të hershëm janë dokumentet rreth veprimtarisë së tyre nëpër gjykatat fetare, me detyrën e gjykatësve islamë, apo siç quhen nëpër dokumente naiv, një term na rrëfen një personalitet juridik të ndryshëm nga kadiu, figura e gjykatësit suprem





nëpër kazatë e perandorisë deri në vitet e Reformës së madhe, apo siç quhen ndryshe Tanzimati, që nuk do të lajthitnim po ta quanim si Rendi i Ri.

Medresetë gjatë shekujve të parë të sundimit osman qenë vatra edukative-arsimore nga ku formoheshin gjykatësit (kadi) dhe shërbyesit e fesë (imam, hatip, myderriz). Zhvillimet shekullore që pësoi ky sistem bënë që sistemi juridik përherë e më shumë të fitonte varësinë nga petku fetar, por shumë çështje të së drejtës në lidhje me martesat, shkurorëzimet, dëshmitë rreth fëmijëve, çështje të veçanta të ndarjes së pasurive dhe trashëgimisë brenda familjeve mbetën nën varësinë e gjyqeve të fesë. Kjo situatë vazhdoi edhe në disa pjesë të Shqipërisë deri në vitet 20 të shekullit të 20-të.

Nga pohimet e bëra prej nëpunësve të fesë në dosjet e tyre personale kuptojmë se medresetë në trevat shqiptare mbështeteshin përkrah mësimëve bazë të fesë në mënyrë të veçantë në mësimdhënien e gjuhëve të lindjes arabisht, osmanisht dhe persisht. Gati 99 % e nëpunësve shqiptarë kanë pohuar se kanë ardhur në Stamboll për të marrë edukimin e mëtejshëm fetar-juridik. Pjesa më e madhe e të diplomuar-

ve në shkollat e fesë janë kthyer në vendet e tyre, gjë që na lejon të pohojmë se administrata osmane e fesë vendoste nëpër institucionet e larta të fesë njerëz të këtyre anëve.

Ndonëse në një rast të caktuar gjenden edhe fotografitë personale të hoxhallarëve siç është rasti i Ismail Hakki Efendiut nga Manastiri, autori në gjuhën osmane i librit Mevahibu'r-

Rahman, në 2 volume, që flet rreth jetës së imam A'dham Ebu Hanife-s.

Në dosjet e nëpunësve të fesë gjenden të dhëna të vlefshme rreth medreseve, myftilerëve e jetën politike, tarikateve dhe disa informacione që mund të vlejshëm në zbardhjen apo pasurimin e informacionit të mangët që kemi rreth institucioneve të fesë dhe nëpunësve të tyre.

Të dhëna kemi për medresenë e Shkodrës, Janinës, Filatit, Gjirokastrës, Beratit, Libohovës, Tiranës, Lushnjës dhe Shijakut.

**Medreseja e Mahmut Pashë (Bushatlliut) apo që quhet ndryshe edhe Medreseja e Sipërme.**

Në këtë medrese përveç nxënësve shkodranë mësuan edhe nxënës nga zonat e tjera të sanxhakut të Shkodrës, persona të cilët në vitet më pas do të merrnin detyra të ndryshme në administratën fetare islame, siç qenë Haxhi Isa Krujani, Mehmet Emin Gucia dhe Ibrahim Edhem efendi Kavaja.

Nga myderrizët e kësaj medreseje në dokumentacion përmenden Selim Çoba, Hasan efendi Podgoriçani, hafiz Hasan efendi Lohja. Ky i fundit pas marrjes së ixhazetit



punoj si mësues pa pagë në Medresenë e Shkodrës për rreth 12 vjet dhe në muajin shkurt të vitit 1909 caktohet myderriz me rrogë prej 169.5 kurushësh.

**Medreseja e Filatit** ku mësim jepte Hasan Riza efendi Dibrani.

**Medreseja Evkaf në Berat** ku si myderriz gjejmë Mehmet Tevfik efendi Shkodranin.

**Medreseja e Abdurrahman bej Toptanit në Tiranë**, medrese e ndërtuar mbi themelet e medresesë së Ethem Beut, kundërshtarit të Toptanëve. Abdurrahman bej Toptani këtë medrese e rrafshoi dhe mbi të ndërtoi të tijën. Kështu rrëfen tradita gojore.

**Medreseja e Lushnjës** në të cilën myderriz qe Ibrahim Haki efendi.

**Medreseja e Shijakut** ku myderriz qe Malik Bektash efendi nga Gjakova i cili caktohet si myderriz me kërkesë të masës së popullit pas dorëheqjes së këtij të fundit prej myftinisë së Krujës. Aty ai emërohet zyrtarisht si myderriz me datë Mars 1910 me një rrogë prej 200 groshësh (kurush).

**Medreseja e Skëndollit apo Iskenderzades në Gjirokastrë** ku si myderriz gjejmë Sulejman Syrri bin Ahmet Dibrani; Zejnela-bidin Xhaferi, Junus Zyhty; Mehmet Shemsettin efendi dhe Abdysselem Efendinë.

Megjithëse në statusin e nahije-së nën varësinë e kazasë së Gjirokastrës, gjatë sundimit osman në Shqipëri, Libohova, mund të themi, nën dritën e të dhënave që kemi konstatuar në dosjet e myftinisë së Stambollit, ka qenë një vatër ku janë edukuar shumë nëpunës së fesë islame, prandaj është e kuptueshme që këtu të gjendet një **medrese, ajo e Libohovës**, në të cilën ka dhënë mësim Abdyllatif Janina, hafëz Hysein Shkodrani, Rustem efendi Kavaja, sheh Omer efendi Janina.

Të dhëna nga këto dosje ka edhe për myftilerët e ndryshëm, caktimin e tyre në këto

detyra, e nganjëherë edhe për kohëzgjatjen në këto detyra sikur se bëhet fjalë për:

Myftijtë e Pargës (Ajdonat) që qenë Omer Efendiu, pas vdekjes së cilit në vitin 1872, myfti caktohet Mehmet Emin efendiu; dhe data e caktimit në detyrën e myftiut të Mustafa efendisë, që është korrik 1911.

Mehmet Nakshi efendinë Beratasin që pas vdekjes së të atit edhe ai myfti, Ahmet efendisë, caktohet me detyrën e myftiut në Berat, detyrë në të cilën jemi të sigurt se qëndroi deri në vitin 1902.

Ismail efendinë që në muajin maj të vitit 1911 caktohet myfti në Mat.

Myftijtë e Gjirokastrës që qenë Abdulhamit efendiu, Mehmet Xhelaledin efendiu i caktuar në këtë detyrë në muajin shkurt të vitit 1912, Abduselam efendiu, Ismail efendiu dhe Islam efendiu.

Jusuf Siddik efendiu (Tabaku), i cili me datë 10 maj 1878 caktohet në detyrën e Myftiut të Shkodrës.

Lytfi efendiu që me datë maj 1907 caktohet myfti në kazanë e Leskovikut, post në të cilin jemi të sigurt se ka qëndruar të pakten deri në vitin 1912.


Ibrahim Hakki efendiu që në vitin 1910 caktohet në myftininë e Lushnjës.

Musa Qazimi që në vitin 1908 caktohet me anë të një urdhri perandorak (irade-i senijje) myfti në kazanë e Tiranës, detyrë në të cilën qëndroi deri në vitin 1912.

Mutasëm Bilah Tiranasi që me datë 1901 caktohet në myftininë e Durrësit.

Maliq Bektash efendinë nga Gjakova i cili ndërmyjet datave 23 qershor 1907 qe emëruar në myftininë e kazasë së Krujës.

Mehmet Eminin që mes datave qershor 1906 – prill 1911 qe myftiu i Janinës.



Shkresë e konsullatës turke ku njoftohet se Hafiz Xhemal Dibrani është zgjedhur deputet në parlamentin shqiptar

Adem Feraizi që me datë 1892 caktohet myfti nderi në kazanë e Margëlliçit.

Të dhëna nga pjesëmarrja në jetën politike të figurave fetare kemi për Hysen Avni efendi Karagjozi nga Gjirokastra, Idriz Galip efendinë, Hafiz Xhemalin nga Dibra e Sipërme, rreth të cilit konsullata turke në Shqipëri kërkon t'i pritet rroga e mësuesit të përgjithshëm të fesë (dersiam), pasi që zgjedhur deputet në parlamentin shqiptar, Mehmet Fehmi efendinë, i cili ka marrë pjesë vullnetarisht në mbrojtjen e skelës së Janinës të sulmuar nga ushtarët grekë në prill të vitit 1897, duke braktisur detyrën e tij si gjykatës feje në Përmet.

Në formularin personal që plotësohej për nëpunësit e fesë, shënoheshin edhe gjuhët që ata njihnin, flisnin, zotëronin dhe shkruanin. Pjesa dërrmuese e hoxhallarëve nga Shqipëria pohonin që zotëronin gjuhën shqipe, por vetëm për një prej tyre është lënë shënimi se edhe e shkruan atë, informacion që ne e kemi regjistruar si të rëndësishme po të kemi parasysh peri-

dhën për të cilën bëjmë fjalë dhe mungesën e informacionit të literaturës së mundshme fetare në gjuhën shqipe. Ai është Halil Fehmi efendi Gjirokastriti i datëlindjes 1873.

Të dhëna gjejmë edhe për ndonjë urdhër mistik islam synit. Kështu të dhëna kemi për paraardhësit e Lytfti efendiut, ish-myfti i Leskovikut, biri i shejh Abdulhadi efendiut, që rridhte nga gjaku i shejh Sulejman Aziz efendiut, nga shejhët dhe myderizët e njohur të tarikatis saadi, i varrosur në xhaminë e Arslan Pashës, në Janinë.

Ibrahim Hakki Efendiu që biri i postnishit të fshatit Karbunarë së Lushnjës, Rashit Efendiut.

Ndërsa Mehmet Safvet efendiut, i edukuar në universitetin e Ezherit në Egjipt, që biri i shejh Mehmet Ali Efendiut, postnishit nakshibendi të xhamisë së Arslan Pashës.

Një e dhënë tjetër të cilën e konsiderojmë të vlefshme për ta përmendur këtu është edhe dosja e shqiptarit Mehmet Murat efendiut nga Podgorica, i cili në vitin 1884 që vendosur me banim në Zadrinë të Lezhës. Ai në muajin gusht 1911 që caktuar myftiu i Malit të Zi, me zgjedhjen e kryer në bashkësinë islame, post në të cilën qëndroi deri në muajin qershor të vitit 1912.

Nuk ka dyshim që qëmtimi në arkivat e ndryshme osmane, nisur edhe nga Arkivi shqiptar dhe ai turk do të nxjerr lista të plota të nëpunësve të fesë me origjinë nga Shqipëria, nga jeta e tyre personale, fetare, shoqërore, politike etj. Por për të arritur këtë është e rëndësishme që të ekzistojë mirëkuptimi i institucioneve ku ruhen këto dokumente, në mënyrë që të sigurojnë mbështetjen morale të studiuesve të kësaj fushe, në mënyrë të veçantë arkivi i shtetit shqiptar.



## Një metodë e re për shërimin e kancerit



Studiuesit në universitetin e Oksfordit në Angli planifikojnë të realizojnë një eksperiment në të cilin do të përdorin ultrason të intensitetit të lartë në mënyrë që të mund të zhdukin qelizat kancerogjene në trup të njeriut.

Aparati i shpikur në universitetin e Oksfordit, i cili përçon valë ultratingujsh në trupin e njeriut bën të mundur që në pjesën e trupit ku gjenden qelizat kancerogjene të formohen disa flluska, të cilat kur të shpërthejnë do të bëjnë që energjia e nxjerrë si nxehtësi të mund të vras qelizat kancerogjene.

Shkenctarët anglezë që planifikojnë ta provojnë këtë metodë të re që kanë realizuar në të sëmurët me tumor në veshka dhe mushkëri, shprehen se pas eksperimenteve të para të kryera me teknikën e Ultratingujve të Fokusuar me Intensitet

të Lartë (High Intensity Focused Ultrasound - Hifu) është vënë re se kjo teknikë është të paktën aq efektive sa ndërhyrja kirurgjikale, madje në këtë rast shmanget rreziku i hapjes kirurgjikale në trupin e të sëmurit. Teknika e re parandalon edhe dëmtimin e indit të shëndoshë.

Gjithashtu shkenctarët shpresojnë se me marrjen nën kontroll të plotë të energjisë së lëshuar nga flluskat që formohen kur indet mbahen nën valët intensive të ultratingujve, do të mund të realizojnë një kurim më të shkurtër në kohë dhe më efektiv.


## ANGLEZET, NJEREZIT QE VUAJNE ME SHUME NGA DEPRESIONI

Bëhet e ditur se mjekët familjarë u kanë lëshuar ilaçe kundër depresionit një numri të madh individësh duke prerë plot 31 milionë recetash vetëm për këtë vit.

Revista Times që dha alarmin rreth kësaj çështjeje, pohonte se ilaçet më të shitura janë Prozac dhe Seroxat dhe se në shitjen e tyre është vënë re një rritje prej 10 %, ndërkohë nënvizon faktin se numri i atyre që i kanë përdorur këto ilaçe nuk dihet saktësisht.

Sipas gazetës prestigjioze vetë doktorët që kanë lëshuar recetat në lidhje me ilaçe anti-depresive janë shprehur kundër dhënies në një numër kaq të madh të ilaçeve; ndërsa kur janë pyetur se përse i lëshojnë këto receta atë-

herë janë përgjigjur se nuk kanë mundur të mos i shkruajnë recetat përballë nevojës emergjente që kanë vënë re tek pacientët e tyre.




Sipas studimeve të bëra në Angli një ndër pesë persona ka pohuar se ka mbetur për një periudhë të gjatë të jetës nën ndikimin e depresionit. Kjo do të thotë se të paktën 1.5 milion njerëz të popullsisë ndërmjet moshave 16-75 gjenden nën gjendje të rënduar depresioni. Pranohet se është pikërisht ky lloj depresioni faktori kryesor i 70 % të vetëvrasjeve që ndodhin në Angli.

## Aplikohet me sukses “syri bionik”

Sipas raportit të gazettes hyrrijet thuhet se zhvillimi i ri bijonik i realizuar në ABR, do të bëjë të mundur që të shohin miliarda të verbër. Shkencëtarët pohojnë se me anë të protezave do të bëhet e mundur lidhja, ndrejçja e funksioneve të shikimit të shkaktuara nga sëmundjet ose plagët e ndryshme, duke krijuar lidhje ndërmjet trurit dhe sistemit nervor.

Profesori i Universitetit të Kalifornisë se Jugut Mark Humajun nenvizon se teknologjia e zhvilluar do të rikthejë shikimin atyre njerëzve që e kanë humbur atë si pasojë e sëmundjes (Retinit Pigmentosa). Modeli i parë i zhvilluar, me anë të 16 elektrodave në retinë, që nga viti 2002 e ktej është provuar tek gjashtë të sëmurë, ku ka dhënë rezultate më të mira se çpritej. Më pas vazhdon ai duke thënë se edhe të verbërit që nuk shihnin prej vitesh tani mundë qw ti vërejnë sendet e ndryshme si; lugët, pijatat, gotat etj.

Në modelin e ri të projektuar nga ana e ekipit mjekësor të drejtuar nga Prof. Humayun numri i elektrodave do të jetë 60, madhësia e aparatit u zvogëluar me  $\frac{1}{4}$  e të mëparshmit duke u bërë vetëm 3 milimetra. Modeli i ri i protezës, që përbëhet nga një kamerë e vo-



gël e montuar në një xham që i përcjell informacionin protezës, vendoset jashtë bebes së syrit dhe lidhet me një kablo me retinën. Të sëmurët e komandojnë protezën me një dhënë që mbajnë të lidhur në bel.

Prof. Humayun u shpreh se aparati i retinës artificiale të projektuar për të përcjellë informacionin në tru, do të mund të hidhet në treg brenda dy vjetësh, pasi të ketë përfunduar me sukses përpunimi klinik i saj.

Pretendohet se numri i personave që vuajnë nga sëmundja Retinit pigmentosa që ndeshet shpesh tek të sëmurët janë plot 30 milionë.





# Një histori e shkurtër e xhamisë së profetit Muhamed (a.s.)

Viti i parë hixhri ose 622 gregorian.

Profeti Muhamed (a.s.) kur erdhi në Medine e pa të nevojshme ndërtimin e një xhamie, me qëllim faljen e namazeve së bashku me xhemat, diskutimin e temave dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme që kishin besimtarët etj.

Siç e dimë nga historia islame, i Dërguari i Allahut (a.s.) kur erdhi në qytetin e Medinës, për të gjetur vendbanimin e tij, e la të ec devenë e lirë në mënyrë që ajo ta përcaktonte atë, si dhe të shmangte ftesat e shumta që i bënë ensarët. Devoja u nis drejt kopshtit me hurma të dy jetimëve Sehl dhe Suhejl, të cilët ishin nën mbrojtjen e Muadh b. Afrasit (r.a.). Për këtë Profeti Muhamed (a.s.) e thirri Muadhin që t'ia shisnin truallin e tyre, por sahabiu iu përgjigj duke i thënë se jetimët kanë dëshirë t'ia dhurojnë atë. Duke mos e pranuar këtë gjë i Dërguari i Allahut Muhamedi (a.s.) i thirri jetimët për të mësuar se sa u kushtonte trualli. Edhe pse dy të rinjtë jetimë kishin dëshirë t'ia dhuronin truallin Profetit (a.s.), ai përsëri nuk e pranoi këtë gjë dhe urdhëroi Ebu Bekrin (r.a.) që t'ia paguajë.

Vetë Profeti (a.s.) mori pjesë në ndërtimin e kësaj xhamie. Ajo është ndërtuar në një kohë të shkurtër. Muret e saj ishin prej qerpiçi. Gjatë kohës që kibla e myslimanëve ende nuk

ishite e përcaktuar, u vendos që të drejtohej nga Jeruzalemi. Ajo ishte katrore, me tre dyer, me mihrab dhe me gjysmë tavani të mbuluar nga gjethet e hurmave. Në vend të mihrabit ishin vendosur trungje hurmash. Minber nuk kishte, por gjatë kohës që i Dërguari i Allahut (a.s.) mbante ligjëratë, i vendosnin pranë një trung hurme me qëllim që të mbështetej në të. Më pas, me dëshirën e sahabëve lejoi t'i ndërtohej një minber me tre shkallë. Ngjitur xhamisë janë ndërtuar edhe dy dhoma prej qerpiçi për dy gratë e tij, Sevden dhe Aishen. Tavani i këtyre dhomave ishte i mbuluar me gjethë hurmash. Me shtimin e numrit të grave të profetit (a.s.) janë ndërtuar edhe dhoma të tjera, sipas nevojës. Katër dhoma ishin nga qerpiçi, ndërsa pesë prej guri.

Xhamia e profetit nuk është përdorur vetëm për faljen e namazeve me xhemat. Ajo njëkohësisht është përdorur edhe për nevojat e tjera fetare, sociale e kulturore të besimtarëve myslimanë. Plus kësaj aty jepej edhe mësim si dhe ishte vendprijtja e përfaqësuesve të fiseve dhe shteteve të tjera.

## PERUDHA E KATER HALIFEVE TE DREJTE

Po t'i hedhim një vështrim kohës së katër halifëve të drejtë, do të vërejmë se xhamia e profetit Muhamed (a.s.) ka pësuar ndryshime në rikonstruksionin e saj, si pasojë e rritjes së

popullsisë dhe nevojave të kohës.

Koha kur Ebu Bekri (r.a.) ishte halif qe shumë e shkurtër, dhe si shkak i kryengritjeve që zhvillonin murtedët situata e ka imponuar atë ta përqendronte vëmendjen tek ta dhe të angazhohej rreth atij problemi. Mu për këtë arsye mendohet që nuk ka vënë dorë mbi rikonstruksionin e saj. Por të tjerë historianë myslimanë e argumentojnë këtë situatë edhe me mundësinë që ndoshta ai nuk ka dashur të vërë dorë mbi atë çka ndërtuar profeti Muhamed (a.s.) gjatë kohës sa ishte në këtë jetë.

Kur Ymeri (r.a.) u bë halife, ai e ndjeu të nevojshme ta zgjeronte sipërfaqen e saj, duke filluar nga ana e kibles me tri metra, në veri tetë dhe perëndim gjashtë metra, dhe kështu xhamia arriti një sipërfaqe prej 4977 m<sup>2</sup>. Në anën veriore të saj është hapur një portë, një në perëndim e quajtur babu's-salam dhe një në lindje e quajtur babu'n-nisa, dhe kështu nga tre dyer që xhamia kishte më përpara, ato arritën në gjashtë.

Në kohën kur Osmani (r.a.) ishte halife, gjegjësisht në vitet tridhjetë të kalendarit hixhri, sipërfaqja e xhamisë arriti në 5492,5 m<sup>2</sup>, duke u zgjeruar me nga dy metra në drejtim të kibles dhe perëndimit, si dhe tre metër e gjysmë në anën veriore të xhamisë. Xhamia është ri-

konstruktuar rishtazi. Muret e saj sërish janë thurur me gur të stolisur bukur. Duke vendosur kolona prej guri është bërë e mundur që të mbyllet edhe një pjesë e tavanit të xhamisë. Ndërsa në kohën kur Aliu (r.a.) ishte halife, xhamisë nuk i është bërë ndonjë rikonstruktion.

mat e grave të profetit (a.s) që deri atëherë mbeteshin jashtë xhamisë, tani u përfshinë brenda mureve të saj. Muret e saj janë ngritur me gurë dhe mbuluar me mermer. Lartësia e tavanit nga dyshemeja është 12,5 m. dhe u mbulua me dru arre të sjellë nga India. Për t'u mbrojtur nga shiu u ndërtua

shte që ishin në veri të xhamisë me qëllim që t'ia bashkëngjiste. Në këtë krah xhamia është zgjeruar për 27 m. dhe sipërfaqja totale e saj arriti në 9309 m<sup>2</sup>. Në perëndim dhe lindje të mureve janë hapur nga tetë dyer, kurse në veri dhe jug nga katër dyer, dhe kështu shuma e plotë e tyre arriti në 24.



## PERIUDHA E EMEVIVE

Gjashtëdhjetë vjet pas Osmanit (r.a.) si halife, në kohën e Velid b. Abdulmelikut dhe Ymer b. Abdulazizit, xhamia është rindërtuar rishtazi. Duke pasur parasysh kushtet e asaj kohe, mund të themi se xhamia e profetit ka arritur përsosmërinë më të madhe për nga aspekti i elementëve dekorativë që duhet të ketë një faltore. Sipërfaqja e xhamisë është zgjeruar përsëri në drejtim të perëndimit me 9 metër, në lindje me 10, dhe në perëndim me 15 metra, kështu që sipërfaqja totale e saj arriti në 7500 m<sup>2</sup>.

Me zgjerimin e anës lindore të xhamisë për 10 metra, dho-

edhe tavanit i dytë. Janë varur llamba dhe kandila nëpër tavane. Për të parën herë një pjesë e mihrabit është futur brenda murit dhe është ndërtuar mahfili (vendi) i muezinit. Ndërsa minberi është bërë me nëntë shkallë. Në të katër qoshet e xhamisë janë ndërtuar katër minare. Dhoma ku është varrosur Profeti (a.s.) është rrethuar me një mur të bërë me gurë të gdhendur. Sipër varrit është vendosur edhe një mushama për ta mbrojtur nga shiu.

## PERIUDHA E ABASIVE

Në periudhën e Abasitëve, babai i Harun Reshidit, i quajtur El-Mehdi, bleu disa kop-

Pas kësaj, xhamia nuk i është nënshtruar asnjëherë më ndonjë rikonstrukcioni deri në natën e xhumasë së Ramazanit të vitit 654 hixhri, atëherë kur zjarri i kandilit, si shkak i mospërfilljes së mirëmbajtësve të ndriçimit të xhamisë ra. Zjarri tregohet se ka përfshirë çdo gjë që ishte në xhami; duke filluar nga tavani, minberi, dyert, librat, rrobat e ndryshme etj. Në vitin 655 hixhri Halifi Abasit Mutasim Billah ka dërguar ustallarët për rindërtimin e saj. Por në vitin 656 të kalendarit hixhri si shkak i pushtimit të Bagdadit nga ana e tatarëve nuk është bërë i mundur ndërtimi i plotë i saj. Vetëm me ardhjen në pushtet të sulltanëve memluk të Egjiptit u realizua rindërtimi i plotë i saj.

## PERIUDHA E SHTETIT TË KELEMENEVE

Për herë të parë në vitin 678 hixhri sulltani egjiptian Muhammed b. Kalavun ka ndërtuar një kube sipër varrit të Muhamedit (a.s.).

Në muajin e ramazanit të vitit 886 hixhri ka rënë një vetëtimë në drejtim të minares që ndodhej në juglindje të xhamisë dhe është bërë shkak të digjet një pjesë e madhe e saj. Por Sulltan Eshref Kajëtbaj e rikonstrukttoi atë pa humbur kohë dhe sipër varrit të profetit



rishtazi ka vendosur një kube. Këtë radhë kubeja është vendosur sipër kolonave. Mihrab-i Osmani është zgjeruar pak më shumë. Kopshti që ndodhej ndërmjet varrit dhe minberit të xhamisë ishte 26 m dhe sipër saj është ndërtuar një kupolë. Kështu u bë mbyllja e një pjese të madhe të xhamisë. Lartësia e tavanit nga dyshemeja shkoi në 15 m. Muret e saj janë stolisur me gurë mozaiku, ndërsa dyshemesë i është shtuar mermer. Po ashtu mahfili i muezinit dhe minberi u ndërtua nga mermeri. Kolonat e xhamisë arritën numrin treqind e pesë, ndërsa sipërfaqja 9424 m<sup>2</sup>.

### PERIUDHA OTOMANE

Sulltanët e perandorisë otomane i kanë kushtuar një rëndësie të madhe mirëmbajtjes dhe shërbimit të xhamisë së Profetit (a.s.). Sulltanët otomanë janë thirrur me epitelin shërbëtorët e dy qyteteve të shenjta (hadimul-haramejn). Në kohën kur sulltan Sulejmani ishte në pushtet dërgoi plot pesë gjymëhëna me qëllim që të vendoseshin sipër katër minareve dhe kubesë. Në vitin 1541 është ndërtuar mihrabi hanefit dhe është vendosur paralel dhe në një rrafsh me atë të Profetit (a.s.).

Ndërsa në vitin 1813, Mahmuti II-të ka vendosur sipër varrit të Profetit (a.s.) një kupolë të ndërtuar prej plumbi dhe me ngjyrë jeshile, e cila ende edhe kësaj dite vazhdon të jetë. Xhamia e filluar për rikonstruktiv në vitin 1848 dhe që u përfundua në vitin 1861 nga Sultan Abdulmexhidi, arriti formën më të përkryer për nga bukuria deri në ato kohë. Çdo gjë është rindërtuar



nga fillimi, përveç dhomës së Profetit, mihrabit të Profetit, mihrabit të Osmanit, mihrabit hanefi, minberit dhe minares së ndodhur pranë kubesë.

Sipër tavanit të xhamisë janë vendosur kube të lyera me plumb. Lartësia ndërmjet tavanit dhe dyshemesë së haremit ishte e baraslarguar. Por kubet e vendosura sipër tavanit nuk ishin në lartësi të njëjtë njëra me tjetrën. Kubeja me gjatësi më të lartë ishte ajo sipër varrit të profetit. Pastaj vinin me radhë, ajo e mihrabit të Osmanit dhe e babu's-selamit. Kurse të tjerat ishin me përmasa të njëjta. Gjithashtu janë gdhendur katër rreshta shkrimi të llojit sulus në murin e kibles nga njëri cep në tjetrin. Në tre rreshta u shkruan citate nga suret Ali Imran, Tevbe dhe Fetih. Kurse në rreshtin e katërt u shkruan 201 emrat dhe cilësitë e Muhamedit (a.s.). Sipërfaqja e xhamisë në kohën e Sultan Abdulmexhidit ishte 10342 m<sup>2</sup>.

### PERIUDHA E SAUDITËVE

Mbretëria saudite e ka zgje-

ruar sipërfaqen e xhamisë dy herë, por në asnjërin rast nuk ka bërë ndryshime në pjesën e përparme të xhamisë së ndërtuar nga sulltan Abdulmexhidi.

Xhamia ka dyzet e një vendhyrje; në ndonjërin prej tyre ka dy, tre apo pesë dyer. Sipas kësaj shuma e deryeve të xhamisë arrin në tetëdhjetë e pesë. Në rikonstruksionin e fundit të xhamisë sipërfaqja e saj arriti në 98.326 m<sup>2</sup> dhe në të mund të falin namaz 178.000 persona. Sipërfaqja e katit të dytë, duke mos e numëruar atë të kubeve, është 58250 m<sup>2</sup> dhe në të mund të falen rreth 90.000 persona. Kurse sipërfaqja e pjesëve të tjera që i përkasin xhamisë është 13.500 m<sup>2</sup> dhe në të mund të falen 43.000 persona. Po t'i marrim parasysh brendësinë e xhamisë, katin e sipërm dhe pjesët e tjera anësore të saj do të shohim se në të është e mundur të falen rreth 698.000 persona në të njëjtën kohë. Në xhami janë të vendosura edhe 2104 kolona mbajtëse.



**SHQIPËRIA**

## KRYEMINISTRI BERISHA: ME CENTRAL BËRTHAMOR

Kryeministri Berisha deklaroi mundësinë e ndërtimit të një centrali bërthamor që do të zgjidhte përfundimisht problemin e krizës energjetike në Shqipëri. Të ndryshme kanë qenë reagimet e shteteve fqinje me Shqipërinë pas kësaj deklarate. Kryeministri italian, Romano Prodi, ka konfirmuar vizitën e tij në Tiranë më datën 3 të muajit dhjetor. Gazeta prestigjioze angleze "The Guardian", e lidh këtë vizitë pikërisht me idenë e Kryeministrit shqiptar për ndërtimin e një centrali nuklear që jo vetëm do të plotësonte nevojat e vendit tonë me energji, por do të krijonte edhe mundësinë e eksportit të saj drejt Italisë me një çmim tepër të lirë, pasi kostoja e prodhimit të energjisë nga këto vepra është pak më shumë se dy lekë për kilovat/orë.

Kjo mbështetje kaq e fortë e Italisë për idenë e ndërtimit të një centrali bërthamor në Shqipëri, sipas prestigjiozes angleze "The Guardian",

vjen për një arsye të thjeshtë. Ashtu si Shqipëria edhe Italia duket se nuk ndodhet në një situatë të mirë energjetike dhe për të plotësuar nevojat e saj i duhet t'i drejtohet importit. Industrializimi i vendit dhe kërkesa në rritje për energji në Itali e detyroi qeverinë e vendit fqinj që në 1987-ën të hedhë idenë e ndërtimit të një centrali bërthamor. Por pasi u hodh në referendum popullor ideja në atë kohë u rrëzua nga populli italian, që e kundërshtoi fort atë. Por ndryshe nga Italia, fqinji jugor i vendit tonë, Greqia duket se është alarmuar nga propozimi i Kryeministrit Berisha për ndërtimin e centralit nuklear. Athina zyrtare është shprehur kundër një projekti të tillë me idenë se Shqipëria nuk mund të garantojë dot sigurinë e nevojshme, për të zotëruar një fuqi kaq të madhe bërthamore. E ndërsa propozimi i Kryeministrit nuk është asgjë më shumë se një ide, tashmë debati në lidhje me këtë çështje po merr përmasa ndërkombëtare.

## GREKËT ME FABRIKË ILAÇESH NË SHQIPËRI

E përditshmja greke, "Kathimerini", bëri të ditur se kompania "Alapis", e listuar në bursë, njoftoi krijimin e një filiali në Shqipëri, të quajtur "Veterinfarma Albania Sh.p.k.", me seli në Tiranë. Kjo kompani do të merret me prodhimin dhe tregtimin e ilaçeve të reja si për njerëzit, ashtu dhe për përdorim veterinar.

Tregu i barnave në Shqipëri llogaritet në rreth 150 milionë dollarë në vit, sipas të dhënave të përafërta. Ky treg zotërohet në pjesën dërrmuese, gati 90 për qind nga importi. Ndërsa barnat e prodhuara në Shqipëri zënë një vend shumë të vogël dhe nuk e kapërcejnë 10 përqindëshin e nevojave të tregut vendas.

## KANADEZËT RRSIN FIT SHQIPTARE KRAHASUA

Kompania kanadeze "Bankers Petroleum" që ka me koncesion vendburimin e

Patos-Marinzës njoftoi se fitimet e saj nga shitja e naftës shqiptare u rritën me 77 për qind gjatë tremujorit të tretë të këtij viti krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Të ardhurat e kompanisë kanadeze arritën në 16.4 milionë dollarë për tremujorin e tretë

krahasuar me 9.4 milionë dollarë që ishin në të njëjtën periudhë të vitit 2006. Kjo rritje e të ardhurave ka ardhur si pasojë e shtimit të prodhimit nga ana e kanadezëve, që aktualisht nxjerrin rreth 4980 fuçi në ditë nga vendburimi i Patos Marinzës.



## VIZITA E PRESIDENTIT TOPI NË GREQI



*Vizita e presidentit Topi në shtetin grek nuk solli ndonjë gjë të re, përveçse nxorri edhe një herë në pah mënyrën inferiore me të cilën politika greke i qaset çështjeve lidhur me Shqipërinë.*

## FITIMET 77 % NGA NAFTA PËR ME NJË VIT MË PARË

Fitimi neto për Shqipërinë është rritur ndjeshëm. Për tre mujorin e tretë, kompania ka fituar gati 20 dollarë për çdo fuçi naftë që ka shitur, ndërsa tremujorin e mëparshëm

norma e fitimit ishte 16 dollarë dhe një vit më parë vetëm 12.5 dollarë. Për këtë periudhë,

fitimet neto të kompanisë kanë qenë 264 mijë dollarë. Sipas të dhënave zyrtare, gati 55 për qind e naftës që "Bankers" prodhon në Shqipëri dërgohet për eksport në

Itali dhe shitet me një çmim prej gati 45 dollarësh për fuçi. Kjo ka bërë që pjesa më e madhe e naftës së prodhuar në Shqipëri të shkojë për eksport, ndërsa pjesa tjetër përpunohet nga ARMO këtu në vend.

Presidenti shqiptar, Bamir Topi nuk është shprehur për çështjen çame në veçanti, por për çështjen e pronave të shqiptarëve në përgjithësi, duke marrë të njëjtën përgjigje që jep Athina prej shumë vitesh, se çështja do zgjidhet duke u shqyrtuar rast pas rasti.

Presidenti Topi ka theksuar gjithashtu se ka kërkuar nga kryeministri grek që të vendoset një kanal komunikimi mes institucioneve tona dhe atyre greke që të ketë një informacion për shqiptarët që janë në burgjet e Greqisë. Çështja e pronave është trajtuar me mjaft interes në takimin mes dy presidentëve. Presidenti shqiptar, Bamir Topi nuk është shprehur për çështjen çame në veçanti, por për çështjen e pronave të shqiptarëve në përgjithësi, duke marrë të njëjtën përgjigje që jep Athina prej shume vitesh, se çështja do zgjidhet duke u shqyrtuar rast pas rasti. Jashtë vëmendjes nuk janë lënë as pronat e minoriteteve greke. Presidenti Bamir Topi, gjatë një konference dhënë në Athinë, ka premtuar se minoritetet greke do t'i marrin pronat e tyre dhe ka garantuar respektimin e ligjit. "Minoritetet greke në Shqipëri do t'i marrin pronat. Kjo do të bëhet e mundur në bazë të Ligjit 7501, duke shtuar se çështja e pronave do trajtohet në bazë të nenit 15 të Traktatit të Miqësisë të vitit 1996.

Sipas qeverisë greke, të përfaqësuar nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Petros

Dukas, shteti shqiptar, në rast se ndërmer një hap të tillë, duhet të paguajë dëmshpërblim në masën 50 milionë euro zotërueseve prej vitesh të depozitave të mëdha të hidrokarbureve në territorin e portit të Durrësit që janë tre kompanitë e mëdha greke, që operojnë në Shqipëri: Mamidoil, Global Petroleum dhe Evroil. Fakti që ky paralajmërim kërcënues është bërë gjatë vizitës së parë të kreut shqiptar të shtetit, Bamir Topi në Greqi, tregon se problemi është marrë shumë seriozisht nga pala helene, që e trajton atë politikisht.

## SHKARKIMET E SHUMTA NËPËRMJET INTERNETIT ALARMOJNE EKSPERTËT

Sipas një raporti të kompanisë Nemer-tes deri në vitin 2010, si pasojë e shkarkimeve të shumta, sistemi i internetit do të çorientohet. Sipas disa kërkimeve, miliona kompjutera gjatë gjithë vitit 24 ora rrjeshtë bëhen shkarkime dosjesh me GB të madh siç janë: muzika, filmat dhe vidiot. Kjo shkakton një rëndim të trfikut të internetit.


10% të gjithë kapacitetit të të gjithë shkarkimeve e përdor vetëm YOU TUBE. Dhe sipas ekspertëve pritet që numri i shkarkimeve nëpërmjet internetit të rritet edhe më shumë. Për këtë arsye ekspertët lëshojnë alarmin për marrjen e masave të menjehershme për përmisimin e gjendjes para se ajo të behet tepër kritike. Për këtë ekspertët thonë se duhet bërë një investim prej 130 miliard dollarësh. Ku 60 miliardë dollare duhen vetëm për përmisimin e sistemit të internetin në SH.B.A.

Në muaj 12 miliardë video shkarkime



Sipas kërkimeve të bëra nga Camscore shkarkimet më të shumta bëhen në SH.B.A ku 75% e përdoruesve të internetit shkarkojnë në muaj afërsisht 8.5 miliard video kurse shkarkimet që bëhen në gjithë botën e kalojnë shifrën e 12 miliard video.

Investimet prej 130 miliardë dollarësh mund të mos mjaftojë duke parë rritjen e shpejtë të numrit të shkarkimeve në internet. Në të ardhmen duhet të futen në përdorim sisteme interneti më të sofistikuara për ti bërë ballë kësaj gjendje alarmante.





## ZBULOHEK LETRA QË FSHIHET VETVETIU

Është zbuluar një letër në të cilën shkrimet e shkruara brenda 16-24 orëve fshihen vetvetiu. Thuhet se për letren që vetfshihet, Xeroxi ka aplikuar që ti jepej leja për realizimin e këtij projekti edhe pse akoma është në proces zhvillimi e sipër.

Pas një punë të madhe përgaditore është arritur deri aty sa që ngjyrat e shkrimit të shkruar në këto fletë të ndryshohen në të tjera, si dhe pas një momenti të caktuar të vetfshihet. Duke u nisur nga kjo gjë mund të pohohet se kjo letër fshihet vetvetiu për 16-24 orë dhe herpashere.

Qendra PARC AR-GE e Xerox-it e cila ndodhet në Kanada, duke bërë prova të hepashershme për pjesët përbërse të kësaj letre pohon se ka ndërmend që të shpik edhe printerin e saj. Teknologjia e zhvilluar tani bën që shkrimet e shkruara të zhduken në mënyrë natyrale ose brenda një nxehtesie ato të vetfshihen.

Xerox brenda struktues së vet ka afro 1100 shkencëtar dhe se bën kërkime shkencore në laboratorët e vendeve të ndryshme si SHBA., Kanada, dhe Evropë, në fushat; sistemi elektro mekanik, kompjuter, dija për ngjyrat, aparatet teknologjike etj.



## LETRA A DO TË MBESË NË HISTORI?

Websiti amazon.com ka shpikur një aparat i quajtur kindle, me të cilin bëhet e mundur zbritja e një libri të tërë për më pak se një minut. Në saj të këtij aparati mund të lexohen edhe gazetatat të ndryshme që kanë marrveshje me këtë eeb-site.

Ndertuesi i këtij rrjeti interneti Jeffrey Bezos në një konferencë shtypi të zhvilluar që qytetin e Neë York-ut të SHBA-së, ka thekuar se është punuar tre vjet rresht për aparatit "Kindle" dhe se kemi dashur ti marrim librat e mëparshme.

Kindli i cili ka një masë prej 238 gr. dhe më ekran 6 inç bën të mundur leximin e librave të ndryshëm. Një ndër ndryshimet që aparati ka më sistemet e tjera të ngjashme me te, është se shkronjat e saja mund të zmadhohen. Veç kësaj bëhet i mundur leximi i shkrimit edhe atëher kur rrezet e diellit biejn sipër ekranit. Në sajë të aparatit të lidhur me sistemin EVDO që përdoret në telefonat celularë bëhet e mundur që të lexohen dhe zbriten 88000 librat që janë në këtë eeb-site. Gjithashtu edhe në faqe janë të pranishme edhe dipnotat. Aparati kushton 399 \$.